



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë , “Drejtorina e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit Financiar Publik”

# RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

**MBI AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË USHTRUAR NË MINISTRINË  
E FINANCAVE DHE EKONOMISË, DREJTORINË E PËRGJITHSHME  
TË HARMONIZIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR  
PUBLIK**

Tiranë, Tetor 2020

Nr.	PËRMBAJTJA	Faqe
I.	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	3
	<i>Përshkrim I shkurtër I auditimit</i>	3
	<i>Përshkrim I gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve</i>	3
	<i>Konkluzioni I përgjithshëm dhe Opinion i Auditimit</i>	5
II.	<b>HYRJA</b>	8
	<i>Objektivat dhe qëllimi.</i>	8
	<i>Identifikimi i çështjes</i>	8
	<i>Përgjegjësitë e strukturave drejtuese</i>	8
	<i>Përgjegjësitë e audituesve</i>	8
	<i>Kriteret e vlerësimit</i>	8
	<i>Standartet e auditimit</i>	8
III	<b>PËRSHKRIMI AUDITIMIT</b>	8
	<i>Mbi auditimin në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm</i>	9
	<i>Mbi auditimin në Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit</i>	47
	<i>Zbatimi i rekomandimeve të auditimit të mëparshëm</i>	92
IV	<b>GJETJET DHE REKOMANDIMET</b>	93
	<i>Masa Organizative</i>	93
	<i>Masa Administrative</i>	115
	<i>Masa Disiplinore</i>	115

## I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

### I.1 Pëershkrim i shkurtër i auditimit

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me objekt “Mbi përputhshmërinë” e veprimtarisë dhe dhënien e opinionit mbi Raportin Vjetor të prezantuar përmes kësaj drejtorie lidhur me sistemet e kontrollit të brendshëm dhe auditimin e brendshëm në sektorin publik për periudhën 01.01.2019- 31.12.2019, u konstatua se kjo strukturë nuk ka arritur të realizojë programet vjetore lidhur me monitorimin e sistemeve KBFP, nuk ka dokumentuar dhe administruar procesin e monitorimit dhe vlerësimit të njësive publike të përzgjedhura për vlerësim, duke raportuar ecurinë e sistemeve të kontrollit bazuar në një numër mjaft të ulët të njësive publike referuar numrit total të tyre në nivel kombëtar. Auditimi i brendshëm, vijon të mos jetë i pavarur, ndërkohë që paligjshmëria në ngritjen dhe funksionimin e këtyre strukturave mbetet aktuale. Komitetet e Auditimit edhe në rastin kur janë ngritur nuk kanë arritur të garantojnë shkëputjen e plotë të auditimit të brendshëm nga Titullarët e Institucioneve. Aktivitetet e raportuara nga këto struktura për vitin 2019, tregojnë se ka nevojë për përmirësim duke filluar me kornizën ligjore e rregullative të aktivitetit të tyre. Megjithëse konstatohet një qasje pozitive në drejtim të leximit të gjetjeve dhe rekomandimeve që KLSH ka adresuar për përmirësimin e gjendjes, zbatimi i rekomandimeve mbetet në nivel të ulët.

Në Raportin Vjetor, janë sjellë problematikat kryesore të lidhura me auditimin e brendshëm, megjithëse një qasje përgjithësuese duke mos u ndaluar në strukturat më problematike. Në këtë raport është pasqyruar situata e viti 2018, për shkak të mos realizimit të monitorimeve të planifikuara për pyetësorët e vetëvlerësimit të viti 2019, ndërsa raportimi mbi bazë të përpunimit të pyetësorëve të vetëvlerësimit mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, përban jo vetëm problemet e mungesës së testimit të besueshmërisë së të dhënave të raportuara nga entet publike, por edhe të pikëzimit jo standard të përgjigjeve të dhëna nga entet e ndryshme publike. KLSH, gykon se formati dhe përbajtja e Raportit Vjetor nuk duhet të kenë ndryshime të rëndësishme pasi nuk lejon krahasimin dhe vlerësimin e përmirësimeve të ndodhura ndër vite në kuadër të sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësive publike.

### I.2. Pëershkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Gjetja nr	Përbledhje e Gjetjes	Referenca me Raportin Përfundimtar	Rëndësi a	Rekomandimi
1	Konstatohet se DH/MFK nuk ka kryer monitorimet mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm për vitin 2019, ndërkohë që Raporti Vjetor i KBFP, rraperon monitorimet e realizuara përfunksionimin e sistemeve të kontrollit të viti 2018.	Gjetja nr 4 mbi auditimin në Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit	E lartë	Strukturat drejtuese të DH/KBFP, Nëpunësi i Pare Autorizues dhe Titullari Institucionit, të nxjerë përgjegjësi konkrete për të gjithë punonjësit që nuk kanë kryer detyrat funksionale dhe me veprimet dhe mos veprimet e tyre kanë lejuar raportim të gabuar në Raportin Vjetor që i paraqitet Kuvendi. Për monitorimet lidhur me situatën e viti 2020, të programohet një numër i përshtatshëm monitorimesh, si dhe të përfshihet në programet e punës edhe ndekja e rekomandimeve të lëna.

			Përzgjedhja e subjekteve përmonitorim li referohet subjekteve që shfaqin problematika të mëdha lidhur me sistemet e kontrollit bazuar jo vetëm në pyetësorët e vërvlerësimit por edhe në raportet e auditimit të KLSH.	
2	Në lidhje me sistemin e pikëzimin të përzgjedhur nga DH/MFK në kuadër të indikatorëve të performancës, u analizuan vlerësimet e dhëna nga ana e Drejtorisë në vijim të përgjigjeve të institucioneve shtetërore në pyetësorët e vërvlerësimit. Për sa më sipër, në përfundim të auditimit me zgjedhje mbi vlerësimin e indikatorëve të raportuar sipas strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020 grapi i auditimit konstatoi që vlerësimi i pyetësorëve është realizuar në mënyrë jo të drejtë dhe konsistente ndërmjet institucioneve duke patur parasysh që për përgjigje të ngashime vlerësimi ka qenë i ndryshëm, sikundër evidentohet nga disa rastë të evindetua.	Gjetja nr 6 mbi auditimin në Drejtore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit	E lartë	DH/KBFP të marrë masat për një vlerësim real me pikë të institucioneve raportuese pranë drejtorisë. Të nxirret përgjegjësia për vlerësimet jo korakte apo të pa unifikuara të DH/MFK.
3	Referuar memo-s nr.23209 datë 16.12.2019 të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit identifikohen 466 institucione buxhetore në të cilët nëpunësi zbatues kryen edhe regjistrimin e transaksioneve buxhetore, në kundërshtim me rregullat e kontrollit të brendshëm financiar përekzekutimin e transaksioneve financiare të buxhetit tështetit, ku përcaktohen detyrimi ligjor përfshirjen e minimalisht tre punonjësve në rolin e regjistruesit të transaksionit, nëpunësit zbatues dhe nëpunësit autorizues, shprehur në nenin 22 pika 3 "Veprimtaritë e kontrollit" të ligjit 10296, i ndryshuar	Gjetja nr 8 mbi auditimin në Drejtore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit	E lartë	Nënpunësi i Parë Autorizues në bashkëpunim me Drejtore të Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik të marrë masa përzgjidhjen e problemit të evidentuar.
4	Nga verifikimi i raportimit të NJAB-ve lidhur me auditimet e kryera, është kryer analizimi i këtyre të dhëna respektivisht me numrin e audituesve në këto struktura, për të dhënen një pamje të qartë të ngarkesave të strukturave AB. Konstatohet se ka një shpërndarje të pabarabartë të ngarkesës në rang sistemi. Nga verifikimi i të dhënavë të vëna në dispozicion nga DH/AB vihet re se strukturat AB të ngritura në 10 (dhjetë) institucionë nuk kanë realizuar asnjë mision auditimi,	Gjetja nr 3 Mbi auditimin në Drejtore të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm	E lartë	Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit Brendshëm Financiar Publik përmes Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm, në mënyrë të menjëherësme duhet të analizojë me profesionalizëm dhe në mënyrë të detajuarçështjen e efektivitetit dhe efisencës së njësive AB dhe të reflektojë këtë analizë dhe rezultatet e saj në opinionet e dhëna në reportin vjetor të KBFP. Raportimi i DH/AB të ndalojë jo vetëm në problematikat e përgjithshme por edhe në cilësimin e subjekteve që nuk përformojnë detyrat funksionale dhe paguhën nga paratë e shtetit përpunë të pakryer.

### I.3.Opioni i Auditimit

Ne kemi audituar aktivitetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit Brendshëm Financiar Publik e cila përfshin aktivitetin e Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm dhe Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Auditimi është realizuar në përputhje me Standardet Ndërkontrollare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI).Përgjegjësitë tonë sipas këtyre standartave janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin “Përgjegjësitë e audituesit për Auditimin e Përputhshmërisë” të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin e përputhshmërisë në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH dhe kemi përbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

#### Opioni i Grupit të Auditimit mbi përputhshmërinë

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit, mbi të cilat janë formuluar gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, si rrjedhojë e ekzekutimit të procedurave audituese, rezulton se Drejtoria e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, përgjatë të gjitha proceseve të ekzekutimit të përgjegjësive në përmbushje të misionit të saj si harmonizuese, monitoruese dhe raportuese, rezulton se nuk ka vepruar plotësisht në përputhje me Ligjin nr.114/2015 dt. 15.10.2015 “Për Auditin e Brendshëm në Sektorin Publik”, Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin nr.110/2015, datë 15.10.2015 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Manualin e Auditit të Brendshëm, Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, si dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tyre. Deviacionet e identikuara justifikojnë dhënien e një Opioni të Kundërt, mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik për vitin 2019.

#### Bazat për Opinionin e Kundërt të Përputhshmërisë

Gjendja mbi sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, në sektorin publik, vijon të bazohet në një numër të ulët njësish publike (rreth 10% e totalit të njësive publike), ndërkohë që nga DH/MFK nuk garantonhet raportimi i plotë dhe i drejtë, duke sjellë që edhe raporti vjetor i përgatitur të mos reflektojë situatën reale të menaxhimit financiar dhe kontrollit në vend.

DH/MFK nuk ka realizuar monitorimet e detyrueshme, ndërkohë që në raportin vjetor ka raportuar mbi monitorimet e realizuara për vitin 2018, të cilat kanë qenë pjesë e raportimit të situatës së sistemeve të kontrollit për një vit më parë. Nuk ka kryer përllogaritjen e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm mbi gjithë elementët e pyetësorit të vetëvlerësimit (30/99 pyetje të marra për vlerësim), ku rezulton se përzgjedhja e pyetjeve është e pa argumentuar dhe analizuar, për sa kohë ato nuk mund të përgjithësojnë efektivitetin e sistemeve të kontrollit, si dhe nuk krijohet mundësia e krahasimit me situatën e vitevetë mëparshme.

Vlerësimi me pikë i kryer nga Drejtoria e Harmonizimit, është i pa unifikuar dhe nxjerr në pah një vlerësim me standarde të ndryshme. Implementimet e sistemeve pilot rezultojnë të pa realizuar në nivelin 50% referuar 2018, fakt që lidhet me mos arritjen e objektivave të

pritshmenë përmirësim të dizenjimit të sistemeve të kontrollit në entitetet e zgjedhura për pilotim.

DH/MFK nuk ka mundur të përbushë detyrimin e saj për garantimin e cilësisë në përzgjedhjen e strukturave të NA/NZ në nivel kombëtar dhe rezulton në mos veprim për të zgjidhur këtë problematikë, ku konstatohen 466 nëpunës zbatues në kundërshtim me rregullat e kontrollit të brendshëm financiar për ekzekutimin e transaksioneve financiare të buxhetit të shtetit. Kemi gjykuar se strukturat e DH/MFK kanë realizuar funksionet e tyre me mangësi edhe referuar përcaktimeve të dizenjuara nga vetë kjo strukturë.

Për sa i përket situatës së Auditimit të Brendshëm në sektorin publik, është konstatuar se nga ana e DH/AB, akoma mungon analiza mbi nivelin e nevojshëm të shtrirjes së auditit të brendshëm në sektorin publik, nuk ka një numër të saktë të njësive të cilat plotësojnë kushtet e nevojshme për ngritjen e njësive të auditimit në nivel qendror, institucionale të pavarura dhe shoqëri aksionare, me qëllim që të raportohet drejtë mbi strukturat dhe shtrirjen e këtij shërbimi për të kaluar më pas në vlerësimin e cilësisë së tij në rang kombëtar, problematikë kjo e trajtuar në pothuajse të gjithë auditimet e KLSH pranë DH/KBFP vitet e fundit.

Raporti Vjetor mbi Auditimin e Brendshëm në sektorin publik, bazohet në përpunimin e të dhënave të një numri të kufizuar strukturash (129 struktura AB), që raportojnë pranë Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm. Struktura një pjesë e të cilave bazuar në të dhënat e përpunuara, janë ngritur në shkelje të kërkesave të Ligjit nr.114/2015 dt. 15.10.2015, neni 10 dhe VKM nr.83 dt. 3.2.2016 dhe rezultojnë të pa plota, me punësim jo sipas kritereve ligjore dhe formale, duke u shoqëruar me ineficencë të sistemit të auditit të brendshëm, dhe duke shpenzuar në mënyrë jo efektive fondet publike të vëna në dispozicion. Për vitin 2019, edhe për shkak të vakancave në strukturën e DH/AB, nuk konstatohet të jetë vepruar me qëllim përmirësimin e situatës për sa kohë që KLSH ka disa vite rresht që adreson të njëjtat problematika.

Paligjshmëritë e konstatuara në njobjen/mosnjohjen e certifikatave ndërkombëtare adresojnë problematika lodhur me monitorimin e strukturave të pavarura që mbulojnë procesin e certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik si dhe hapësirave në kornizën rregullative për të eleminuar problematikat e konstatuara në dy vitet e fundit.

Niveli i gjetjeve të raportuara nga strukturat e auditimit të brendshëm është i ulët dhe në raportin vjetor nuk ka një analizë të drejtë për të nxjerrë në pah strukturat që kanë vijuar të funksionojnë pa performuar. Mungon në cdo rast përcaktimi i përgjegjësive duke sjellë ruajtjen e të njëjtës "status quo".

#### **Përgjegjësitë e drejtuesve të Drejtorisë së Harmonizimit të Kontrollit Brendshëm Financiar Publik**

Stafi drejtues është përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve dhe funksioneve në përbushje të kërkesave ligjore dhe rregullatore në fuqi, që rjedhin nga Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për Menaxhimi Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Ligji nr. 114/2015 datë 15.10.2015 "Për Auditin e Brendshëm në Sektorin Publik", dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe Ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Është përgjegjës për cilësinë e përgatitjes së Raportit Vjetor lidhur me nivelin e sistemve të kontrollit të brendshëm në rang kombëtar.

#### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë**

Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme dhe dhënien e opinionit nëse aktiviteti i Drejtorisë së Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik është kryer në përputhshmëri me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e përputhshmërisë të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportin e auditimit, me përashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjërë.

Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Gjithashtu, ne u mundësojmë drejtuesve një deklaratë ne lidhje me kërkesat etike të pavarsësisë sipas të cilave ne kemi kryer punën tonë audituese, dhe komunikojmë me ta në rastet kur ekziston konflikt interesit apo çështje të tjera lidhur me etikën.

## II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr 458/1 datë 09.06.2020, në subjektin Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, për periudhën nga 01.01.2019 deri ne 31.12.2019, u krye auditimi me objekt “Auditim përputhshmërie” nga grupi i auditimit me përbërje:



**Titulli:** Auditim përputhshmërie në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

**Marrësi:** Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik

**II.1 Objektivat dhe qëllimi:** Dhënia e opinionit mbi aktivitetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Publik për vitin 2019. Vlerësimi nëse aktivitetet dhe informacionet e raportuara në lidhje me sistemet e kontrollit të brendshëm në sektorin publik janë të drejta dhe të sakta në çdo aspekt, si dhe vlerësimi nëse këto sisteme funksionojnë përputhje me kuadrin rregullator në fuqi.

Korniza ligjore përcakton Ministrin e Financave sipas ligjit nr 114/2015 “Për autitimin e Brendshëm në Sektorin Publik” nen 23, përgjegjës për paraqitjen në Këshillin e Ministrave, brenda muajit maj të çdo viti, të raportit vjetor për auditimin e brendshëm, si pjesë e raportit vjetor të konsoliduar për kontrollin e brendshëm në sektorin publik. Për të ushtruar këto përgjegjësi, Ministri i Financave mbështetet nga Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik dhe struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm në Ministrinë e Financave. Gjithashtu sipas nenit 7 pika 2 të ligjit nr 10296 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” me datë 08.07.2010 i ndryshuar “Nëpunësi i parë autorizues përgjigjet përpëra Ministrin të Financave për menaxhimin e sistemit buxhetor, si dhe për monitorimin e zbatimit të kontrollit të brëndshëm financiar dhe publik, sipas këtij ligji, dhe i paraqet komisionit përkatës parlamentar raporte për ecurinë si dhe pasqyrat financiare e raportin vjetor për zbatimin e

*buxhetit në Republikën e Shqipërisë. Me kërkesë të komisionit, ai raporton gjatë viti lidhur me cështje të zbatimit të buxhetit apo të kontrollit të brendshëm financiar publik.*

Gjithashtu sipas nenit 6 pika 1/a të ligjit të sipër cituar “*Ministri i Financave është autoriteti përgjegjës për miratimin e udhëzimeve e të manualeve për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësitë e sektorit publik, që mbulojnë në mënyrë të vecantë formën, përmbytjen dhe afatet e raportimit periodik te nepunësi i parë autorizues rrëth funksionimit, përshtatmërisë, eficencës dhe efektivitetit të sistemeve ekzistuese të menaxhimit financiar dhe kontrollit, parregullsisë e gjetura dhe masat e marra*”

**II.3 Përgjegjësitë e audituesve.** Përgjegjësia e audituesit të jashtëm publik është që të shprehi një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Kontrollit Brendshëm Financiar Publik në lidhje me aktet ligjore dhe nënligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin, auditimin e brendshëm dhe menaxhimin e sistemit buxhetor. Është përgjegjësi e audituesve që auditimi të kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INTOSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, bazuar në nivel të mjaftueshëm të evidencës së mbledhur për auditim.

**II.4 Kriteret e vlerësimit.** Për kryerjen e këtij auditmi, në lidhje me dhënien e opinionit për përputhshmërinë e aktivitetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit jemi bazuar në Ligjin nr. 10 296 dt. 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar me Ligjin 110/2015 dt. 15.10.2015, Ligjin nr. 114/2015 dt. 22.10.2015 “Për Auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Ligji nr. 9936 dt. 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” si dhe urdhrat dhe udhëzimet specifike në lidhje me to.

**II.5 Standardet e auditimit:** Auditimi u bazua në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren “Për Procedurat e Auditimit KLSH” miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 107, datë 08.09.2017, të ndryshuar, dhe në referencë të Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t.

### **III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT**

**Informacioni i Përgjithshëm:** Auditimi në Drejtoren e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të brendshëm Financiar Publik u krye në bazë të planit fillestare të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar.

**Objekti i këtij auditimi** është vlerësimi i përputhshmërisë së aktivitetit të vitit 2019, i subjektit të audituar me kriteret e përcaktuara të në kuadrin rregullator në fuqi.

**Qëllimi i auditimit** është dhënia e opinionit të përputhshmërisë në lidhje me aktivitetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të brendshëm Financiar Publik në respekt të kërkesave të Ligjin nr. 10 296 dt. 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, të ndryshuar dhe Ligjin nr. 114/2015 dt. 22.10.2015 “Për Auditimin e brendshëm në sektorin publik”. Dhënien e opinionit mbi Raportin Vjetor të KBFP, të prezantuar përmes kësaj drejtorie lidhur me sistemet e kontrollit të brendshëm dhe auditin e brendshëm në sektorin publik përiudhën 01.01.2019 - 31.12.2019, është objktivi tjetër i këtij auditimi.

Fushëveprimi i këtij auditimi përfshin aktivitetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të brendshëm Financiar Publik, e cila ka si mision të saj harmonizimin e standardeve, rregullave dhe procedurave në kryerjen, monitorimin dhe raportimin e veprimtarisë së

**auditimit të brendshëm dhe të menaxhimit e kontrollit financiar në sektorin publik me funksionin kryesor të saj: rregullimin, monitorimin, dhe raportimin mbi veprimtarinë e auditimit në përgjithësi dhe të menaxhimit financiar dhe kontrollit në veçanti, si dhe kualifikimi dhe certifikimi i profesionistëve auditues.**

**Çështjet kryesore të Auditimit:** Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje të cilat në gjykimin tonë, kanë rezultuar më të rëndësishmet në bazë të vlerësimit të risqeve të identifikuara në fazën e parë të auditimit si dhe çështjeve të dala gjatë auditimit mbi aktivitetin e Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm dhe Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin. **Çështjet kryesore në auditimin e aktivitetit të Drejtorisë së Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik për vitin 2019, paraqiten si më poshtë:**

**I. Në lidhje me Drejtorinë e Harmonizimit të AB:**

1. Monitorimi i veprimtarisë AB në nivel kombëtar;
2. Përgatitja dhe administrimi i planit të konsoliduar strategjik e vjetor të veprimtarisë së auditimit të brendshëm në njësitë publike;
3. Përhatitja e raportit për funksionimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik, pjesë e raportit vjetor të konsoliduar për kontrollin e brendshëm në sektorin publik
4. Mbi zbatimin e manualit për vlerësimin e cilësisë, e cila përfshin procesin e monitorimit dhe vlerësimit në mënyrë periodike të veprimtarisë së njësive të auditimit të brendshëm, në përputhje me standarde ndërkombëtare, të pranuara, të auditimit të brendshëm;
5. Mbi administrimin e procesit të certifikimit të audituesve të brendshëm, si dhe njohja e certifikatave ndërkobëtare

**II. Në lidhje me Drejtorinë e Harmonizimit të MFK**

1. Analiza e sistemit sipas pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit bazuar në vetëvlerësimin e njësive publike, dhe cilësia e këtij raportimi.
2. Monitorimi mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm kryer nga DH/MFK.
3. Mbi implementimit pilot të sistemeve të MFK në institucionet e përgjedhura, për vitin 2019.
4. Mbi azhornimin e metodologjisë së kontabilitetit publik me zhvillimet bashkëkohore dhe ndjekjen e procesit të zbatimit të strategjisë së qeverisë për implementimin e standardeve të kontabilitetit publik.
5. Mbi planifikimin dhe kryerjen e trajnimeve nga DH/MFK. Administrimi i rregjistrat të nepunësve autorizues dhe zbatues dhe monitorimi i përputhshmërisë ligjoretyre.
6. Mbi cilësinë, konkluzionet dhe opinionin e paraqitur në Raportin vjetor të vitit 2019 të sistemit financiar të brendshëm publik mbi funksionimin dhe progresin e sistemit MFK në sektorin publik

**III.1 AUDITIM NË DREJTORINË E HARMONIZIMIT TË AUDITIT TË BRENDSHËM**

- 1. Mbi Komitetet të Auditimit dhe aktivitetin e raportuar të tyre për vitin 2019. Krijimi i Komiteteve në strukturat e qeverisjes qëndrore, është një hap pozitiv për të ndihmuar në garantimin e pavarësisë së strukturave të AB dhe rritjen e profesionalizmit të tyre, por që mbetet akoma larg objektivave dhe qëllimeve të synuara. Analiza e punës dhe aktivitetetit të strukturave AB nga këto Komite të është akoma e vakët dhe në disa raste nuk është marrë fare në analizë.**

**Situata:** Në nenin 13, pika 2 të Ligjit nr. 114/2015, është përcaktuar se: “*Komiteti i Auditimit të Brendshëm, në ato njësi publike ku krijohet, e shtrin autoritetin për të gjitha njësitë e varësisë*” dhe në pikën 3 është përcaktuar se: “*Mënyra e funksionimit, kompetencat dhe përbërja e Komitetit të Auditimit të Brendshëm rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrit të Financave*”. Në zbatim të pikës 3 të nenit 13 të Ligjit nr. 114/2015, Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM nr. 160, datë 02.03.2016 “*Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komiteteve të Auditit të Brendshëm një njësitet publike*”, ku janë përcaktuar roli dhe autoriteti i Komitetit të AB, përbërja dhe funksionimi, si dhe kompetencat dhe raportimi. Aktualisht në sektorin publik janë krijuar dhe funksionojnë tetë komitete përkatësishit në: Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Shërbimit Social, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme, Ministrinë e Kulturës dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit. **Gjatë vitit 2019 ka mbaruar mandati i Komitetit të Auditimit të Brendshëm të krijuar në Ministrinë e Mbrojtjes dhe aktualisht ky organ nuk është riorganizuar akoma. Në Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë nuk është krijuar ende Komiteti i Auditimit të Brendshëm.**

VKM nr. 160, datë 02.03.2016 “*Për mënyrën e funksionimet kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm njësitet publike*”, ka përcaktuar se: “*Anëtarët e Komitetit të Auditimit të Brendshëm emërohen me urdhër të titullarit të njësës publike, si ...*”, pra emërimi lihet në diskrecion të Titullarit të Institucionit, pa ndonjë procedurë të mirë përcaktuar mbi vlerësimin e profesionalizmit dhe kapaciteteve që do përfshihen në këto Komitete duke prekur konceptin e pavarësisë së plotë, të synuar nga ligjvënesi.

Nga analiza e emrave përfshirë në këto struktura, konstatojmë që një pjesë e tyre shfaqen si anëtar në më shumë se një Komitet, fakt që tregon se përcaktimet e bëra në kornizën llojore kanë një spektër të kufizuar të eksperëtëve që mund të përfshihen në këto struktura.

Strukturat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si përgjegjëse për bashkërendimin e përgjithshëm, harmonizimin dhe monitorimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik, për analizimin e funksionimit të komiteteve i ka kërkuar të gjitha ministrive të sipërcituara vënien në dispozicion të raportit vjetor të veprimtarisë të secilit Komitet i Auditimit të Brendshëm (KAB). Bazuar në këto raporte evidentohet se, gjatë kësaj periudhe komitetet e ngritura, kanë funksionuar bazuar në përcaktimet e akteve llojore.

Nisur nga Raportet Vjetore të depozituara (dërguara) pranë DH/AB, të cilat na u vunë në dispozicion, kemi konstatuar që një pjesë e rëndësishme e strukturave të Komiteteve të Auditimit nuk kanë miratuar rregullore të brëndshme të miratuar. Është zbatuar përgjithësht realizimi i numrit minimal të përcaktuar në bazën rregullative të mbledhjeve të tyre. Ndërsa referuar fushave ku është përqëndruar aktiviteti i tyre, kemi konstatuar se fokusi i tyre ka qënë kryesishët në shqyrtim dhe miratim të kartës së auditimit, miratimi i planeve strategjik dhe vjetore dhe në pak raste gjetjmë një analizë të punës së strukturave AB apo dhe ballafaqim me problematikat që ka ngritur KLSH lidhur me aspekte

**të MFK dhe vecanërisht të AB.** Nisur nga përbërja e këtyre strukturave, kapacitetet profesionale të tyre, gjykojmë se roli i deritanishëm nuk justifikon qëllimin për të cilin janë ngritur. Në këtë drejtim kanë ndikuar edhe ndryshimet e përbërjes së këtyre strukturave. Konstatohet se punonjësit që kanë dalë në pension, vijojnë të jenë pjesë e këtyre komiteteve.

Në Raportin Vjetor të vitit 2019, **problematikat dhe rekomandimet e dhëna nga Komitetet e Auditimit jepen jo në mënyrë konkrete për cdo institucion, por në mënyrë të përbledhur megjithëse cdo institucion ka jo vetëm qasje të vecantë por dhe raportojnë problematika specifike.**

Ndërsa po ti referohëmi opinionit të dhënë nga Komitetet e Auditimit sic cilësuar në Raportin Vjetor "Komitetet e Auditimit të Brendshëm konkludojnë se veprimtaria audituese është në përgjithësi në përputhje me kuadrin rregullator, por evidentohet se ka nevojë për përmirësim në fusha specifike për të cilat janë dhënë rekomandimet përkatëse, për çdo NJAB nga Komiteti që mbështet veprimtarinë e auditimit të brendshëm. Titullarët e njësive publike duhet të mbështesin më shumë strukturat e auditimit të brendshëm. Duke vlerësuar kontributin që KAB jep në mbështetjen dhe garantimin e realizimit të auditimit të brendshëm si funksion i pavarur që jep siguri objektive dhe këshillim për menaxhimin, krijimi i Komiteteve të Auditimit në njësitë e qeverisjes qëndrore dhe të vetëqeverisjes vendore konsiderohet si një domozdoshmëri për funksionimin e auditimit sipas standardeve dhe praktikave më të mira, në mënyrë të veçantë në njësitë publike që paraqiten me risk të lartë në Matricën e Riskut", gjykojmë se nuk është i saktë dhe i mbështetur në evidencat që disponon DH/AB lidhur me aktivitetin e këtyre Komiteteve. Krijimi i Komiteteve në strukturat e qeverisjes qëndrore, është një hap pozitiv për të ndihmuar në garantimin e pavarësisë së strukturave të AB dhe rritjen e profesionalizmit të tyre, por që imbetet akoma larg objektivave dhe qëllimeve të synuara. Analiza e punës dhe aktivitetetit të strukturave AB nga këto Komite është akoma e vakët dhe në disa raste nuk është marrë fare në analizë. Nuk konstatojmë vëmendje të shtuar në zbatimin e rekomandimeve me efekt në forcimin e sistemeve të brendshme të kontrollit. Nuk konstatohet që për vitin 2019, këto struktura të kenë raportuar raste të trajtimit të konfliktit të interesit në realizimin e angazhimeve audituese.

DH/AB raporton se në asnjë nga njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk është krijuar Komiteti i Auditimit të Brendshëm. DH/AB ka përzgjedhur gjashtë njësi të pushtetit vendor, për dhënen e asistencës së duhur në lidhje me krijimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, referuar shkresës nr. 13893, datë 22.07.2019 "Mbi krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm", e cila i është dërguar Bashkisë Tiranë, Bashkisë Durrës, Bashkisë Vlorë, Bashkisë Lezhë, Bashkisë Kavajë dhe Bashkisë Pogradec. Gjithashtu parashtronhet kërkesa për shtrirjen e këtyre Komiteteve në Njësitë e Vetëqeverisjes vendore, por ne gjykojmë se kjo kërkesë është e pa studiuar dhe kur flitet për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore është jo vetëm e parakohshme por imbart një risk të lartë duke ju referuar kapaciteteve në dispozicion. Në gjykimin tonë Komitetet e Auditimit duhet të funksionojnë fillimisht vetëm në strukturat që kanë shumë njësi varësie (si në rastin e Bashkisë Tiranë me 25 ndërmarrje në varësi).

Ndërsa fakti i cilësuar që njësitë publike të përzgjedhura, kanë një nivel të lartë të

detyrimeve të prapambetura, gjë që i rendit në njësi me risk të lartë dhe me nevojë imediate për të vlerësuar shkaqet e krijimit të tyre nëpërmjet vlerësimit me efektivitet të sistemeve të kontrollit të brendshëm me anë të analizës dhe rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe monitorimit nga Komiteti i Auditimit të Brendshëm për një mirëadministrim të fondeve publike, nuk rezulton i bazuar në të dhëna konkrete (mbi baza të të cilave arrihet në këtë konkluzion) si dhe nuk është arësy për të justifikuar ngritjen e strukturave të auditimit për sa kohë që përgjegjësia për kontrollin dhe monitorimin e detyrimeve të prapambetura është e strukturave të Ministrisë së Financiave dhe Ekonomisë (Nënpunësi i Parë Autorizues)

**Kriteri:** Ligji 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik” ; VKM nr. 160, datë 02.03.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komiteteve të Auditit të Brendshëm në njësitë publike”

**Impakti:** Mungesa raportimi të plotë dhe formalitet në funksionimin e Komiteteve të Auditimit të ngritura

**Shkaku:** DH/AB nuk ka vlerësuar e kujdesin e duhur raportet e Komiteteve të Auditimit dhe nuk ka kompetence të vlerësoje cilësinë e përbërjes së Komiteteve të Auditimit

**Rëndësia:** E lartë

**2. Mbulimi me auditim të brendshëm nga njësitë publike. Vleresimi dhe vetevleresimi i strukturave ne përputhje me standartet dhe kërkesat e manualit, metodat dhe udhëzimet e miratuar nga MFE**

**Situata:** Edhe për vitin 2019, analiza e veprimtarisë së auditimit të brendshëm është kryer nga konsolidimi i të dhënave të raporteve vjetore të njësive të auditimit të brendshëm, që raportojnë aktivitetin e tyre pranëDH/AB. Konstatohet se, sikundër është trajtuar edhe në auditimet e mëparshme të KLSH, nuk rezulton një analizë e plotë në shkallë sistemi nga ana e DH/AB për njësitë të cilat plotësojnë kushtet e nevojshme për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në nivel qendror, njësi të vetëqeverisjes, institucionale të pavarura dhe shoqëri aksionare, me qëllim që kjo njësi të jep ndihmesën e saj për ngritjen dhe funksionimin e njësive të auditimit të brendshëm në shkallë vendi.DH/AB nuk ka të dhëna të sakta lidhur me mbulimin me auditim për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme me qëllim që të përcaktohen kapacitetet audituese dhe nevojat për mbulim me auditim në shkallë sistemi me njëren nga format e përcaktuara në nenin 10 “Organizimi i shërbimit të Auditimit të Brendshëm” të Ligjit 114/2015 dt.22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik” dhe në VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar pikat 1 dhe 7, ku përcaktohet se: “Njësitë publike brenda 6 muajve nga data e hyrjes së fugi të këtij vendimi, të kryejnë organizimin e brendshëm për njësinë e auditimit të brendshëm”, megjithëse sipas kërkesave të nenit 24 të Ligjit 114/2015 dt.22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”, për monitorimin e veprimtarisë së AB në nivel kombëtar, DH/AB ka detyrim të realizojë këtë analizë. Problematikat jepen në përgjithësi dhe jo duke cilësuar subjektet problematike në të cilat strukturat nuk janë ngritur dhe funksionojnë në përputhje me kërkesat ligjor.

Në gjykim të grupit të auditimit, Drejtoria e Harmonizimit raporton në reportin vjetor

të KBFP në nivel të përgjithshëm, pavarësisht se në këtë raportim përfshihen **vetëm 129 njësi** (dy më shumë se viti i kaluar), numër që në gjykimin tonë nuk përfaqëson informacion të mjaftueshëm për njësitë të cilat plotësojnë kushtet e nevojshme për ngritjen e njësive të auditimit në nivel qendror, njësi të vetëqeverisjes, institucionë të pavarura dhe shoqëri aksionare.

Pra, DH/AB ka informacion në lidhje me 129 NJAB në nivel sistemi, për institucionet që kanë strukturë AB, institucionet të cilat e marrin këtë shërbim nëpërmjet aktmarrveshjeve dhe institucionet e pavarura dhe bashkitëtë cilat nuk kanë shërbim të auditimit të brendshëm. Në tabelë jepet situata mbi strukturat e NJAB-ve, aktmarrveshjeve dhe institucioneve të cilat nuk e ofrojnë këtë shërbim, në nivel sistemi:

Emërtim	Institucion që duhet të kenë mbulim AB	Institucion më shërbim AB	Bashki pa shërbim AB	Aktmarrve shje	Institucionë të pavarura pa shërbim AB
Numri	?	129	5	11	31

*Burimi: Përpunuar nga KLSH (2020)*

Pra sistemi sipas DH/AB, përfshin 129 NJAB, numër që nuk krahasohet me numrin e institucioneve të cilat duhet sipas ligjit të raportojnë mbulimin më auditim të brendshëm. Për vitin 2019, bashki të cilat nuk kanë mbulim me shërbim auditiminë një nga format e ligjit janë 5, përkatësisht: **Bashkia Belsh; Bashkia Has; Bashkia Pukë; Bashkia Konispol dhe Bashkia Delvinë**. Lidhur me këtë situatë nuk kemi dokumentacion për veprimet që Drejtoria e Harmonizimit/AB ka bërë për të inkurajuar realizimin e shërbimit të auditit të brendshëm sipas një nga mënyrave të përcaktuara në ligj. Për vitin 2019, janë 11 institucionë që kanë një marrëveshje për shërbimin e auditimit

Nr.	Institucion që realizojnë mbulimin me AB me anë të Aktmarrveshjeve
1	Agjensia Telegrafike Shqiptare
2	Shkolla e Magjistraturës
3	Qendra Kombëtare e Kinematografisë
4	Autoriteti i Konkurencës
5	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit
6	Autoriteti Komb. Cert. Elekt. /Sigurime Kibernetike
7	Autoriteti Shtetëror Gjeohapsinor (ASIG)
8	Agjencia për Mbështetje për shoqërinë civile
9	Komisioneri për të Dr. Inform. Mbrojt. Dhënavë Pers.
10	Autoriteti Drejtën e Info. mbi dok.ish-Sigurimit Shtetit
11	Sekretariati i Ujtit

*Burimi: Drejtoria e Harmonizimit të AB (2020)*

Institucionë të pavarura pa mbulim me shërbim auditimi sipas një nga formave të ligjit, për vitin 2019, janë 31

Nr	Institucionë të pavarura pa mbulim me AB
1	Presidencia
2	Aparati i Keshillit te Ministrave
3	Akademie e Shkencës
4	Avokati i Popullit
5	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

6	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
7	Inspektorati i Lartë i Deklarimit e KP dhe KI
8	Komisioneri i Prokurimit Publik
9	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
10	Instituti i studimeve të krimeve të komunizmit
11	Gjykata Kushtetuese
12	Komisioneri i Pavarur i Kualifikimit
13	Kolegji i Posacem i Apelimit
14	Komisioneri Publik
15	Avokatura e shtetit
16	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
17	Këshilli i Lartë i Drejtësisë
18	Drejtoria Sigurimit të Informacionit Klasifikuar
19	Agjencia e Prokurimit Publik
20	Komiteti Shtetëror i Minoriteteve
21	Inspektorati Qendror
22	Qendra kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit
23	Agjencia për Diasporën
24	Agjencia për Hapje, Dialog dhe Bashkeqeverisje
25	Agjencia e Zhvillimit te Territorit
26	Agjencia Autonome e Auditimit te Fondeve të BE
27	Agjensia Kombëtare e Shoqerisë së Informacionit
28	Komiteti Shtetëror i Kulteve
29	Departamenti i Administratës Publike
30	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
31	Agjencine Kombetare te Planifikimit te Territorit

Burimi: Drejtoria e Harmonizimit të AB (2020)

VKM nr. 83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditit të brendshëm në sektorin publik”, ka përcaktuar se: “Njësia e AB përbëhet nga jo më pak se tre punonjës përfshirë dhe drejtuesin e njësisë”, në po të njëjtën pikë të VKM-së së sipërprërmendur vijohet me: ...në strukturën përgjegjëse të njësisë së auditimit të brendshëm mund të punësohen deri në 1/3 e punonjësve të pacertifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik. Nga auditimi është konstatuar:

1. Nga auditimi konstatohet se nga DH/AB në evidencën përbledhëse janë raportuar **47 njësi auditimi me më pak se 3 auditues**. Janë 21 institucione që në strukturën AB kanë vetën 1 punonjës ndërkohe që në Bashkinë Himarë, struktura e auditimit nuk ka asnjë punonjës ndërsa 25 institucione janë më nga 2 punonjës. Theksojmë se si numër edhe për vitin 2019, 36% e strukturave nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në VKM nr. 83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditit të brendshëm në sektorin publik”, për sa i takon plotësisë së këtyre strukturave.

Nr	Institucioni	Në fakt
1	Sherbimi Social Shteteror	2
2	AZHBR	2
3	Drejtoria e Rezervave	2
4	ALBCONTROL	2
5	Drejtoria e Sherb.Qeveritare	2
6	Universiteti Politeknik i Tiranës	2
7	Universiteti Mjekesise	2

8	Kuvendi I RSH	1
9	Prokuroria e Pergjithshme	2
10	Instituti I Statistikave	2
11	Radio-Televizioni Shqiptar	2
12	Drejtoria e Pergj. Arkivave	2
13	Dr.Qend. Op.Kujd.Shend.	2
14	Nj.Vend. Op.Kujd.Shend. Tirane	1
15	Q. Spitalore Vlore	1
16	Spitali Rajonal Gjirokaster	1
17	Spitali Rajonal Durrës	1
18	Spitali Rajonal Elbasan	1
19	Spitali Rajonal Fier	1
20	Spitali Rajonal Shkoder	1
21	Spitali Rajonal Kukës	1
22	Qendra Spitalore Korçë	1
23	Qendra Spitalore Berat	1
24	Qendra Spitalore Lushnje	1
25	Alb Gaz sha	2
26	Ujesjelles Kanalizime Korce	1
27	Ujesjelles Kanalizime Vlore	1
28	Ndermarrja e Trajt.Stud. 1	1
29	Bashkia Skrapar	1
30	Bashkia Klos	1
31	Bashkia Shijak	2
32	Bashkia Gramsh	2
33	Bashkia Librazhd	2
34	Bashkia Prrenjas	2
35	Bashkia Fier	1
36	Bashkia Patos	2
37	Bashkia Tepelenë	1
38	Bashkia Memaliaj	1
39	Bashkia Korce	2
40	Bashkia Maliq	2
41	Bashkia Kolonje	2
42	Bashkia Devoll & B.Pustec	2
43	Bashkia Fushë Arrëz	2
44	Bashkia Vorë	2
45	Bashkia Himarë	0
46	Bashkia Cërrik	1
47	Bashkia Rrogozhinë	2

Burimi: Përpunuuar nga KLSH (2020)

2. Nga auditimi rezultoi se janë 32 institucione që në përbërje të strukturave të NJAB-ve kanë më shumë se 1/3 të punonjësve të pacertifikuar, situatë që bie në kundërshtim me kriterin e Ligjit nr. 114/2015 dt.22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik". Ndërkohë që në 5 prej tyre nuk ka asnjë punonjës të certifikuar në strukturën e NJAB-së.

N R	INSTITUCIONI	Të planifiku	Në fak	Te pa certifiku	Te certifiku	NJAB me	PJESA E PACERTIFI
--------	--------------	-----------------	-----------	--------------------	-----------------	------------	----------------------

		ar	t	ar	ar	vende vakant e	K
1	Spitali Rajonal Fier	1	1	1			1
2	Qendra Spitalore Lushnje	1	1	1			1
3	Bashkia Kuçove	3	3	3			1
4	Bashkia Skrapar	1	1	1			1
5	Bashkia Rrogozhine	2	2	2			1
6	Agjensia e Ofrimit te Sherb. Pub.te Integruara	3	3	2	1		2/3
7	Fondi Shqiptar I Zhvillimit	3	3	2	1		2/3
8	Ujesjelles Kanalizime Pogradec	3	3	2	1		2/3
9	Ujesjelles Kanalizime Shkoder	3	3	2	1		2/3
10	Bashkia Ura Vajgurore	3	3	2	1		2/3
11	Bashkia Dibër	3	3	2	1		2/3
12	Bashkia Mat	3	3	2	1		2/3
13	Bashkia Bulqize	3	3	2	1		2/3
14	Bashkia Roskovec	3	3	2	1		2/3
15	Bashkia Divjakë	3	3	2	1		2/3
16	Bashkia Pogradec	3	3	2	1		2/3
17	Bashkia Kukës	3	3	2	1		2/3
18	Bashkia Vau Dejes	3	3	2	1		2/3
19	Bashkia Selenicë	3	3	2	1		2/3
20	Bashkia Kurbin	3	3	2	1		2/3
21	Bashkia Peqin	3	3	2	1		2/3
22	AZHBR	4	2	1	1	1	½
23	Universiteti Politeknik I Tiranës	2	2	1	1		½
24	Radio-Televizioni Shqiptar	3	2	1	1	1	½
25	Drejtoria e Pergj. Arkivave	3	2	1	1	1	½
26	Bashkia Shijak	3	2	1	1	1	½
27	Bashkia Gramsh	2	2	1	1		½
28	Bashkia Prrenjas	2	2	1	1		½
29	Bashkia Patos	3	2	1	1	1	½
30	Bashkia Maliq	3	2	1	1	1	½
31	Bashkia Lezhe	4	4	2	2		½
32	Dr.Pergj.Tatim Taks.Vendore	5	5	2	3		2/5

Burimi: Përpunuuar nga KLSH (2020)

3. Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Harmonizimit të NJAB rezultoi se në NJAB-të egzistuese për vitin 2019, ka struktura te paplotësuara, të cilat paraqiten si në tabëlën mëposhtme. Konstatohet se 36 institucione kanë struktura të paplotësuara (vakanca në strukturat AB).

Nr	Institucioni	Vende vakante në NJAB	Struktura e miratuarmi NJA	% ndaj totalit
1	Ministria e Financave &	1	7	13%
2	Ministria e Infra. & Energjisë	1		14%
3	Ministria e Drejtësise	1	4	20%
4	Ministria e Mbrojtjes	1	7	13%

5	Drejt.Pergj.Tatimeve	1	8	11%
6	Sherbimi Social Shteteror	1	2	33%
7	AZHBR	1	2	33%
8	Drejtoria e Rezervave	1	2	33%
9	Agjensia Shteterore e Kadastres	1	4	20%
10	Drejtoria e Sherb.Qeveritare	1	2	33%
11	Universiteti i Tiranes	1	4	20%
12	Universiteti Mjekesise	1	2	33%
13	Kuvendi I RSH	1	1	50%
14	Instituti I Statistikave	1	2	33%
15	Radio-Televizioni Shqiptar	1	2	33%
16	Drejtoria e Pergj. Arkivave	1	2	33%
17	Dr.Qend. Op.Kujd.Shend.	1	2	33%
18	Nj.Vend. Op.Kujd.Shend. Tirane	1	1	50%
19	Sh.a.Albpetroli Fier	1	6	14%
20	OSHEE sha	1	22	4%
21	Alb Gaz sha	1	2	33%
22	Agro Kredit	1	3	25%
23	Bashkia Shijak	1	2	33%
24	Bashkia Librazhd	1	2	33%
25	Bashkia Fier	1	1	50%
26	Bashkia Patos	1	2	33%
27	Bashkia Memaliaj	1	1	50%
28	Bashkia Dropull	1	4	20%
29	Bashkia Korce	1	2	33%
30	Bashkia Maliq	1	2	33%
31	Bashkia Kolonje	1	2	33%
32	Bashkia Devoll & B.Pustec	1	2	33%
33	Bashkia Fushë Arrëz	1	2	33%
34	Bashkia Tiranë	1	9	10%
35	Bashkia Vorë	1	2	33%
36	Bashkia Himarë	1	0	100%

Burimi: Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm (2020) dhe KLSH

Po ti referohemi, gëndjes së strukturave që kanë raportuar pranë DH/AB referuar plotësisë së tyre por edhe përputhshmërisë me kërkesat ligjore për ngritjen dhe funksionimin e tyre, konstatohet se në fund të vitit 2019,kemi rreth 28% të strukturave të paplotësuara, ndërkojë që 20% e audituesve në strukturat AB janë të pacertifikuar.Trendi ndër vite pasqyrohet në tabelën e mëposhtme.

Përshkrimi/Vitet	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Numri i njësive të auditimit	106	100	103	112	119	127	129
Pozicioni të auditimit të plotësuara (në %)	95%	93.9%	92%	93%	93%	91%	72%
Auditues aktual të certifikuar (në %)	85%	82.9%	90%	76%	77%	77%	80%
Trendi (+/-)		-2%	8%	-18%	1%	-77%	3%

Burimi: Përpunuar nga KLSH (2020)

Nga auditimet e realizuara nga KLSH në njëistë e vetëqeverisjes vendore, kemi konstatuar komandim të punonjësve në pozicionin e “Inspektorit të Auditit”, në kundërshtim me nenin 48, pika 1, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Bashkitë: Delvinë, Rrogzhinë. Struktura

përgjegjëse AB jo vetëm nuk ishin të plota por edhe të pa kualifikuara.  
**Bashkitë:** Shkodër, Patos, Himarë, Klos, Rrogozhinë, Cërrrik, Skrapar, Maliq

**Kriteri:** Neni 10 “Organizimi i shërbimit të Auditimit të Brendshëm” të Ligjit 114/2015 dt.22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik” dhe në VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar pikat 1 dhe 7

**Impakti:** Raportim jo i plotë i mbulimit me auditim të brendshëm në njësitë publike. Struktura të papërshtatshme për të garantuar pavarësinë dhe cilësinë e punës së auditit të brendshëm në rang sistemi

**Shkaku:** DH/AB nuk ka vepruar në funksion të përgjegjësive të saj për kryerjen e një analize të nevojave të mbulimit me auditim të brendshëm të njësive publike, duke u mjaftuar vetëm me të dhënat e dorëzuara nga vetë njësitë publike. Mungesa e masave administrative dhe disiplinore

**Rendësi:** E lartë

### 3. Efektiviteti i ulët i njësive të AB, reflektuar në numrin e ulët të angazhimeve dhe gjetjeve të raportuara gjatë vitit 2019

**Situata:** Nga verifikimi i raportimit të NJAB-ve lidhur me auditimet e kryera, është kryer analizimi i këtyre të dhëna respektivisht me numrin e audituesve në këto struktura, për të dhënë një pamje të qartë të ngarkesave të stafit të strukturave të AB, ku vihet re një shpërndarje e parabartë me strukturat e AB dhe numrin e auditimeve të kryera, paraqitur si më poshtë:

Nr.	Institucioni	Realizimi i auditimeve	Auditues në fakt	Aud të realizuara/aududitues
1	Bashkia Rrogozhine	1	2	0,5
2	OSHEE sha	16	22	0,7
3	Drejt.Pergj.Tatimeve	7	8	0,9
4	ALBCONTROL	2	2	1,0
5	Autoriteti Rrugor Shqiptar	3	3	1,0
6	Universiteti Politeknik I Tiranës	2	2	1,0
7	Dr.Qend.Kujd.Shend.	2	2	1,0
8	Bashkia Cërrrik	1	1	1,0
9	Universiteti i Tiranës	5	4	1,3
10	Agjensia e Ofrimit te Sherb. Pub.te Integruese	4	3	1,3
11	Universiteti Bujqesor Tiranës	4	3	1,3
12	Universiteti "Ismail Qemali" Vlore	4	3	1,3
13	Bashkia Kruje	4	3	1,3
14	Bashkia Tiranë	12	9	1,3
15	Drejt.Pergj.Doganave	11	8	1,4
16	Drejtoria e Rezervave	3	2	1,5
17	Radio-Televizioni Shqiptar	3	2	1,5
18	Bashkia Kolonje	3	2	1,5
19	Inst.Sig.Shoqerore	15	9	1,7
20	Kontrolli i Larte i Shtetit	5	3	1,7
21	Ujesjelles Kanalizime Pogradec	5	3	1,7
22	Bashkia Kucove	5	3	1,7
23	Bashkia Roskovec	5	3	1,7
24	Autoriteti Komb. i Ushqimit	6	3	2,0
25	D.P.Transportit Rrugor	14	7	2,0

26	Universiteti "L.Gurakuqi" Shkoder	6	3	2,0
27	Sha OST Tirane	10	5	2,0
28	Hekurudha Shqiptare sha	6	3	2,0
29	Ndermarria e Trajt. Stud 2	6	3	2,0
30	Bashkia Ura Vajgurore	6	3	2,0
31	Bashkia Mallakaster	6	3	2,0
32	Bashkia Tepelenë	2	1	2,0
33	Bashkia Sarande	6	3	2,0
34	Bashkia Selencë	6	3	2,0
35	Fondi i Sg. Kujdesit Shendetesor	19	9	2,1
36	Bashkia Elbasan	13	6	2,2
37	Ministria e Turizmit & Mjedisit	11	5	2,2
38	Ministria e Drejtësise	9	4	2,3
39	Bashkia Dropull	9	4	2,3
40	Bashkia Mirdite	9	4	2,3
41	Spitali Shefzet Ndroqi Tirane	7	3	2,3
42	Ujesjelles Kanalizime Shkoder	7	3	2,3
43	Bashkia Pogradec	7	3	2,3
44	Bashkia Vau Dejes	7	3	2,3
45	Bashkia Malesia e Madhe	7	3	2,3
46	Agjensia Shteterore e Kadastres	10	4	2,5
47	Drejtoria e Pergj. Arkivave	5	2	2,5
48	Bashkia Gramsh	5	2	2,5
49	Bashkia Librazhd	5	2	2,5
50	Bashkia Korçë	5	2	2,5
51	Bashkia Vorë	5	2	2,5
52	Ministria e Kultures	8	3	2,7
53	Autoriteti Portual Durres	8	3	2,7
54	Universiteti "A.Moisiu" Durres	8	3	2,7
55	Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare	8	3	2,7
56	Bashkia Gjirokaster	8	3	2,7
57	Bashkia Kukës	8	3	2,7
58	Bashkia Shkoder	8	3	2,7
59	Bashkia Vlore	8	3	2,7
60	Bashkia Kurbin	8	3	2,7
61	Ministria e Shendetesise & Mb.Sociale	19	7	2,7
62	Ministria e Arsimit, Sportit & Rinisë	14	5	2,8
63	Ministria e Brendshme	23	8	2,9
64	Ministria për Europën & P.Jashtme	15	5	3,0
65	AZHBR	6	2	3,0
66	Enti Komb.Banesave	9	3	3,0
67	Spitali Rajonal Gjirokaster	3	1	3,0
68	Spitali Rajonal Shkoder	3	1	3,0
69	Qendra Spitafore Berat	3	1	3,0
70	Bashkia Berat	9	3	3,0
71	Bashkia Divjakë	9	3	3,0
72	Bashkia Devoll	6	2	3,0
73	Bashkia Tropoje	9	3	3,0
74	Bashkia Lezhe	12	4	3,0
75	Bashkia Kamëz	9	3	3,0
**Shkaku:** Mungesë e kapaciteteve për të realizuar konform ligjit vlerësimin e jashtëm të cilësisë, rrjedhimisht pamundësi e arritjes së përbushjes së objektivit prej 25 vlerësimë të jashtme të cilësisë të vendosur në pikën 7.2.1 të Manualit të AB.

**Rëndësia** E lartë

;

#### **7. Mbi problematikat e konstatuara në procesin e njohjes së certifikatave ndërkombëtare të AB**

**Situata:** Ligji nr. 114/2015 datë 15.10.2015 "Për Auditin e Brendshëm në Sektorin Publik", në numri 19 "Certifikimi i audituesve të brendshëm" ka përcaktuar se "1. Certifikimi i audituesve të brendshëm organizohet nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, sipas procedurës së miratuar me urdhër të Ministrit të Financave. 2. Të drejtën për të aplikuar në procesin e certifikimit e kanë individët e klasifikuar në shkronjën "ç", të pikës 2, të nenit 11, të këtij ligji. 3. Individët, që zotërojnë një certifikatë profesionale, të njohur ndërkombëtarisht, në fushën e auditimit të brendshëm, i nënshtronen një procedure specifike certifikimi, të përcaktuara në urdhrrin e nxjerrë sipas pikës I të këtij neni".

Rregullorja e Trajnimit të Vlijeshëm Profesional të Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar sipas urdhrit nr. 3, datë 08.01.2016 të Ministrit të Financave:

Neni 9 "Kriteret dhe procedurat e regjistrimit të kandidatëve", pika 2 përcakton se: "Të drejtën për të aplikuar në procesin e certifikimit e kanë punonjësit që plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligjin e AB në sektorin publik si më poshtë:

Të kenë diplomë universitare të nivelit të dytë në shkencat ekonomike, juridike dhe disiplina të tjera, sipas nevojave të sektorit që auditohet;

Të kenë përvojë pune 3 vjet në profesion;

Të jetë i punësuar në njësitë e auditimit të brendshëm në sektorin publik...

Neni 19 "Certifikimi i audituesve të brendshëm"

1. Certifikimi i audituesve të brendshëm organizohet nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, sipas procedurës së miratuar me urdhër të Ministrit të Financave.

2. Të drejtën për të aplikuar në procesin e certifikimit e kanë individët e klasifikuar në shkronjën "ç", të pikës 2, të nenit 11, të këtij ligji.

3. Individët, që zotërojnë një certifikatë profesionale, të njohur ndërkombëtarisht, në fushën e

auditimit të brendshëm, i nënshtronen një procedure specifike certifikimi, të përcaktuara në

urdhrin e nxjerrë sipas pikës 1 të këtij nenit.

Nenit 11, pika 2, shkronja "ç"

ç) punonjësi, që nuk zoteron certifikatën si "Auditues i brendshëm", por ka përvojë pune 3 vjet në profesion, punësohet në njësinë e auditimit të brendshëm dhe gjatë 2 viteve të para punon nën mbikëqyrjen e eprorit të drejtpërdrejtë. Brenda kësaj periudhe ky punonjës duhet t'i nënshtrohet detyrimisht procedurës së certifikimit si "Auditues i brendshëm". Në rast se brenda këtij afati punonjësi nuk certifikohet si "Auditues i brendshëm", punonjësit i ndërpriten marrëdhëniet e punës në njësinë e auditimit të brendshëm, të cilat konsiderohen se janë ndërprerë për shkak të këtij ligji. Për sa më sipër, konstatohet se për punonjësit që aplikojnë të certifikohen si auditues të brendshëm si kriter kërkohet që të jenë punonjës të auditit të brendshëm në sektorin publik, në një kohë ku për njësimin e certifikatave ndërkombëtare nuk shikohet plotësimi i këtij kriteri, duke cënuar kushtet e barazisë për pajisjen me certifikatën e auditit të brendshëm në sektorin publik. Vlerësimi i kritereve për personat që kërkojnë të certifikohen do të jetë në focus të auditimit të rradhës për sa kohë që procesi sapo ka nisur (2020)

1. Gjatë periudhës objekt auditimi, nëpërmjet shkresës nr.8174 prot, datë 06.05.2019 është bërë kërkesë me subjekt "Kërkesë për njohje të certifikatës profesionale ndërkombëtare CIA" [REDAKTUE], drejtar Drejtorisë së Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, Ministria e Financave.

Bashkangjitur kësaj kërkesë për aplikim janë paraqitur dokumentet si mëposhtë:

- a. *Certifikatën e Kualifikimit Profesional të marrë jashtë vendit CIA, fotokopje e përkthyer dhe e noterizuar (4 faze).*
- b. *Programin e Certifikimit CIA të IIA-së, fotokopje e përkthyer dhe e noterizuar (22 faze).*
- c. *Dokument Identifikimi (1 faza).*
- d. *Diplomë e Universitetit të Tiranës, dega Finance-Kontabilitet (Sistemi 4-vjecar) (1 faza).*

Nëpërmjet shkresës nr.8174/1 prot, datë 31.05.2019 është bërë "Kthim Përgjigje", ku i kërkohet aplikueses që të tërheq dosjen, dhe të pajisë dokumentat me vulë apostile, sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit 21 "Procedura e njohjes së certifikatës profesionale ndërkombëtare".

Nëpërmjet shkresës nr.8174/2 prot, datë 01.07.2019 "Kërkesë për njohje të certifikatës profesionale ndërkombëtare CIA", është bërë sqarimi nga [REDAKTUE], se pasi ka paraqitur pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dosjen, e cila është kthyer mbrapsht nga ky institucion me arsyetimin se *Certifikata CIA dhe Programi i Certifikimit CIA i IIA, nuk janë objekt legalizimi me vulë apostile*. Gjithashtu për vulën apostile është kontaktuar edhe "The Institute of Internal Audits" (IIA), ku përgjigja e tyre me shkrim ka qenë që nuk mund të lëshojmë vulë apostile mbi certifikatën por mund t'ju mundësojmë letër verifikimi të certifikatës së noterizuar. Dhe nëpërmjet kësaj shkrese është bërë ri-kërkesë për aplikim për njohjen e certifikatës.

Nëpërmjet shkresës nr.8174/3 prot, datë 07.08.2019 "Kërkesë për njohje të certifikatës profesionale ndërkombëtare CIA", është bërë kërkesë për tu njoftuar në lidhje me vendimin e komisionit KKAB, sepse ka kaluar afati 20 ditorë pune që komisioni të shprehej me vendim në lidhje me kërkesën e bërë për njohjen e

certifikatës profesionale ndërkombejtare.

Nëpërmjet shkresës nr.8174/4 prot, datë 08.08.2019 "Kthim përgjigje" është dhënë përgjigje shkresës nr.8174/3 prot, datë 07.08.2019, ku komisioni pasi administrojë dokumentacionin e paraqitur me shkresës nr.8174/2 prot, datë 01.07.2019, shqyrtoji përbajtjen e tij dhe me Vendimin nr.36, datë 05.07.2019 vendosi:

Të kërkoi informacion zyrtar nga Albanian Institute of Auditors për afatin e vlefshmërisë së certifikatës nr.14519 të Znj. Dallandyshe Cela lëshuar nga IIA (Shtator 2016), programin e këtij niveli certifikimi, si dhe shpjegime cfarë nënkuption afati i përkohshëm i kësaj certifikate"

Me shkresën nr.12880, datë 05.07.2019 "Kërkesë për Informacion", drejtuar Albanian Internal Auditors është kërkuar pajisja me informacionin e sipërcituar (Kryetarja e KKAB është pjesë e Bordit të Albanian Internal Auditors). Në vijim, Albanian Internal Auditors me shkresën nr.12880/1, datë 16.07.2019 'Kthim Përgjigje", ka përcjellë informacionin e kërkuar nga KKAB dhe ky i fundit do të shprehet me vendim në mbledhjen e tij më të afërt.

Nëpërmjet shkresës nr.12880/1, datë 16.07.2019 'Kthim Përgjigje" është shprehur se: "Për të mbajtur aktiv statusin e certifikatës, çdo profesionist i certifikuar duhet të fitojë dhe raportojë tek IIA 40 orë kreditë CPE, përfshirë 2 orë trajnim mbi etikën. Ky raportim duhet të bëhet brenda datës 31 Dhjetor të çdo viti. Nëse një i certifikuar dështon në plotësimin e raportimit brenda afatit të CPE-ve të kërkua, statusi i certifikatës bëhet "jo-aktiv" dhe certifikata nuk mund të përdoret derisa të plotësohen kërkuesat. Nëse statusi i certifikatës qëndron "jo-aktiv" për më shumë se 12 muaj për shkak të mosraportimit, të certifikuarit i caktohen penalitetë përiaktivizimin e certifikatës. Është dhënë edhe ëebosit i IIA, për informacione më të detajuara.". Nëpërmjet shkresës nr.12880/1, datë 16.07.2019 "Dërgohet vendimi i komisionit", është përcjellë Vendimi Nr. 37, datë 06.09.2019 i KKAB.

KKAB në Vendimin Nr.37, datës 16.07.2019, Protokolluar nr.16208 prot, datë 10.09.2019) vendosi që:

1. Rrëzimin e kërkësës [REDACTED] dhe mosnjohjen e certifikatës profesionale ndërkombejtare "Certified Internal Auditor" (CIA) të lëshuar nga Instituti Global i Audituesve të Brendshëm, sipas arsyetimit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim i komunikohet kërkueses [REDACTED] dhe strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm.

Vendimi nuk ka qënë unanim.

Nëpërmjet shkresës nr.16749, datë 19.09.2019 me subjekt "Ankesë për mosnjohje nga Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm në sektorin publik (KKAB) të certifikatës profesionale ndërkombejtare- CIA, dhënë nga IIA", i është drejtuar [REDACTED].

Nëpërmjet shkresës nr.16749, datë 19.09.2019 është dërguar pranë KKAB për të vlerësuar ankimin nr.16749, datë 19.09.2019.

KKAB në Vendimin Nr.38, datës 03.10.2019, protokolluar nr.17971 prot, datë 08.10.2019) vendosi që:

1. Të konsiderojë si të pambështetur shkresën nr.16749/I, datë 27.09.2019 të

*strukturës përgjegjëse të harmonizimit për auditimin e brendshëm, për rivlerësimin e vendimit nr.37, datë 06.09.2019 “Për mosnjohjen e certifikatës “Auditues i Brendshëm i Certifikuar” (CIA) të lëshuar nga Instituti Global i Audituesve të Brendshëm”, për shkak se nuk ka bazë të mjaftueshme ligjore dhe faktike për rishikimin e vendimit nr.37, datë 06.09.2019.*

2. *Ky vendim i komunikohet kërkueses [REDAKTUE] dhe strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm.*

**Nga verifikimi në ëbsite të ILA, nga grapi i auditimit rezulton se [REDAKTUE] zotëron certifikatën ndërkombëtare të Audituesit të Brendshëm të certifikuar. Qendrimi i KKAB në lidhje me njohjen e certifikatave nderkombetare në gjykimin e grupit të auditimit është i pajustifikuar dhe i paargumentuar ligjërisht.**

**Kriteri:** Rregullorja e Trajnimit të Vlijueshëm Profesional të Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar sipas urdhrit nr.3, datë 08.01.2016 të Ministrit të Financave: Ligji

Neni 9 “Kriteret dhe procedurat e regjistrimit të kandidatëve”, pika 2 përcakton se:  
“ Të drejtën për të aplikuar në procesin e certifikimit e kanë punonjësit që plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligjin e AB në sektorin publik si më poshtë:

- Të kenë diplome universitare të nivelit të dytë në shkencat ekonomike, juridike dhe disiplina të tjera, sipas nevojave të sektorit që auditohet;
- Të kenë përvojë pune 3 vjet në profesion;
- Të jetë i punësuar në njësitë e auditimit të brendshëm në sektorin publik...

Neni 21 “Procedura e njohjes së Certifikatës Profesionale Ndërkombëtare”, përcakton se:

1) Njohja zyrtare e certifikatës profesionale në fushën e auditimit të brendshëm, bazohet në parimin e ngjashmërisë së programeve/moduleve profesionale të trajnimit të kryer nga aplikantët jashtë vendit në masën 75%, me programin/modulet e certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik, të miratuar nga Komisioni.

2) Baza e vlerësimit të programeve dhe kurseve profesionale të kryera jashtë vendit në fushën e auditit të brendshëm janë programet/modulet e trajnimet, koha e studimit, si dhe kualifikimet që përcaktohen nga kuadri ligjor i vendit të origjinës, krahasuar me kuadrin ligjor dhe nënligjor shqiptar.

3) Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditit të brendshëm, në përputhje me kërkzesat e akteve ligjore në fuqi, me bashkëpunim me Komisionin, ndjek procedurat e njohjes së certifikatave profesionale ndërkombëtare në fushën e auditimit të brendshëm të individëve që i zotërojnë ato, sipas kritereve .....

4) Dokumentat e përcaktuara në pikën ii) dhe iii) të gërmës b) të këtij nenit, duhet të janë origjinalë ose fotokopje e noterizuar, si dhe të janë të legalizuar me vulë apostule ose nga Ambasada Shqiptare në vendin e huaj ose nga Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë.

5) Komisioni pasi shqyrton dosjen merr vendim për njohjen e certifikatës profesionale ndërkombëtare ose mund të vendosë t’ia kthejë dosjen aplikantit për plotësimë të nevojshme, brenda 20 ditëve pune nga vendosja në dispozicon e dosjes

<b>Impakti:</b>	së aplikantit.
<b>Shkaku:</b>	Paqartësi proceduriale lidhur me njësimin e certifikatës ndërkombëtare si auditues i brendshëm, shoqëruar me standarde të ndryshme lidhur me njohjen apo mosnjohjen
<b>Rëndësia:</b>	Kryerja e analizës së fakteve të paraqitura nga kandidati në mënyrë jo të drejtë
	E lartë

### **Observacioni i Subjektit**

Pas dërgimit të konkluzioneve dhe rekomandimeve lidhur me aktivitetin e Drejtorisë së Hramonizimit AB, subjekti i audituar ka paraqitur observacione dhe komente si më poshtë vijon:

Përsa i përket Rekomandimit nr 1, rekomandimi është pranuar dhe ka filluar të zbatohet

Përsa i përket Rekomandimit nr 2 DH/AB është shprehur se ka të dhëna të sakta në lidhje me shtrirjen e shërbimit të auditit të brëndshëm, si dhe ka realizuar një analizë të plotë në shkallë sistemi gjatë përgatitjes së bazës nënligjore, por nga grupi i auditimit duhet të merret në konsideratë që çdo vit kalendarik ka ndryshime strukturore të njësive publike (shkrirje ose krijim njësish të reja). Rekomandimi pranohet dhe ka filluar të zbatohet

Përsa i përket Rekomandimit nr 3 rekomandimi është pranuar dhe ka filluar të zbatohet

Përsa i përket Rekomandimit nr 4 DH/AB është shprehur se në zbatim të gërmës “a” të nenit 24 të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, DH AB çdo vit kalendarik, në funksion të hartimit të Planit të Konsoliduar Strategjik dhe Vjetor të veprimittarive të NJAB-ve, gjatë fazës dhe procesit të hartimit të Planit të Konsoliduar respektiv ka kryer monitorimin dhe vlerësimin e këtyre planeve, ku krahas dokumentimit dhe identifikimit korrekt të çështjeve që lidhen me këto procedura, ndërmjet të tjerave ka konstatuar se disa Njësi të Auditimit të Brendshëm nuk kanë qënë në nivelin e kërkuar në drejtim të respektimit të standardeve që lidhen me hartimin dhe miratimin e këtyre planeve.

Rekomandimi pranohet dhe ka filluar të zbatohet

Përsa i përket Rekomandimit nr 5 4 DH/AB është shprehur se Opinion i DH AB lidhur me vlerësimin e efektivitetit të NJAB mbështetet në: “Metodologjinë për monitorimin e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm të njësive publike”, miratuar me Urdhër nr.117, datë 01.04.2019 të Ministrit të Financave e cila ndër të tjera përcakton pikëzimin dhe llogaritjen e treguesve kryesorë dhe të performancës së NJAB. Performanca e strukturave të AB matet me tregues specifikë që shërbejnë për të vlerësuar arritjen e objektivave strategjikë dhe operacionale të NJAB dhe referenca e përdorur nga grupi i auditimit për vlerësim bazuar në nivelin, shkallën dhe masën e gjetjeve të konstatuara pranë strukturave të audituara nuk është e bazuar në kuadrin rregullator dhe metodologjik të miratuar.

Standartet Ndërkombëtare për praktikën profesionale, miratuar Urdhrin nr.40, datë 08.05.2017 të Ministrit të Financave, që vendosin bazën për vlerësimin e performancës së auditimit të brendshëm ndër të tjera më specifikisht në paketën e Standardeve të Performancës lidhur me efektivitetin e veprimitarisë së NJAB-ë në asnjë rast nuk përcaktojnë numrin e gjetjeve si kriteri për vlerësimin e perfomancës së auditimit të brendshëm. Rekomandimi pranohet pjesërisht dhe ka filluar të zbatohet

Përsa i përket Rekomandimit nr 6 rekomandimi është pranuar dhe ka filluar të zbatohet

Përsa i përket Rekomandimit nr 7 DH/AB është shprehur se në lidhje me këtë rekomandim DH/AB do t'i drejtohet Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për marrjen e mendimit për vendimin e KKAB dhe se si do të procedohet më tej.

Nsërkohë për këtë cështje kanë ardhur observime të KKAB, ku cilësohet ndër të tjera: “Në rast se grupi i auditimit vlerëson se parashikimet e akteve ligjore ose nënligjore për ligjin “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” mund të krijojnë hapësira për mosrespektim të barazisë, atëherë grupi i auditimit mund të paraqesë rekomandime për ndryshime të këtyre akteve. Problematikat

*që konstatohen në mënyrën e formulimit të akteve nënligjore, vlerësojmë se nuk mund të shërbejnë për të ngarkuar me përgjegjësi funksionarët publik. Krahasimi që bëhet me vendimarrjet e mëparshme nuk i shërben dhënies së një konkluzioni të drejtë pasi nuk i referohet rasteve specifike dhe nuk argumenton nëse këto raste përfshihen brënda periudhës kohore të objektit të auditimit.”*

**Qëndrimet e Audituesve Shtetërorë të KLSH:** Në trajtimin e bërë lidhur me kërkeshën e ardhur për njohje certifikate, kemi konstatuar inkosistencë në mënyrën se si lexohet dhe zbatohet kuadri rregullativ. Fakti që lloji i certifikatave ndërkombëtare që mund të njihen nuk është ërcaktuar në ligj, nuk do të thotë që KKAB si një institucion me integritet profesional të lartë të ketë qasje të pa standartizuar. Për të mos u ndalur në argumenta dhe kundërargumenta që nuk e ndihmojnë vendimarrjen e drejtë, pyetja që shtohet në këto raste është se nëse për KKAB nuk është e vlefshme certifikata e audituesit të brendshëm të lëshuar nga IAL, cila është ajo certifikatë ndërkombëtare që i përshtatet më mirë kurikulës në Shqipëri?

Në gjykimin tonë, saktësimi i kuadrit rregullator është njëra anë, por nuk justifikon as vendimarrjen për njohjen e “certifikatave” nga trajnimet e Bankës Botërore, dhe as vendimin e mosnjohjes për certifikatën ndërkombëtare të lëshuar nga IAL.

Në gjykimin tonë, Ministri i Financave dhe Ekonomisë është përgjegjës për analizimin e vendimarrjeve për këto certifikata dhe saktësimin e llojit të certifikataës të vlefshme për njohje në mënyrë që vendimarrja të mos jetë selektive dhe rast pas rasti. Në këtë linjë, e nevojshme është edhe vlerësimi i përgjegjësive individuale të KKAB.

### **III.2 AUDITIM MBI DREJTORINË E HARMONIZIMIT TË MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIN**

**1. Mbi nivelin e raportimit të njësive publike pranë DH/MFK është i ulët dhe nuk përfshin përvec të tjerave shoqëritë aksionere, organizatat jo fitimprurëse, autoritete të përbashkëta (kjo pas ndryshimeve ligjore të Ligjit nr.110/2015) megjithëse ato vijojnë të raportojnë mbi sistemet e auditit të brendshëm pranë DH/AB**

**Situata:** Referuar Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 ndryshuar me Ligjin

nr.110/2015, datë 15.10.2015, neni 3 “Fusha e Zbatimit të Ligjit” cilëson “Ky ligj zbatohet në njësitë publike, ku, sipas këtij ligji, përfshihen: 1. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme. 2. Shoqëritë tregtare, organizatat jo fitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta, të cilat zoterohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme. 3. Njësi të tjera që shpenzojnë fonde publike, sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare”, ndërkohë me ndryshimet nenit 18 (pika 1) i tij përcakton se vetëm “Nëpunësi autorizues i njësisë publike, sipas pikës 1, të nenit 3, të ketij ligji, në bazë të vetëvlerësimëve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të viti aktual. Për të realizuar detyrimin e tij, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të zbatojë një sistem të brendshëm raportimi për të marrë informacion nga njësitë e varësisë, për të mbështetur deklaratën”, pra janë përjashtuar nga përgjegjësia për përgatitjen e pyetësorëve të vetëvlerësimit dhe raportit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe dorëzimin e tyre tek nëpunësi i parë autorizues, **njësitë publike të përfshira në pikën 2, dhe 3 të nenit 3:** Shoqëritë tregtare, organizatat jo fitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta, të cilat zoterohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme si dhenjësi të tjera që shpenzojnë fonde publike, sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare”. Raportimi pranë Nëpunësit të Parë Autorizues dhe DH/MFK, kufizohet vetëm tek njësitë e qeverisjes së përgjithshme, në ndryshim me ligjin e auditimit të brendshëm ku fusha e zbatimit dhe raportimi pranë DH/AB është e njëjtë. Në sistemin e thesarit operojnë mbi 1400 ente publike, ndërkohë kufizimi i dërgimit të pyetësorëve vetëm në 150 njësi, reflekton një nivel mbulimi me monitorim shumë të ulët duke vënë në diskutim gjithë raportin mbi sistemet e kontrollit të brendshëm të përgatitur nga DH/MFK. Gjithashtu konstatohet se raportimin mbi sistemet e kontrollit të brendshëm nuk e bëjnë shoqëritë aksionere dhe organizatat jo fitimprurëse, njësi të cilat raportojnë mbi sistemet e auditit të brendshëm megjithëse ky është koponent i sistemeve të kontrollit. Megjithë këmbënguljen e KLSH, për disa vite rresht, konstatojmë se entet ku është dërguar shkresa për pyetësorin e vetëvlerësimit si dhe niveli i përgjigjeve mbetet larg asaj që quhet mbulim për dhënie opinioni, fakt që tregon mos vlerësim të situatës edhe pse janë vënë në dijeni që nuk reflekton nivelin real të sistemeve.

Nga analiza e listës së subjektive të cilave ju është dërguar pyetësori konstatohet se kemi edhe njësi varësi të strukturave qëndrore, fakt që sjell numër më të kufizuar të enteve mbi të cilat është bazuar vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm në vend. Pra raportimi ështësi rezultat më pak gjithëpërfshirës. Nga ana tjetër rakordimi i raportimit të dy strukturave pjesë të DH/KBFP, i munguar deri tanë reflekton një raportim mbi situatën e kontrollit të brendshëm, bazuar në raportime të strukturave

<b>Kriteri:</b>	tëndryshme, duke sjellë një raportimin vjetor të KBFP me pamje jo të plotë dhe gjithëpërfshirëse për përgjithësimë në nivel kombëtar.
<b>Neni:</b>	3 i ligjit nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”
<b>Impakti:</b>	Raporti vjetor i KBFP nuk është përfaqësues i sektorit publik sipas kërkeseve tënenit 3 pika 1, pasi të dhënat e përpunuara bazohen vetëm tek një numër i vogël njësish. Ka mos rakordim të strukturave që raportojnë sistemet MFK dhe AB.
<b>Shkaku:</b>	Ndryshimi ligjor duke hequr nga përgjegjësia për raportimin pranë NPA të pyetësorëve dhe raporteve të MFK për njësitë e pikës 2 & 3 të nenit 3 të ligjit të MFK.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë

2. Raportimi bazuar në të dhënat vetëm të pyetësorëve të vetëvlerësimit, nuk reflekton situatën reale të sistemeve të kontrollit në njësitë publike. Pyetësorët e vetëvlerësimit mbartin si gabime njërzore si deklarime të pasakta të cilat jo vetëm nuk kontrollohen por as nuk ndëshkohen në rastin kur ato evidentohen. Nga testimi i bërë nga KLSH për të paktën 20% të njësive të vetëqeverisjes vendore të raportuara në Raportin Vjetor, konstatuan devijacione materiale.

**Situata:** Pyetësori i vetëvlerësimit KBFP është miratuar me urdhrin nr. 117, datë 01.04.2019 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë. DH/MFK ka kryer njoftimin e 150 njësive publike për dorëzimin e tij pranë nepunësit të pare autorizues sipas ligjit “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. Ndryshimi i pyetësorit nuk është shoqëruar me rishikim të manualit të MFK miratuar me urdhrin nr. 108 datë 17.11.2016, me qëllim përshtatjen e tij me ndryshimet në mënyrën e vlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Konstatohet se raportimi përfundim se efekt të treguesve të kontrollit të brendshëm financiar publik është bazuar në të dhënat e dorëzuara nga njësitë publike. Nga grupi i auditimit u analizuan, përgjigjet e pyetësorëve të vetëvlerësimit përfundim se Bashkitë që kanë raportuar dhe arritëm në përfundim se në vitin 2019, vijon të mos jetë rishikuar nga DH/MFK, përfundim se rezulton të jëtë kryer asnjë analizë e pyetësorëve të dërguara nga njësitë publike, me qëllim përcaktimin e saktësisë dhe konsistencës së plotëtimit të tyre. Kjo analizë rezulton e pakryer si në vecanti përfundim se dhënat e rastit të treguesve të kontrollit të brendshëm financiar publik janë të dhëna e rastit të treguesve të kontrollit të brendshëm financiar publik. Nga auditimi konstatohet se megjithëse është kërkuar nga KLSH, manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me urdhër nr. 108, datë 17.11.2016, vijon të mos jetë rishikuar nga DH/MFK, përfundim se dhënat e rastit të treguesve të kontrollit të brendshëm financiar publik janë të dhëna e rastit të treguesve të kontrollit të brendshëm financiar publik. Vlerësimi i vetëm dhe konsolidimi i të dhënavë nga ana e DH/MFK rezulton të kryhet vetëm përfundim se efekt të indikatorëve të performancës, të cilat përfaqësojnë vetëm 30 pyetje nga pyetësori i vetëvlerësimit, nga 99 që

është totali i tyre. Ky vlerësim bazuar në një kampionim jo përfaqësues dhe në nivele të papërshtatshme mbulimi (30 pyetjeve nga 99 pyetje që përmban pyetësori), shoqërohet me deformim të opinionit mbi këto sisteme në nivel kombëtar.

Kemi konstatuar se në raportin vjetor të KBFP për vitin 2019, nuk është kryer një analizë krahasimore me vitet e mëparshme, referuar shkallës së vlerësimit të institucioneve, me arsyetimin e subjektit të audituar se janë përfshirë 18 indikatorëkrahasuar me 17 indikatorë në vitin 2018. Baza e përdorur për renditjen e ministrive në raportin 2019, nuk mundëson analizimin e pikëve te indikatorëve për vetë institucionin, në mënyrë që të evidentohet nëse kemi një përmirësim ose jo të sistemeve. Referuar analizës së paraqitur për ministritë, kundrejt totalit të mundshëm të pikëzimit për çdo metodologji ndër vite, institucionet rezultojnë kryesisht në rënien, dhe bëjnë përjashtim vetëm 2 nga 11 ministritë, përkatësisht MBZHR dhe MEJP që rezultojnë me rritje referuar të dhënave të raportuara. Të dhënat për bashkitë më të mëdha, Shkodër, Korçë, Lezhë, Kukës, Fier, Elbasan, Tiranë, Durrës, Berat, Dibër, Gjirokastër dhe Vlorë, tregojnë se ato paraqiten me tregues në rënien, me përjashtim të Bashkisë Fier, Tiranë, Gjirokastër dhe Vlorë.

Situata e raportuar në gjykimin tonë nuk reflekton saktësisht situatën reale në sektorin publik, kjo sepse për vlerësimin e indikatorëve për menaxhimin financiar dhe kontrollin janë përzgjedhur 29% e pyetjeve lidhur me Mjedisin e Kontrollit, 33% të pyetjeve të lidhura me komponentin e Menaxhimit të Riskut, vetëm 12% e pyetjeve të lidhura me aktivitetet e kontrollit, 37% e pyetjeve të komponentit Informim dhe Komunikim dhe 100% e pyetjeve të Monitorimit.

Gjithashtu, nga auditimet e realizuara nga KLSH për llogari të zbatimit të buxhetit të vitit 2019, në njësitë e vetëqeverisjes vendore kemi konstatuar që lidhur me komponentin e **Mjedisit të Kontrollit** problematikat janë të ndjeshme duke nisur nga mungesa e rregulloreve të përditësuara të funksionimit, ku të reflektohen ndryshimet strukturore si nëbashkitë Patos, Klos, mungesë të pëershkrimit të përgjegjësive të punonjësve apo mungesë të procedurave të lidhura me shkeljet disiplinore të punonjësve me kontratë apo shkeljeve të etikës si në rastin e BashkiveSarandë, Himarë, Klos, Rrogozhinë, Finiq, Ura Vajgurore; Malësi e Madhe. Gjithashtu në Bashkitë Tepelenë, Klos, Malësi e Madhe, Këshilli i Qarkut Gjirokastër, Divjakë, Rrogozhinë, Finiq, Ura Vajgurore, Patos, Krujë, Berat është konstatuar mungesë të rregullave të dorëzimit të detyrave, trajnimeve të punonjësve si dhe delegimit të detyrave.

Në lidhje me komponentin e **Menaxhimit të riskut**, ka rezultuar se nuk është caktuar koordinatori i riskut, në Bashkitë Finiq, Ura Vajgurore, Rrogozhinë, Sarandë, etj. Nuk është hartuar regjistri i riskut në Bashkitë Tepelenë, Malësi e Madhe, nuk është kryer asnjë procedurë për menaxhimin e riskut në Bashkitë Sarandë, Cërrrik dhe nuk ka të përcaktuar adresim të riskut si dhe nuk janë marrë masa për menaxhimin e tij në bashkitë Finiq, Ura Vajgurore, Skrapar, Cërrrik, Klos, Krujë Himarë

Nuk kanë një strategji të miratuar tërisqeve në Bashkitë Sarandë, Delvinë, Roskovec, Ura Vajgurore, Divjakë, Krujë, Finiq.

Në lidhje me komponentin e **Aktivitetit të kontrollit** kemi konstatuar se ky komponent nuk kuptohet plotësisht në Bashkitë Berat, Roskovec, Skrapar, Klos, Rrogozhinë. Nuk janë hartuar rregulla për proceset e punës ne Bashkitë Tepelenë, Skrapar. Nuk janë hartuar rregulla për ruajtjen e aktiveve, ne Bashkitë Tepelenë, Delvinë, Prefekti i Qarkut Tiranë. Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave, në kundërshtim me pikën 15/b, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011, "Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike" rasti i Bashkisë Dropull, Skrapar, Finiq, Roskovec, Ura Vajgurore, Skrapar, Himarë etj. Gjurma e Auditimit nuk është miratuar në bashkitë Himarë, Delvinë, Finiq, Cërrrik, Ura Vajgurore, Malësi e madhe, Skrapar.

Në lidhje me komponentin e **Informimi dhe komunikimi**, nuk ka problematika të konstataura nga auditimet e realizuara.

Në lidhje me komponentin e **Monitorimit**, ka problematika të lidhura me pikëzimin apriori të pyetësorit konstatuar në Bashkinë Cërrrik apo raportime jo mirë të dokumentuara në bashkitë Sarandë, Krujë, Roskovec, Skrapar Manuali i MFK, urdhri nr. 117, datë 01.04.2019 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, urdhri nr. 28 datë 15.12.2011

**Kriteri:**

**Impakti:**

**Shkaku:**

**Rëndësia:**

**Rekomandimi:**

Raporti mbi sistemet e kontrollit të brendshëm nuk reflekton nivelin real të situatës pasi konstatohet mungesa sigurie në vërtetësinë e të dhënavë të dorëzuara nga njësitë publike

Mungesa e një metodike në plotësimin e pyetësorit të vetëvlerësimit, mungesa e testimeve dhe kontolleve nga ana e DH/MFK dhe mos marrja e masave administrative sipas kërkesave ligjore.

E Lartë

Strukturat e DH/MFK të marrin masat për të bërë testimin e të paktën 50% të numrit të pyetësorëve të vetëvlerësimit përpërfundojnë të dhënat për përgatitjen e Raportit Vjetor mbi sistemet e kontrollit të brendshëm.

Mbi bazën e problematikave të konstataura të hartoheret një udhëzues i plotë që duhet të ndiqet nga entitet publike në plotësimin sa më të saktë të pyetësorëve të vetëvlerësimit

Për të gjitha devijimet që nuk i takojnë gabimeve njerëzore të merren masa administrative dhe disiplinore në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.

**3. Vlerësim i sistemeve të kontrollit të brendshëm bazuar në një kampionim jo përfaqësues dhe në nivele të papërshtatshme mbulimi (30 pyetjeve nga 99 pyetje që përmban pyetësori), shoqërohet me deformim të opinionit mbi këtositësime në nivel kombëtar. Megjithëse është kërkuar edhe vjet nga KLSH, struktura DH/MFK nuk ka vepruar për të garantuar një opinion të bazuar në të dhëna të besueshme dhe të plota.**

**Situata:** Referuar detyrimit të Drejtorisë së Harmonizimit për kryerjen e konsolidimit të raporteve dhe pyetësorëve të vetëvlerësimit të njësive publike, sipas ligjit Nr 10296 datë 08/07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” nenit 26, pika 3 i cili citon se “*Struktura Përgjegjëse e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin ndihmon nëpunësin e parë autorizues dhe Ministrin e Financave përmes monitorimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe përgatitjen e raportit vjetor për gjendjen e menaxhimit financiar dhe kontrollit publik, ku përmblidhet informacioni i marrë, në përputhje me dispozitat e nenit 18 të këtij ligji.*”, u krye analizimi i të dhënave në Raportin Vjetor të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik për vitin 2019. Në këtë raport, Drejtoria e Harmonizimit është shprehur se “*Në vijim, nga analiza e përgjithshme e 17 parimeve të kontrollit të brendshëm konstatojmë se, sistemi i kontrollit të brendshëm për vitin 2019 paraqitet pjesërisht efektiv, ku peshën kryesore në këtë rezultat e zënë mangësitë lidhur me raportimin në kohën e duhur të problematikave të sistemit të kontrollit të brendshëm.*”.

Grupi i auditimit ka konstatuar se për vitin 2019, nuk është kryer një përllogaritje e caktuar, si dhe nuk janë dokumentuar kriteret /indikatorët/ treguesit sipas së cilave DH/KBFP ka konkluduar në një sistem “pjesërisht efektiv”. Nëse për vlerësimin e viteve 2016, 2017, 2018, KLSH ka cilësuar pasaktësi në vlerësim tëtreguesit, pasi ky tregues ishte përcaktuar nga mesatarja e efektivitetit të treguesit të performancës përmes MFK “Gjithëpërfshirja dhe rregullsia e raportimit vjetor mbi sistemet e kontrollit të brendshëm përmes ministritë e linjës, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e pavarura, Grupit 87 të Kryeministrisë dhe njësive shpenzuase me buxhet të madh”, mesatare që jo domosdoshmërisht lidhet me efektivitetin e sistemit, ajo që konstatohet për vitin 2019 është mungesa e plotë e raportimit të treguesit.

Viti	2016	2017	2018	2019
Niveli i efektivitetit i raportuar	79%	85%	72%	Nuk ka raportim
	3.16/4	3.41/4	-	

Edhe për vitin 2019, DH/MFK nuk rezulton të ketë bërë konsolidim të rezultateve të pyetësorëve të vetëvlerësimit për çdo njësi që ka raportuar pranë Drejtorisë apo vlerësim specifik përi situatën e cdo njësie, objektiv ky që solli rishikimin e pyetësorit të vetëvlerësimit. Vlerësimi në pikë sipas përgjigjeve të dhëna në pyetësor është bërë sipas indikatorëve të MFK (përmes matje performance), pra vetëm 30 pyetje të pyetësorit të vetëvlerësimit nga 99 që përbante në total pyetësori.

Konstatojmë se në Raportin vjetor të KBFP për vitin 2019, nuk është kryer një analizë krahasimore me vitin e mëparshëm, referuar shkallës së vlerësimit të institucioneve. Kjo sipas raportit ka ardhur si rezultat i përfshirjes së 18 indikatorëve në vitin 2019, krahasuar me 17 indikatorë në vitin 2018.

Për Ministritë:

Nr	Institucioni	Piket 2017 <sup>1</sup>	2017 %	Piket 2018 <sup>2</sup>	2018 %	Piket 2019 <sup>3</sup>	2019 %	Ndryshimi 2019-

<sup>1</sup>Totali i pikave ne bazë të indikatorëve të marë në konsideratë për atë periudhë ka qenë 600 pikë, dhe përllogaritja në % e efektivitetit në bazë të pikëve të institucionit për vitin 2017 është përllogaritur duke marë parasysh këtë total pikësh.

								2018 <sup>4</sup>
1	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	510	85%	53	78%	47	65%	-16
2	Ministria e Brendshme	495	83%	53	78%	48	66%	-12
3	Ministria e Infrastrukturës dhe Enerqjisë	480	80%	51	75%	43	60%	-15
4	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	530	88%	50	74%	52	72%	-2
5	Ministria e Kulturës	470	78%	49	72%	47	65%	-7
6	Ministria e Mbrojtjes	495	83%	48	71%	44	61%	-10
7	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	500	83%	45	66%	41	57%	-9
8	Ministria e Drejtësisë	485	81%	45	66%	42	58%	-8
9	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	500	83%	45	66%	47	65%	-1
10	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	465	78%	43	63%	52	69%	+6
11	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	500	83%	35	51%	43	60%	+9

Kryerja e krahasimit në bazë të renditjes në të cilën do të konkludojnë institucionet, nuk mundëson analizimin e pikëve te indikatorëve për vetë institucionin, në mënyrë që të evidentohet nëse kemi një përmirësim ose jo të sistemeve. Referuar analizës së paraqitur për Ministratë, kundrejt totalit të mundshëm të pikëzimit për cdo metodologji ndër vite, institucionet rezultojnë **kryesishët në rënien**. Përjashtim bëjnë vetëm 2 nga 11 ministritë që rezultojnë me rritje, përkatësisht MBZHR dhe MEPJ.

Për 12 Bashkitë e mëdha:

Nr	Institucioni	Pikët 2017 <sup>5</sup>	2017 %	Pikët 2018 <sup>6</sup>	2018 %	Pikët 2019 <sup>7</sup>	2019 %	Ndryshimi 2019-2018 <sup>8</sup>
1	Shkodër	415	92%	47	73%	46	68%	-5%
2	Korçë	430	96%	45	70%	39	57%	-13%
3	Lezhë	330	73%	44	69%	37	54%	-15%
4	Kukës	365	81%	42	66%	40	59%	-7%
5	Fier	345	77%	41	64%	51	75%	11%
6	Elbasan	385	86%	40	63%	28	41%	-22%
7	Tiranë	355	79%	40	63%	48	70%	7%
8	Durrës	405	90%	39	61%	38	56%	-5%
9	Berat	395	88%	36	56%	30	44%	-12%
10	Dibër	375	83%	36	56%	17	25%	-31%
11	Gjirokastër	355	79%	36	56%	42	62%	6%
12	Vlorë	340	76%	34	53%	41	60%	7%

Referuar analizës së mësipërme, kundrejt totalit të mundshëm të pikëzimit për cdo metodologji ndër vite, institucionet rezultojnë **kryesishët në rënien**. Përjashtim bëjnë vetëm 4 nga 12 bashkitë e përfshira në analizë që rezultojnë me rritje, përkatësisht Bashkia Fier, Tiranë, Gjirokastër dhe Vlorë. Për vlerësimin e indikatorëve përmenaxhimin financiar dhe kontrollin e njësive janë përzgjedhur pyetje sipas pytësorëve të cilat i kemi paraqitur në tabelën e mëposhtme.

<sup>2</sup> Totali i pikeve ne bazë të indikatorëve të marë në konsideratë për atë periudhë ka qenë 68 pikë, duke marë në konsideratë 17 nga 18 indikatorë, dhe përllogaritja në % e efektivitetit ne bazë të pikëve të institucionit për vitin 2018 është përllogaritur duke marë parasysh këtë total pikësh.

<sup>3</sup> Totali i pikeve ne bazë të indikatorëve të marë në konsideratë për atë periudhë ka qenë 72 pikë, duke marë në konsideratë 18 nga 18 indikatorë, dhe përllogaritja në % e efektivitetit ne bazë të pikëve të institucionit për vitin 2019 është përllogaritur duke marë parasysh këtë total pikësh.

<sup>4</sup> Diferencia në pikë përqindjeje nga viti 2019 në 2018.

<sup>5</sup> Totali i pikeve ne bazë të indikatorëve të marë në konsideratë për atë periudhë ka qenë 450 pikë, dhe përllogaritja në % e efektivitetit ne bazë të pikëve të institucionit për vitin 2017 është përllogaritur duke marë parasysh këtë total pikësh.

<sup>6</sup> Totali i pikeve ne bazë të indikatorëve të marë në konsideratë për atë periudhë ka qenë 64 pikë, duke marë në konsideratë 16 nga 18 indikatorë, dhe përllogaritja në % e efektivitetit ne bazë të pikëve të institucionit për vitin 2018 është përllogaritur duke marë parasysh këtë total pikësh.

<sup>7</sup> Totali i pikeve ne bazë të indikatorëve të marë në konsideratë për atë periudhë ka qenë 68 pikë, duke marë në konsideratë 17 nga 18 indikatorë, dhe përllogaritja në % e efektivitetit ne bazë të pikëve të institucionit për vitin 2019 është përllogaritur duke marë parasysh këtë total pikësh.

<sup>8</sup> Diferencia në pikë përqindjeje nga viti 2019 në 2018.

Komponentët e MFK	Pyetje në pyetësorin e vjetëvlerësimit	Përzgjedhur përvlerësim	Raporti në %
<b>Mjedis i Kontrollit</b>	45 pyetje (pyetjet 1 deri 44)	13 pyetje	29%
<b>Menaxhimi i Riskut</b>	18 pyetje (pyetjet 45 deri 62)	6 pyetje	33%
<b>Aktivitete të Kontrollit</b>	16 pyetje (pyetjet 63 deri 78)	2 pyetje	12%
<b>Informimi dhe Komunikimi</b>	19 pyetje (pyetjet 79 deri 97)	7 pyetje	37%
<b>Monitorimi</b>	2 pyetje (pyetjet 98 deri 99)	2 pyetje	
	<b>99 pyetje</b>	<b>30 pyetje</b>	<b>30%</b>

Në komponentin e **mjedisit të kontrollit**, sipas drejtimeve të tij janë konstatuar:  
**Integriteti dhe vlerat etike**- ka rezultuar se nuk është miratuar kodi i etikës profesionale në bashkitë Himarë, Klos, Rrogozhinë, Finiq, Ura Vajgurore;  
**Struktura organizative**

Rregulloret e brendshme të funksionimit nuk pasqyrojnë ndryshimet e strukturave organizative si në Bashkitë Patos, Klos;

në rregullore nuk janë përcaktuar qartë mënyra menaxheriale dhe përgjegjësit e punonjësve, si dhe raportimi i tyre ne mënyrë periodike. të kontrollit, Bashkia Sarandë.

Në Rregulloren e Funksionimit nuk ka procedura mbi trajtimin e rasteve të shkeljeve apo thyerjes së disiplinës nga ana e stafit, për stafin marrëdhëniet e të cilëve rregullohen me kod pune; në Bashkitë Klos, Malësi e Madhe;

Rregullore të miratuara me shumë vonesë, si AMVV

Mungesë totale e rregullores në Bashkinë Klos.

#### **Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore**

Nuk ka rregulla për dorëzimin e detyrës në rastet e largimit të punonjësve nga puna, Bashkia Tepelenë

Nuk janë kryer trajnime- Bashkitë Tepelenë, Klos, Malësi e Madhe, KQ Gjirokastër, Divjakë, Rrogozhinë, etj.

Lëvizjet e punonjësve për shkak të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, vlerësohen me risk përsa i përket shkallës së kualifikimit të tyre, në bashkitë Finiq, Ura Vajgurore

#### **Delegimi i detyrateve**

nuk ka përcaktuar qartë mënyrën e raportimit nga niveli me i ulët deri tek niveli me i lartë i menaxhimit si dhe detyrat e përgjegjësit e punonjësve nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, pavarësisht se këtë e realizon referuar kompetencave dhe akteve nënligjore në fuqi, duke reflektohar kështu nivel mesatar të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm **Patos, Krujë**,

#### **Berat**

Në komponentin e **Menaxhimi i riskut**,

Nga auditimi ka rezultuar se **nuk është caktuar koordinatori i riskut**, në Bashkitë Finiq, Ura Vajgurore, Rrogozhinë, Sarandë, etj.

Në lidhje me **vendosjen e objektivave** ka rezultuar se nuk ka evidenca dokumentare

ku të jetë miratuar dhe identifikuar deklarata e misionit, objektivat dhe planet strategjike e vjetore në përbushje të këtyre objektivave, Bashkia Cërrik

Procesi i menaxhimit të riskut, adresmi i tij, etj- Nuk janë marrë masa për menaxhimin e riskut, Ura Vajgurore, Malësi e Madhe dhe nuk është hartuar regjistri i riskut Bashkitë Tepelenë, Malësi e Madhe, nuk është kryer asnjë procedurë për menaxhimin e riskut në Bashkitë Sarandë, Cërrik dhe nuk ka të përcaktuar adresim të riskut si dhe nuk janë marrë masa për menaxhimin e tij në bashkitë Finiq, Ura Vajgurore, Skrapar, Cërrik, Klos, KrujëHimarë etj.

**Strategja e Riskut** - nuk ka të miratuar një strategji të risqeve në Bashkitë Sarandë, Delvinë, Roskovec, Ura Vajgurore, Divjakë, Krujë, Finiq, Sarandë, etj.

Në komponentin e Aktivitetit të kontrollit

- **Aktivitet e kontrollit** nuk kuptohen plotësisht në Bashkitë Berat, Roskovec, Skrapar, Klos, Rrogozhinë, etj

- **Procedurat e autorizimit** - Nuk janë hartuar rregulla për listën e proceseve të punës ne Bashkitë Tepelenë, Skrapar, etj

**Procedurat e kontabilitetit të plotë, të vërtetë, të saktë** dhe në kohën e duhur për të gjitha operacionet - Nuk janë hartuar rregulla për ruajtjen e aktiveve, Subjektet Tepelenë, Delvinë, Prefekti i Qarkut Tiranë

**Procedurat antikorrupsion-** në asnjë auditim nuk janë konstatuar procedurat antikorrupsion.

Rregullat që lidhen me të drejtën e hyrjes (aksesin) tek aktivet dhe informacioni - Nuk janë hartuar rregulla për mbrojtjen dhe ruajtjen e të dhënavë elektronike Tepelenë, Rrogozhinë, Roskovec, KQ Gjirokastër, Skrapar

**Aktivitetet e kontrollitqë lidhen me teknologjinë e informacionit-** nuk janë hartuar rregulla dhe nuk janë marrë masa konkrete për mbrojtjen e të dhënavë të sistemit elektronik. Delvinë, Klos, Roskovec

**Procedurat e shkruara** - Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrate, në kundërshtim me pikën 15, germa b, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011, "Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike" Dropull, Skrapar, apo nuk janë nxjerrë urdhra me shkrim përmes mënyrës ushtrimit të veprimtarisë së kontrollit në bashkitë Finiq, Roskovec, Ura Vajgurore, Skrapar, Himarë etj.

**Harta e proceseve të punës** - Njësia e burimeve njerëzore dhe titullari i institucionit, nuk kanë bërë vlerësimin 6 mësjor të rezultateve të punës për 13 punonjësit me statusin e nëpunësit civil në Bashkinë Libohovë apo në Bashkinë Klos kjo procedurë është bërë vetëm për rekrutimet e reja.

**Manuali i proceseve të punës** - Nuk janë hartuar proceset e punës në bashkitë Delvinë, Klos, Rrogozhinë, Cërrik, KQ Gjirokastër

- **Gjurmët e Auditimit** - Nuk janë miratuar gjurmët e auditimit në bashkitë Himarë, Delvinë, Finiq, Cërrik, Ura Vajgurore, Malësi e madhe, Skrapar.

Në komponentin e Informimi dhe komunikimi, në përgjithësi ekziston ky komunikim nëpërmjet komunikimit të brendshëm me elektronikë apo shkresa të brendshme zyrtare, si dhe komunikimi shkresor me të tjerë jashtë institucionit

Në komponentin e Monitorimit.

Në fund të çdo viti vlerësimi i funksionimit të sistemit të menaxhimit finansiar dhe kontrollit nuk është bërë si duhet nga menaxherët kryesor, duke mos përcaktuar pikat e dobëta të këtij sistemi e marrjen e masave për përmirësimin e tij., si dhe nuk ka plan monitorimi Roskovec

- Rolet në procesin e monitorimit - marrja në dorëzim e punimeve të kontraktuara ose furnizimi me materiale sipas kontratave, nuk janë bërë me komisione të ngritura për këtë qëllim. Këto raste janë shkelje e kërkeseve të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ne Bashkitë Finiq dhe Ura Vajgurore

- Procedura e vetëvlerësimit - Sistemi i vetëvlerësimit nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit finansiar dhe kontrollit nuk funksionon pasi pikëzimi (nga 1 në 4) është vendosur apriori dhe është joreal në Bashkinë Cërrik.

-Roli i Auditimit të Brendshëm, Raportimi mbi sistemin e menaxhimit finansiar dhe kontrollit - nuk ka raporte të dokumentuara për zbatimin e sistemeve të menaxhimit finansiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë në bashkitë **Sarandë, Krujë, Roskovec, Skrapar**

Deklarata e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm- janë dërguar në Ministrinë e Financave deklaratën, pyetësorin dhe reportin vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, pa informacionin e Drejtive vartëse, Bashkia Dropull dhe Cërrik.

**Treguesit e Performancës së Sistemeve të Kontrollit të brendshëm bazuar në 3 indikatorë marë në konsideratë dhe pyetjet respektive rezultojnë:**

Treguesi	Mënyra e pikëzimit (vlerësimit)	Komenti grupit të auditimit
12. Hartimi me cilësi i Planit të Veprimit të MFK-së dhe paraqitja brenda afateve kohore të përcaktuara.	Nga pyetësori i vetëvlerësimit janë përzgjedhur pyetjet 89-90 si pyetje respektive të këtij indikatori.	
13. Gjithëpërfshirja dhe rregullsia e raportimit vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm.		Me rishikimin e pyetësorit, është përpiluar edhe një pyetësor për njësitë e varësisë për të cilat institucionet që kanë raportuar pranë MFE duhet të kishin kryer konsolidimin e të dhënavëve dhe vecanërisht ky indikator lidhet me këtë cështje, por faktikisht <u>në asnjë nga pyetësorët e dorëzuar nuk është identifikuar</u> të jetë kryer ky proces. dhe përmë tepër në metodologjinë e vlerësimit të këtij indikatori <u>nuk është parashikuar kryerja e verifikimit nga stafi i drejtorisë për garantimin e gjithëpërfshirjes</u> në vlerësimin e sistemeve të kontrollit nga varësitë.

14. Efektiviteti i mekanizmave bazë të përgjegjshmërisë menaxheriale në njësitë e sektorit publik	Nga pyetësori i vetëvlerësimit janë përzgjedhur 21 pyetjet respektive (5,8,10,17,20,21,22,23,26,27,28,40-45,58-60,62,76,77,79,85-88).	

<b>Kriteri:</b>	Neni 26 pika 3 e ligjit 10296 datë 08.07.2010,i ndryshuar Manuali i MFK, urdhri nr. 117, datë 01.04.2019 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Në pyetësorin e vetëvlerësimit, çështja “Mënyra e vlerësimit”, është përcaktuar se “Në mbështetje të përgjigjeve të njësisë publike, Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit do të nxjerrë konkluzione mbi efektivitetin dhe efikasitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë publike. Vlerësimi i cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm, ndahet në tre kategori: efektiv, pjesërisht efektiv ose joefektiv: 1. Sistemi i Kontrollit të Brendshëm do të konsiderohet efektiv, nëse nuk janë zbuluar asnjë ose janë zbuluar shumë pak dobësi dhe mangësi të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm. 2. Sistemi i Kontrollit të Brendshëm do të konsiderohet pjesërisht efektiv, nëse dobësiti dhe mangësitë e zbuluara vlerësohen si të mesme dhe / ose të ulëta dhe nuk janë zbuluar dobësi të rëndësishme dhe ngjarje të dëmshme për njësinë në zbatimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. 3. Sistemi Kontrollit të Brendshëm do të konsiderohet jo efektiv kur ekziston një mangësi e madhe në lidhje me funksionimin e një komponenti ose parimi përkatës, ose në lidhje me komponentët që veprojnë së bashku në një mënyrë të integruar për të gjithë njësinë dhe kjo mangësi ndikon direkt në moszbatimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.”
<b>Impakt</b>	Raporti mbi sistemet e kontrollit të brendshëm nuk reflekton nivelin real të situatës pasi bazohet në një nivel jo të përshtatshmëm mbulimi të pyetjeve të pyetësorit të vetëvlerësimit. Mos raportim i mangësive të identifikuara në elementët e kontrollit të brendshëm për entet me devijacionet më të mëdha. Mos marrja e masave korektuese
<b>Shkaku</b>	Përdorimi nga DH/MFK i metodologjisë së vlerësimit të performancës si mënyrë vlerësimi për sistemet e kontrollit në rang kombëtar
<b>Rëndës</b>	E lartë

**4. Konstatohet se gjatë vitit 2019, DH/MFK nuk ka kryer monitorimet mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm ndërkoqë që Raporti Vjetor i KBFP, riraporton monitorimet e realizuara për funksionimin e sistemeve të kontrollit të vitit 2018.**

**Situata:** Konstatohet se DH/MFK nuk ka kryer monitorimet mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm për vitin 2019.ndërkoqë që Raporti Vjetor i KBFP, riraporton monitorimet e realizuara për funksionimin e sistemeve të kontrollit të vitit 2018. Në funksion të nenit 25 pika 3 dhe nenit 26 pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar është përgjegjëse për monitorimin sistematik të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësite e sektorit publik

për të vlerësuar nga afér ecurinë e zbatimit të nenit 18 të ligjit të MFK ku përcaktohet se Nëpunësi Autorizues duhet të paraqesë pranë Ministrisë së Financave pyetësorin e vetëvlerësimit, deklaratën dhe raportin mbi cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë publike që mbulon, përvitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual.

Bazuar në manualin e MFK, Kapitulli II “Rolet dhe Aktorët në Sistemin e MFK-së”, pika 2.2.2 përcaktohet se “DH/MFK është gjithashtu përgjegjëse për monitorimin sistematik të sistemeve të MFK-së në njësitë publike. Ajo e kryen këtë monitorim nëpërmjet aktiviteteve që realizon vetë, në bashkëpunim me njësi të tjera publike, si dhe bashkërisht me DH/AB”.

Nga auditimi u konstatua se në kuadër të monitorimeve sistematike të MFK në njësitë publike për përgatitjen e raportit mbi Funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brëndshëm Financiar Publik në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme përvitin 2019, Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar ka planifikuar 17 vizita monitoruese sipas shkresës nr. 2709 prot datë 06.02.2020. Deri në momentin e dorëzimit të raportit vjetor për cilësinë dhe funksionimin e kontrollit të brëndshëm financiar publik nuk rezulton asnjë monitorim i realizuar që mund të jetë pjesë e raportit përvitin 2019 mbi cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm përvit këtë periudhë. Planifikimi i monitorimeve përgjatë gjithë vitit kalendarik, i shërben kësaj drejtorie në zbatim të qëllimit të parë sipas manualit, pra grumbullimi i informacioneve me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të metodologjisë, standardeve dhe udhëzimeve, si dhe vlerësimit tësaktësisë së plotësimit të pyetësorëve të vetëvlerësimit mbi të cilat bëhet raportimi mbi gjendjen e sistemeve.

Në raportin vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar dhe publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme përvitin 2019 konkretisht në kapitullin 3, përcaktohet se përgjatë vitit 2019 janë monitoruar 17 njësi të qeverisjes së përgjithshme. Këto monitorime, i përkasin identifikimit të besueshmërisë në dorëzimin e pyetësorëve të njësive të qeverisjes së përgjithshme pranë DH/MFK përvit gjendjen e sistemeve të këtyre njësive në vitin 2018 (realizuar në muajin shkurt 2019), dhe jo monitorimeve përvit sistemet gjatë vitit 2019 sikundër përcakton raporti vjetor i gjeneruar nga kjo drejtori. Konstatohet se kjo strukturë jo vetëm nuk ka realizuar planin vjetor të miratuar, por ka raportuar punë të parealizuar, raportim që ka sjellë si pasojë që edhe Raporti i Paraqitur nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë përvit Kryeministrin dhe që do shqerojë edhe Raportin e Zbatimit të Buxhetit të vitit 2019, të mbart këtë raportim fiktiv. Njësitë e monitoruara përgjatë vitit 2019 dhe të planifikuara në vitin 2020, paraqiten si më poshtë:

Nr.	<b>Institucionet e rapportuar në Raportin Vjetor të KBFP përvit vizita monitoruese të sistemeve të MF përgjatë vitit 2019<sup>9</sup></b>	<b>Institucionet e miratuara përvit monitorim përvitin 2020 që nuk janë rapportuar në Raportin Vjetor të KBFP</b>
-----	---	---

<sup>9</sup> Pra, vizita qe shprehin gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm përgjatë vitit 2019

1	Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë	Ministria e Brendshme
2	Ministria e Mbrojtjes	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
3	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
4	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”
5	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Bashkia Sarandë
6	Ministria e Infrastrukturës dhe Enerjisë	Bashkia Përmet
7	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Bashkia Gjirokastër
8	Ministria e Kulturës	Bashkia Fier
9	Këshilli i Lartë Gjyqësor	Bashkia Berat
10	Kryeministria	Bashkia Korce
11	Bashkia Vlorë	Bashkia Ura Vajgurore
12	Bashkia Tropojë	Bashkia Kavajë
13	Bashkia Krujë	Bashkia Lushnje
14	Bashkia Shijak	Bashkia Rrogozhinë
15	Bashkia Pogradec	Kolegji i Posacëm i Apelimit
16	Bashkia Devoll	Agjensia për Mbikëqyrjen e Shoqërisë Civile
17	E paspecifikuar në raport	Agjensia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

Nga ana tjetër në kundërshtim me manualin e MFK i cili udhëzon “Llogaritjen e numrit të njësive publike që do të monitorohen nga çdo punonjës i DH/MFK ...., dhe sipas përqindjes: 50% njësi publike nga grupei “i performuesve të dobët”, 25% nga “performuesit mesatar”, 25% nga “performuesit e mire”, DH/MFK nuk rezulton të ketë kryer një analizë të tillë për përcaktimin e subjekteve për monitorim (përzgjedhja e njësive të listuara në tabelë)

**Kriteri:**

Manuali i MFK

**Impakti:**

Mos kryerja e monitorimeve dhe raportim jo i saktë i aktivitetit të monitorimit në Raportin Vjetor. Mungesë e ndjekjes së rekomandimeve të mëparshme.

**Shkaku:**

Situata e krijuar për shkak të pandemisë Covid 19 dhe gjithashtua afatet në realizimin e aktiviteteve të planifikuar, devijim nga programet vjetore te punës dhe mungesë kontrolli nga strukturat përgjegjëse MPA dhe Titullari i Institucionit.

**Rëndësia:**

E lartë

**5. Mbi mangësitë në implementimin pilot të sistemeve të MFK në institucionet e përzgjedhura, për vitin 2019**

**Situata:**

Sipas planit vjetor të DH/MFK pika IV, në lidhje me zbatimin e MFK është përcaktuar si objektiv që të kryejë trajnime specifike të institucioneve për asistencë lidhur me implementimin e sistemit të MFK. Nga auditimi u konstatua se në kuadër të planifikimit të aktiviteteve sipas shtyllës 5 të

Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020, Drejtoria e Harmonizimit gjatë vitit 2019, në mbledhjen e bordit të KBFP-së me datë 25.09.2019 vendosi përgatitjen dhe dërgimin e një shkresë informuese për institucionet pilot të përzgjedhura me afat realizimi aktivitetesh 1 vjeçar për 4 ministri linje dhe 3 bashki, konkretisht për: Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Shëndetësisë, Bashkinë Vlorë, Durrës dhe Lezhë. Pilotimet janë parashikuar fillimisht si një asistence teknike mbi realizimin e kërkesave të MFK në përmbushje të aktiviteteve në kuadër të shtyllës 5 të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020 (dhe atë të rishikuar), per implementimin e një sistemi modern te MFK.

Gjatë auditimit të mëparshëm të KLSH, rezultoi se pilotimet e iniciuara nga Drejtoria e Harmonizimit, në Ministrinë e Brendshme dhe në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, deri në fund të periudhës objekt auditimi, nuk kishin kryer të gjithë aktivitetet e planifikuara nga drejtoria. Ky proces, rezulton i papërfunduar dhe i ndërprerë nga DH/MFK për këto dy institucione edhe gjatë këtij viti, duke mos rezultuar për vijimin e pilotimit në përmbushje të objektivave për modernizimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Rezulton se në mbledhjen e bordit të KBFP-së me date 19.12.2019, u vendos që për shkak të situatës së krijuar nga termetet, të zëvendësohen institucionet e përzgjedhura për asistencë teknike, konkretisht Bashkia Lezhë dhe Durrës me Bashkinë Elbasan dhe Kukës. Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentacionin e vendosur në dispozicion për vijueshmërinë e procesit të pilotimit në institucionet e përcaktuar si më sipër konstaton si më poshtë:

#### **1. Pilotimi në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (i papaërfunduar)**

Përzgjedhja e institucionit është kryer në mbledhjen e bordit të KBFP-së më datë 25.09.2019, pa u shoqëruar me kriteret sipas së cilës është vendosur të kryhet monitorimi në këtë institucion, edhe pse ky institucion qëndron në rang rankimi në vendin e parë sipas renditjes së ministrive të linjës për treguesit e performancës.

Planifikimi për kryerjen e vlerësimit të institucionit për gjendjen e sistemeve të MFK dhe ofrimi i asistencës teknike është përcaktuar muaji Dhjetor dhe përgjatë vitit 2020 sipas shkresës datë 30.10.2019. Plani i aktiviteteve për këtë njësi paraqitet si më poshtë:

Aktiviteti	Afati i realizimit	Komenti i grupit të auditimit
Vlerësimi paraprak për statusin e implementimit të kërkesave të MFK-së	03.02.2020-07.02.2020	Këto aktivitete nuk rezultojnë të dokumentuar dhe nuk janë shoqëruar me relacione shpjegues/pyetësor për dokumentat e marra nga punonjësit e DH/MFK, rezulatat e vlerësimti paraprak, etj. Bashkëlidhur vetëm memo e njoftimit me datë 23.01.2020
Trajinimin e përgjithshëm për stafin e MFE mbi kërkesat dhe mënyrën e implementimit të kërkesave ligjore të MFK-së	03.02.2020-07.02.2020	

Përgatitja e manualeve të proceseve të punës	09.03.2020-13.03.2020	I padokumentuar kryerja ose jo e aktivitetit
Përgatitja e regjistrat të riskut për institucionin pritës	I paspecifikuar	I padokumentuar kryerja ose jo e aktivitetit
Përgatitja e plan veprimit për minimizimin e risqeve	I paspecifikuar	I padokumentuar kryerja ose jo e aktivitetit
Përgatitja e gjurmëve të auditimit për disa procedura kryesore	I paspecifikuar	I padokumentuar kryerja ose jo e aktivitetit
Përgatitja e planit të veprimit për ngritjen e sistemeve të MFK	I paspecifikuar	I padokumentuar kryerja ose jo e aktivitetit
Ëorkshop përbledhës për realizimin e pilotimit	I paspecifikuar	I padokumentuar kryerja ose jo e aktivitetit

Përsa i përket institacioneve të tjera të planifikuarat për implementimin e sistemit modern të MFK, rezulton se janë kryer vetëm njoftimet si më poshtë, pa u shoqëruar me aktivitetet konkrete që do të kryhen në këto institucione dhe afatet përkatëse.

Nr.	Institucioni	Njoftimi	Aktivitete të planifikuara	Aktivitete të realizuara
1	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Shkresa nr. 20396, datë 08.11.2019	-	-
2	Ministria e Drejtësisë	Shkresa nr. 20395, datë 08.11.2019	-	-
3	Ministria e Infrastrukturës dhe Enerjisë	Shkresa nr. 20394, datë 08.11.2019	-	-
4	Bashkia Elbasan	Shkresës nr. 24490, datë 31.12.2019	-	-
5	Bashkia Kukës	Shkresa nr. 24491, datë 31.12.2019	-	-
6	Bashkia Vlorë	Shkresa nr. 20397, datë 08.11.2019	-	-

Edhe për këto institucionë nuk disponohet metodologjia apo vlerësimi sipas së cilës është kryer përzgjedhja e tyre. Konkretilisht, Bashkia Kukës sipas renditjes të sistemeve të kontrollit të brendshëm, nuk rezulton të disponojë sisteme të dobëta. Gjithashtu, në analogji edhe Bashkia Vlorë rezulton në nivele të kënaqshme renditjeje, si dhe ka qënë pjesë e pilotimit të Drejtorisë së Harmonizimit për një vit më parë, proces i cili është deklaruar i konkluduar me rishikimin e kuadrit rregullativ dhe implementimin e sistemit modern.

Konstatojmë gjithashtu mungesë të analizës dhe evidencave të zbatimit të kriterieve në përzgjedhje të njësive "pilot". Kështu, përzgjedhja e Bashkisë Vlorë, e cila është institucion i cili ka qënë pjesë e projektit të

mëparshëm si njesi pilot evidenton formalizimin në proces dhe lë të paqartë arsyet pse keto njesi klasifikohen si njësi pa sistem modern të MFK, edhe pse renditja e saj në rankimet e treguesve të përformancës përvitin 2019 është e kënaqshme.

Nga auditimi u konkludua se në kundërshtim me planin e aktiviteteve në kuadër të shtyllës 5 të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020, Drejtoria e Harmonizimit nuk ka mundur të kryejë implementimin e sistemit të MFK në asnjë nga njësitë e përgjedhura pilot përvitin 2019, edhe pas ndryshimeve të kryera në llojin e tyre, duke mos përgatitur relacione shpjeguese dhe duke mos e prezantuar këtë çështje si mosrealizim objktivi në Raportin Vjetor 2019.

Mosrealizimi edhe i këtij aktiviteti nga ana e DH/MFK, evidenton mangësitë që ekzistojnë në planifikimet/realizimet e punës së kësaj drejtorie, të cilat ndikojnë edhe në progresin e pritshëm të objektivave të strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike të rishikuar.

**Kriteri:**

**Impakti:**

**Shkaku:**

**Rëndësia:**

Shtylla 5 e Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020

Mos realizimi i një nga aktivitetetë kryesore të DH/MFK, evidenton mangësitë që ekzistojnë në planifikimet e kësaj drejtorie, të cilat ndikojnë edhe në progresin e pritshëm të objektivave të strategjisë.

Mos marrja e masave përkatëse nga drejtuesit e DH/KBFP për organizimin dhe planifikimin e punës në funksion të objektivave të strategjisë

E lartë

## 6. Mbi vlerësimin me pikë të pyetësorëve të përfektë të indikatorëve të MFK dhe AB

**Situata:**

Në lidhje me sistemin e pikëzimit të përgjedhur nga DH/MFK në kuadër të indikatorëve të performancës, u analizuan vlerësimet e dhëna nga ana e Drejtorisë në vijim të përgjigjeve të institucioneve shtetërore në pyetësorët e vetëvlerësimit, respektivisht:

**Indikatori 1: Hartimi me cilësi i planit të veprimit dhe paraqitja brenda afateve kohore (vlerësimi nga 1-4 mbi bazën e përgjigjeve të pyetjeve të mëposhtme)**

**Pyetja 92:** A ka institucioni një plan veprimi të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të miratuar për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit? (Në rubrikën "Përgjigje e Arsyetur" specifikoni numrin dhe datën e dokumentit)

Institucioni	Përgjigjja	Vlerësimi nga DII/MFK
Bashkia Ura Vajgurore	Institucioni ka plane veprimi të menaxhimit financiar dhe kontrollit, sepse ai mbështetet në ligjin e buxhetit	4pikë
Bashkia Pukë	Kemi strategjinë e menaxhimit të riskut	1pikë

**Indikatorin 3: Efektiviteti i mekanizmave bazë të përgjegjshmërisë**

menaxheriale në njësitë e sektorit publik:

**Pyetja 5 :** A ekzistojnë mekanizma të cilat i dedikohen ankesave për korruption, nëse po:

- A ofrojnë këto sisteme nivele të përshtatshme të anonimitetit dhe mbrojtjes ndaj ankuesve?
- A është përcaktuar përgjithësisht procedura e sinjalizuesve?
- A mund të bëhen zbulime me një besim të arsyeshëm se informacioni është i vërtetë në kohën kur ajo zbulohet?
- A janë gjithëpërfsirëse dhe të përcaktuara qartë procedurat e mbrojtjes për sinjalizuesit?

Institucioni	Përgjigjja	Vlerësimi nga DH/MFK
Bashkia Kolonjë	Baza ligjore kodri i etikës. Egzistojnë mekanizma për dokumentimin e ankesave dhe ka strukturë përkëtë e cila është në përberje të autitit të brëndshem në bazë të ligjit nr 60/2016	3 pikë
Bashkia Pustec	Nuk ka një mekanizëm për shëmangjen e e korruptionit	1 pikë
Ministria e Shëndetsisë dhe Mbrotjes Sociale	Po, në ministri egziston një person për antikorruptionin. Gjithashtu egziston dhe rjesia e "bilbilfyrësits"	4 pikë
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Lidhur me ankesat për korruptionin, në institucionin tonë nuk ka patur probleme të tillë	2 pikë
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	Liqji nr 9131 datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në Administratën Publike"	1 pikë

**Pyetje 8:** Nëse keni njësi varësie: A merrni raportime të rregullta nga Titullari/NA i njësisë për performancën (përmbrushjen e detyrave) gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre? (Në rubriken "Përgjigje e Arsyetuar" vendosni numrin dhe datën e disa raporteve zyrtare të marra gjatë vitit si dhe numrin e njësive të vartësise që janë nën kontrollin e organit qëndror.)

Institucioni	Përgjigjja	Vlerësimi nga DH/MFK
Ministria e Mbrotjes	Njësi varësie të cilat raportojnë edo fillim muaji si dhe rast pas rasti	4 pikë
Ministria për Evropën dhe punët Jashtme	-	1 pikë
Bashkia Kukës	Sipas kërkesave të përcaktuara në udhëzimin e MF Nr.30 datë 27.11.2011 pikat 32 dhe 33 përcaktohet se shoqëritë tregtare duhet të dorëzojnë raporte dhe pasqyrat financiare. Pranë Bashkisë Kukës kanë detyrimin ligjor që të paraqesin sh.a ujësjellës kanalizime Kukës dhe sh.a Futboll Klub Kukësi. Nga dy sh.a vetëm ujësjellëz kanalizime Kukës depoziton edhe vit, sipas asfatit reportin vjetor dhe pasqyrat financiare	3 pikë
Bashkia Pukë	Nuk kemi njësi të vartësise me financë me vete. Është vetem sh.a Ujësjellës kanalizime Pukë i cili rapporton te kryetari i bashkisë	-
Bashkia Vlorë	Po, situacionet dhe raportet 4 mujore të shpenzimeve, ecurinë e punës	2 pikë

**Pyetje 10:** A janë raportuar të gjitha dobësitë e kontrollit të brendshëm, analizohen dhe adresohen siç duhet kur është e nevojshme?

Institucioni	Përgjigjia	Vlerësimi nga DH/MFK
Bashkia Shkodër	Te gjitha raportet audituese, analizohen dhe paraqiten në mbledhjen e këshillit të qarkut sipas rastit	2pikë
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	po	2pikë
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Po,në rastet e evidentimit të dobësive apo problematikave ato janë analizuar dhe janë bërë rekomandimet e duhura nga drejtuesit përkatës	4pikë
Bashkia Elbasan	Janë raportuar të gjitha dobësitë e kontrollit duke u analizuar për tu përmiruar	2pikë
Bashkia Selenicë	Auditimi brëndshëm	2pikë
Bashkia Vorë	Cdo drejtori, sektor ka planin e veprimit vjetor të miratuar nga NA	2pikë
Bashkia Rrogozhinë	Nuk kemi pasur një audit të brendshëm, për të raportuar të gjitha dobësitë e kontrollit të brendshëm. Vetëm në tremujorin e fundit të vitit 2019 është krijuar struktura dhe në bazë të një programimi po vazhdon kontrolllet sipas sektorëve	1 pikë
Bashkia Mirditë	Auditi brendshëm bën vlerësimin e kontrollit të brëndshem ku evidenton dobësitë dhe i adreson ato sipas sistemeve ku ushqrohet auditimi. Titullari i institucionit merr opiniione bazuar në raportet dhe memot e hartuara nga Auditi Brendshëm	3pikë

**Pyetja 18:** A keni një strategji të miratuar me objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor? (Nëse po, lutemi specifikoni datën e miratimit në rubrikën "Përgjigje e Arsyetur")

Institucioni	Përgjigjia	Vlerësimi nga DH/MFK
Bashkia Vajgurore Ura	Po kemi hartuar dhe miratuar një deklaratë të misionit në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit të buxhetit. Kjo është shprehur në PBA 2019-2021	3pikë
Bashkia Bulqizë	Dokumenti i PBA miratuar me VKB nr.71 datë 24.12.2019	3 pikë
Këshilli i Qarkut Dibër	Po,kërkesat buxhetore,objektivat kryesore,prioritetet e programit etj	3pikë
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Po	2 pikë
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Si cdo vit ne kemi ndjekur procedurën e zbatimit të PBA-së nëpërmjet dërgimit të fishave në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit	4 pikë
Bashkia Selenicë	Dokumenti i PBA nr 1420 datë 31.05.2019	1 pikë

**Pyetja 21:** A i përcakton njësia publike treguesit e performancës në planin strategjik për monitorimin dhe arritjen e objektivave? (Nëse po, duhet të jetë përcaktuar në dokumentin e strategjisë, në mënyrë narrative ose në matricën shoqëruese.)

Institucioni	Përgjigjia	Vlerësimi nga DH/MFK
Bashkia Tepelenë	-	1 pikë
Bashkia Elbasan	Njesia publike treguesit e përfornancës i përcakton në planin strategjik për monitorimin dhe arritjen e objektivave	3 pikë

Ministria e Drejtësisë	Në planin e Veprimit,në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë(SNKK)si dhe në Strategjinë e Drejtësisë për të mitur(SDM)	4 pikë
Këshilli i Qarkut Fier	Po njësia ka objektiva të caktuar për të cilat luftohet për tu realizuar	2 pikë
Këshilli i Qarkut Gjirokastër	Nuk kemi një dokument të tillë për arsyet e përmenduara më sipër	1 pikë
Këshilli i Qarkut Shkodër	Po punohet	1 pikë

**Pyetja 22:**A keni plan-veprime vjetore të miratuara, për arritjen e qëllimeve strategjike, objektivave vjetore që përbajnë veprime, afate, dhe persona konkretë përgjegjës për çdo veprim të parashikuar?

Institucioni	Përgjigjia	Vlerësimi nga DH/MFK
Bashkia Libohovë	Nga sektorët përkatës ka plane vjetore të punës për realizimin e detyrave dhe objektivave të tyre	2 pikë
Ministria për Evropën dhe punët e Jashtme	-	1 pikë
Ministria e Mbrojtjes	Po miratuar nga Ministri i Mbrojtjes me nr 951/1,datë 15.02.2019,me aktivitete,afate dhe nëpunës përgjegjës për realizimin e tyre	4 pikë
Bashkia Selenicë	Po	1 pikë
Bashkia Kamëz	Cdo drejtori,sektor dhe njësi vartësie ka objektivat,planin vjetor të miratuar nga titullari	3 pikë
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	Aktualisht për vitin 2019 nuk ka të miratuar një plan veprimi,kjo pikë kërkon numrin e shkresës qështë miratuar plan veprimi	1 pikë

**Pyetja 23:**A është miratuar struktura organizative në përputhje me madhësinë dhe aktivitetet e njësisë? A është përditësuar dhe kur? (Jepni referencën e dokumentit në rubrikën "Përgjigje e Arsyetuar")

Institucioni	Përgjigjia	Vlerësimi nga DH/MFK
Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë	Po,Rregullorja është Miratuar me Urdhérin e Ministrit nr.352 datë 17.06.2019 është miratuar "Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Struktura e Aparatit të MASR është miratuar me Urdhérin e kryeministrit nr 163 datë 07.10.2017	4 Pikë
Bashkia Fushë-Arréz	Kemi një strukturë të përshtatur por e pamjaftueshme.Urdhër nr 428 datë 11.12.2017,VKB nr.55 datë 19.12.2017	4 Pikë
Bashkia Korçë	Është miratuar struktura organizative e bashkisë Korçë me urdhër të titullarit nr 14 datë 11.01.2019	4 Pikë
Këshilli i Qarkut Vlorë	Struktura organizative e Këshillit të Qarkut miratohet edo vit dhe bazohet në ligjin e buxhetit(nr i punonjësve) dhe kompetencat dhe detyrat mbështeten në ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" sipas VKQ nr 44 datë 20.12.2018 "Mbi strukturën organizative të Këshillit të qarkut Vlorë për vitin 2019	4 Pikë

**Pyetje 24:** A janë përcaktuar përgjegjësitë e menaxherëve për zbatimin e objektivave të njësisë publik dhe menaxhimit të riskut?

Institucioni	Përgjigjia	Vlerësimi nga DH/MFK

Qëndra Kombëtare e Kinematografisë	Rregullorja e Brëndshme e QKK përfshin organigramën e institucionit, Përshkrimet e punës së personelit janë të përcaktuara në rregulloren e brëndshme të punonjësve nr 10. Prot datë 04.01.2019	4 pikë
Ajensia telegrafike Shqiptare	Po, janë përcaktuara në rregulloren e brëndshme të institucionit	2 pikë
Bashkia Mat	Janë të përcaktuara në Planin e Integritetit por edhe në aktet e tjera kryesish tek Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave	2 pikë
Bashkia Kavajë	-	3 pikë

**Pyetje 28:** A delegohen përgjegjësitë brenda njësisë nga ana e menaxherëve? A ndahan përgjegjësitë dhe detyrat sipas nevojës, në nivele të ndryshme të njësisë publik?

Institucioni	Përgjigjja	Vlerësimi nga DH/MFK
Departamenti i Administratës Publike	Delegimi i detyrave dhe përgjegjësive dokumentohet sipas ligjit Nr 10296/2010 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe për cdo delegim të detyrës pason një raportim i nëpunësitet kundrejt deleguesit në lidhje me mbarëvajtjen e punës	2 pikë
Këshilli i Qarkut Vlorë	Delegimi i detyrave bëhet nëpërmjet urdhërave me karakter individual, rregullore së brëndshme dhe përshkrimit të punës	3 pikë
Bashkia Vorë	Po delegohen përgjegjësitë në bazë të problematikave dhe prioriteteve dhe nevojave që mund të ketë	2 pikë
Bashkia Polican	Detyrat dhe përgjegjësitë janë të mirëpërcaktuara në rregulloren e brëndshme, përshkrimet e punës dhe planet mujore	2 pikë
Bashkia Sarandë	Në rastet kur ka urdhëra delegimi kopetencash në mungesë janë shumë të qarta kopetencat dhe fusha e veprimit e tyre	1 pikë
Kryeministria	Detyrat ndahan sipas nevojës në nivele të ndryshme të njësisë publike dhe delegohen e kontrollohen në vazhdimësi nga drejtuesit	4 pikë

**Pyetje 30:** A analizohen risqet që lidhen me funksionet dhe kompetencat e deleguara?

Institucioni	Përgjigjja	Vlerësimi nga DH/MFK
Ministria e Kulturës	Po analizohen të gjitha risqet që lidhen me funksionet dhe kompetencat	2 pikë
Bashkia Sarandë	Nuk ka delegim në detyrë	1 pikë
Kryeministria	Risqet që lidhen me funksionet dhe kompetencat e deleguara analizohen paraprakisht por edhe pas delegimit nëpërmjet raportimit periodik	4 pikë
Gjykata Kushtetuese	Po	4 pikë

**Pyetja 43:** A është përcaktuar përgjegjshmëria dhe përgjegjësia e menaxherëve për objektivat strategjike? Dhe a është përcaktuar kjo përgjegjësi në rregulloren e brendshme të njësisë publike?

Institucioni	Përgjigjja	Vlerësimi nga DH/MFK
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	Përgjegjësitë e menaxherëve janë përcaktuara në Rregulloren e Brëndshme të institucionit, ku përcaktohen detyrat për secilën drejtori sipas sektorëve përkatës dhe me programe vjetore për cdo strukturë	4 pikë
Bashkia Vau Dejës	Rregullorja e brëndshme i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë dhe detyrat e cdo menaxheri organigrama	3 pikë

	hartoher sipas hierarkisë dhe strukturës,delegimi i detyrave hartohet	
Kryeministria	Po	4 pikë
Bashkia Korce	Urdhri i Kryetarit të bashkisë nr 12 dt 10.1.2019 përgjithësisht e grupit të menaxhimit strategjik GMS	3 pikë

**Pyetje 44:** A zhvillohen mbledhje të rregullta të dokumentuara të GMS për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin finansiar dhe kontrollin?

Institucioni	Përgjigjja	Vlerësimi nga DH/MFK
Ministria e Mbrojtjes	Po	2 pikë
Bashkia Polican	Urdhri nr 22 "Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësive të vëtqeverisjes vendore	2 pikë
Këshilli i Qarkut Fier	Po zhvillohen vazhdimi, gjatë periudhës së hartimit të buxhetit.Në zbatim të ligjil përbuxhetin e vitit	3 pikë

**Pyetje 45:** A vendos njësia juaj, si një tërësi, objektiva afatmesme gjatë përgatitjes së PBA? A janë publikuar këto objektiva?

Institucioni	Përgjigjja	Vlerësimi nga DH/MFK
Këshilli i Qarkut Dibër	Po njësia jonë vendos objektivat afatmesme gjatë përgatitjes së PBA-së dhe këto objektiva publikohen në faqen e internetit të institucionit	4 pikë
Ministria për Evropën dhe punët e Jashtme	-	1 pikë
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Po	2 pikë

**Pyetje 46:** A i komunikohen objektivat e miratuara stafit, sipas llojit të strukturës?

Institucioni	Përgjigjja	Vlerësimi nga DH/MFK
Avokati i Popullit	Po,komunikimi kryhet sipas rregullave të komunikimit të brëndshem,referuar sqarimeve të dhëna në pikën 2 të kësaj tabelë	4 pikë
Bashkia Pustec	Institucioni jonë është në proces hartimi të objektivave në nivel treguesish, nëpërmjet implementimit të projektit përfundimtar vendore	3 pikë
Bashkia Polican	U komunikohen në formë shkresore dhe takimeve zyrtare me drejtoret,shefat e sektorëve dhe drejtues ekspert të menaxhimit të programeve sipas sektorëve	3 pikë

**Pyetje 47:** A janë objektivat operacionale të njësisë publike në përputhje me strategjitet dhe politikat kombëtare/sektoriale, si dhe vizionin dhe misionin e njësisë? A ka përputhje midis objektivave afatmesme (PBA) dhe objektivave të parashikuara në buxhetin vjetor të njësisë?

Institucioni	Përgjigjja	Vlerësimi nga DH/MFK
Ministria e Mbrojtjes	Po	2 pikë
Kryeministria	Objektivat operacionale të njësisë janë në përputhje me strategjitet dhe politikat kombëtare,si dhe vizionin e misionin e njësisë.Objektivat e parashikuara në buxhetin vjetor janë përputhje me objektivat afatmesme	4 pikë
Bashkia Fier	Po janë në përputhje me strategjitet dhe politikat kombëtare të bëra në buxhetin vjetor dhe në dokumentin e PBA	3 pikë

**Pyetje 61:** A merr në konsideratë njësia ndikimet e mundshme të riorganizimit, shtimit të njësive të reja organizative dhe/ose ndryshimet e menjëherëshme të strukturave ekzistuese në sistemin e kontrollit të brendshëm?

Institucioni	Përgjigjja	Vlerësimi nga DH/MFK
Kryeministria	Sigurisht që riorganizimi shtimi njësive të reja organizative apo ndryshimet e menjëherëshme në strukturën egzistuese merren në konsideratë	4 pikë
Bashkia Kavajë	Bazuar në vlerësimin e nevojave të administratës nga Burimet Njerëzore për numrin maksimal të punonjësve në bashkëpunim me drejtoretë dhe njësitë përkatëse miratohet Struktura e bashkisë Kavajë nga kryetari i bashkisë mbështetur në vendimet e miratuara të keshillit bashkiak për numrin maksimal të punonjësve dhe buxhetit	2 pikë
Këshilli i qarkut Tiranë	Nuk aplikohet	0 pikë

**Pyetje 62:** A merr në konsideratë njësia ndryshimet në menaxhim dhe qëndrimet filozofike përkatëse në sistemin e kontrollit të brendshëm?

Institucioni	Përgjigjja	Vlerësimi nga DH/MFK
Bashkia Fushë Arrež	Po	2 pikë
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Po	3 pikë
Bashkia Bulqizë	Nuk ka patur ndryshime	2 pikë

**Pyetje 63:** A janë listuar proceset dhe a janë dokumentuar aktivitetet e kontrollit në formën e hartave të proceseve të punës/manualeve të proceseve të punës dhe/ose procedurave të brendshme për proceset e punës (duke adresuar proceset e njësisë përmrbushjen e misionit dhe objektivave të saj)?

Institucioni	Përgjigjja	Vlerësimi nga DH/MFK
Kryeministria	Secili pozicion ka proceset e tij të punës.Nuk janë dokumentuar aktivitetet e kontrollit në formën e hartave të proceseve të punës/manualeve të proceseve të punës.Manuali i procedurave është duke u hartuar.Pjesë e tij do të jenë edhe procedurat e kontrollit	3 pikë
Ministria e Infrastrukturës Energjisë	Janë duke u hartuar manualet e proceseve të punës	2 pikë
Bashkia Selenicë	Në vijimësi duke e strukturuar	1 pikë

**Pyetje 79:** A kanë përcaktuar dhe identifikuar drejtuesit e njësisë publike, informacionin e kërkuar në nivelin përkatës dhe specifikat e duhura, tek personelin i duhur? Ku është e mundur, a ka lidhje të qartë me objektivat e njësisë publike?

Institucioni	Përgjigjja	Vlerësimi nga DH/MFK
Këshilli i Qarkut Dibër	Po, regjistër risku	1 pikë
Bashkia Sarandë	Të përcaktuar në regjistrin e riskut dhe në Strategjinë e Zhvillimit Institucional	3 pikë

Bashkia Bulqizë	Drejtitoritë paraqesin në Burimet Njerëzore dhe Titullari planet si dhe informacione për realizimin e planeve	3 pikë
-----------------	---	--------

**Pyetje 80:** A janë identifikuar llojet e raportimit periodik brenda njësisë që i dorëzohen menaxherëve në njësinë përkatëse?

Institucioni	Përgjigjja	Vlerësimi nga DH/MFK
Kryeministria	Ka disa lloje raportimi periodik që i dorëzohen menaxherëve të njësive përkatëse, të cilat janë të identifikuara (psh raportimi periodik nga njësia e monitorimit të akteve tregullatore)	4 pikë
Bashkia Selenivë	Po	2 pikë
Ministria Infrastrukturës e Enerjisë	Po, janë të identifikuara llojet e raportimit periodik brënda njësisë që i dorëzohen menaxherëve në njësinë përkatëse, sipas përcaktimeve/detyrimeve dhe rregullat e brëndshme	4 pikë

**Pyetje 82:** A janë paraqitur në kohën e duhur për vendimmarrjen dhe mbështetur nga sistemi, raportet operacionale të mëposhtme: Raportet për monitorimin e buxhetit; Raportet për detyrimet financiare (shpenzime të njoitura por të papaguara. (Në përgjigje të jepet dhe me çfarë shpeshtësie i përgatitë njësia këto raporte.)

Institucioni	Përgjigjja	Vlerësimi nga DH/MFK
Bashkia Kavajë	-	2 pikë
Bashkia Gjirokastër	Raporte 4 mujore të monitorimit, raporte 3 mujore mbi detyrimet e prapambetura, raportet financiare "Bilanc" i vjecar, raporte për nxjerje jashtëpërdorimit sipas rastit	4 pikë
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	Raportet e monitorimit 4 mujor	2 pikë

**Pyetje 88:** A keni procedura të brendshme periodike të raportimit që rregullon zbatimin dhe monitorimin e objektivave?

Institucioni	Përgjigjja	Vlerësimi nga DH/MFK
Bashkia Patos	-	2 pikë
Këshilli i Qarkut Fier	Po, kemi rregulloren e brëndshme	3 pikë
Bashkia Polican	Kemi dhe jemi të fokusuar që ta përmirësojmë akoma më mirë	2 pikë

**Pyetja 90:** A kryen rregullishi Institucioni një vetëvlerësim të sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. (përshtakuaj instrumentin që përdoret)

Institucioni	Përgjigjja	Vlerësimi nga DH/MFK
Bashkia Lezhë	Cdo vit hartohet nga institucioni pyetsori i vetëvlerësimit të menaxhimit finansiar dhe i kontrollit të brëndshem, deklaratë e vlerësimit të kontrollit të brëndshem. Si dhe raporti përkatës dhe u dërgohen sipas afatit të përcaktuar në ligjin për MFK-në	3 pikë
Bashkia Roskovec	Po	3 pikë
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	-	1 pikë

**Pyetja 91:** A ka në institucion rregulla të brendshme të miratuara për

*monitorimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit? (Nëse ka specifikojeni në rubrikën "Përgjigje e Arsyetuar")*

Institucioni	Përgjigjia	Vlerësimi nga DH/MFK
Këshilli i Qarkut Dibër	Rregullorë me VKQ nr.23 datë 23/12/2019	3 pikë
Kryeministria	Nuk ka rregulla të brëndshme të miratuarar për monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit	1 pikë
Avokati i Popullit	Monitorimi i sistemit financiar dbe kontrollit realizohet bazuar në ligjin për menaxhimin financiar dhe udhëzimet e MF	2 pikë

Për sa më sipër, në përfundim të auditimit me zgjedhje mbi vlerësimin e indikatorëve të raportuar sipas strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020 **grupi i auditimit konstatoi që vlerësimi i pyetSORËVE është realizuar në mënyrë jo të drejtë dhe konsistente ndërmjet institucioneve duke patur parasysh që për përgjigje të ngjashme vlerësimi ka qënë i ndryshëm, sikundër evidentohet nga disa rastë të trajtuar nga grupi i auditimit.** Mungesa e standartizimit të pikëzimit të dhënë nga ana e Drejtorisë krasas përgjigjeve të institacioneve, ndikon drejtpërdrejtë në vlerësimin final dhe rankimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm për këto institucione.

Gjithashtu, vijon të ekzistojë problematika lidhur me mos përgatitjen nga ana e DH/MFK të komenteve apo sygjerimeve lidhur me pyetjet ku evidentohen mangësi, në mënyrë që subjekti të njihet me dobësitë e tij me qellim përmirësimin e këtyre sistemeve. **Ky përfundim lidhet edhe me faktin se roli i Drejtorisë, sikundër është përcaktuar në misionin dhe objektivat e saj, duhet ti shërbejë institucioneve nëpërmjet asistimit të vazhdueshëm për përmirësimin e shtyllave të sistemeve të kontrollit të brendshëm, dhe jo kryerjen e analizave statistikore për më tepër të pabazuara në modele standarte.**

Gjithashtu, grupi i auditimit nëpërmjet të dhënave të siguruara nga auditimet e kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit gjatë vitit 2020 në disa institucione, ku ka trajtuar ndër të tjera edhe sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit në subjektet e audituara. Në pyetësorët e dorëzuar nga KLSH, krasas me përgjigjet e dorëzuara nga institucioneve pranë DH/MFK evidentohet se për pyetje të cilat janë lidhur me të njëjtat cështje/dokumentacione, ka pasur përgjigje të ndryshme nga subjektet.

**Ky fenomeno evidenton formalitetin e përgjigjeve nga ana e institacioneve dhe dobësitë në realizimin e monitorimeve nga ana e Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, me qëllim informimin dhe trajnimin e vazhdueshëm të stafit mbi rëndësine e sistemeve të kontrollit të brendshëm.**

Institucioni	Pyetja DH/MFK	Pyetja KLSH	Pergjigjja për DH/MFK	Pergjigjja për KLSH

Bashkia Divjakë	A ofrohen mundësi të mjaftueshme të trajnimit për personelin.A është zhvilluar strategjia e përgjithshme e trajnimit në përpulje me objektivat e njësisë publike	1)A ka kryer institucioni trajnime të punonjësve 2)A ka program strategjik dhe vjetor të trajnimeve të shpallun nga institucioni 3)A ofrohen mundësi të mjaftueshme për trajnimin e stafit	Po,edo drejtoria e sektori u dërgohen emaile vazhdimishi me mundësите për trajnime bazuar edhe nëkalendarin e trajnimeve të ASPA	1)Po 2)JO 3)JO
Bashkia Divjakë	A është vlerësimi i riskut të mashtrimit pjesë përbërëse e procesit të rregullt të vlerësimit të riskut	A konsiderohet riku i mashtrimit nga ana e institucionit tuaj	Po	-
Bashkia Divjakë	A keni një regjistër për aktivet e njësisë(specifiko dokumentin e regjistrimit dhe numrin,datën)dhe a janë të regjistruar në SIFQ	1)A ka regjistër aktivesh 2)A është i përditësuar regjistri i aktiveve	Udhëzimi nr 30 dt 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e Sektorit Publik"	1)Po 2)Po
Bashkia Tepelenë	A është miratuar struktura organizative në përputhje me madhësinë dhe aktivitetet e njësisë?A është përditësuar dhe kur?	Struktura Organizative data dhe Nr i urdhërit të miratimit nga institacioni epror	3	Nr 04 datë 11.03.2019
Bashkia Tepelenë	A delegohen përgjegjësítë brënda njësisë nga ana e menaxherëve	A ka delegim të funksioneve të NZ dhe NA	2	Po sipas rregullores së brëndshme të Bashkisë Tepelenë
Bashkia Skrapar	A delegohen përgjegjësítë brënda njësisë nga ana e menaxherëve	A ka delegim të funksioneve të NZ dhe NA	Ka raste kur për arsyet e justifikuar mund të delegohen përgjegjësi për një periudhë relativisht të shkurtër kohe	Jo
Bashkia Skrapar	A ka institucioni juaj rregullore të brendshme përcaktimin e rasteve të konflikteve të	A ka institucioni një rregullore të brendshme,data e miratimit tërregullores dhe a është informuar	Ka një rregullore të brendshme egzistuese,po punohet për hartimin e rregullores së re dhe kodit të etikës e cila	Po,miratuar me datë 03.03 2020 dhe stafi është informuar

	interesit, të hartuar në përputhje me bazat ligjore në fuqi	stafi	përfundon brënda muajit Mars 2020	
Bashkia Skrapar	A identifikohen dhe vlerësohen risqet në njësinë publike, në të gjitha nivellet e saj përrritjen e objektivave? a është përfshirë i gjithë stafi në këtë proces	1)A ka institucioni një regjistër riziku 2)A ka një plan konkret masash përritje minimizuar rizikun e mashtrimit 3)A ka "bilbilfryës" të caktuar nga institucioni për rizikun e mashtrimit	Po identifikohen vlerësohen dhe merren masa përritje shëmangur sa më tepër efektet negative të riskut	1)Po 2)Po 3)Jo
Bashkia Roskovec	A ka institucioni juaj rregulllore të brendshme përritimin e rasteve të konflikteve të interesit, të hartuar në përputhje me bazat ligjore në fuqi	A ka institucioni një rregulllore të brendshme, data e miratimit të rregullores dhe a është informuar stafi	Po, kemi një rregulllore të brendshme përritimin e konfliktit të interesave Nr 7323 Prot datë 17.12.2019	Po, miratuar nga Kryetari i Bashkisë me nr. 793 Prot, datë 19.02.2019, nuk egziston urdhër përritimin e stafit
Bashkia Roskovec	A ofrohen mundësi të mjaftueshme të trajnimit përrit personelin. A është zhvilluar strategjia e përgjithshme e trajnimit në përputhje me objektivat e njësisë publike	1)A ka kryer institacioni trajnime të punonjësve 2)A ka program strategjik dhe vjetor të trajnimeve të shpallun nga institucioni 3)A ofrohen mundësi të mjaftueshme përritimin e stafit	Deri më tanë kemi pasur trajnime të vazhdueshme të ndara sipas fushave përkatëse	1)Po 2)Jo 3)Po
Bashkia Malësi e Madhe	A delegohen përgjegjësítë brënda njësisë nga ana e menaxherëve	A ka delegim të funksioneve të NZ dhe NA	3	Jo
Bashkia Ura Vajgurore	A është miratuar struktura organizative në përputhje me madhësinë dhe aktivitetet e nësisë? A është përditësuar dhe kur?	Struktura organizative	Po është miratuar brënda mundësive financiare që ka edhe institucioni. Përditësimi i fundit është bërë me dt 03.04.2019	Struktura e fundit Nr 2849 Prot, datë 17.10.2019

Bashkia Libohovë	A e kryen njësia publike periodikisht një vlerësim të ekspozimit të saj ndaj veprimtarisë mashtruese dhe si mund të ndikohen veprimtaritë e saj? A përfshin ky vlerësim secili nga njësítë e vartësisë	1)A konsiderohet rishku i mashtrimit nga institucioni juaj? 2)A ka plan konkret masash për minimizimin e riskut të mashtrimit? 3)A ka një strukturë përgjegjëse për minimizimin e riskut të mashtrimit	Vlerësimet bëhen nëpërmjet takimeve me administratën e Bashkisë	1)Po 2)Jo 3)Jo
Bashkia Krujë	A delegohen përgjegjësitë brenda njësisë nga ana e menaxherëve	A ka procedura të delegimit të detyrave në këtë institucion	Po, ka raste kur përgjegjësitë janë deleguar	Jo

Kriteri:

Pyetësori i Vetëvlerësimit të MFK

Impakti:

Pasaktësi në vlerësimin e kryer ana e strukturave të DH/MFK

Shkaku:

Mos kryerja e vlerësimit në përputhje me përgjigjet e dhëna nga institucionet në mënyrë konsistente

Rëndësia:

E lartë

Rekomandimi

DH/KBFP të marrë masat për një vlerësim real me pikë të institucioneve raportuese pranë drejtorisë.

:

Të nxirret përgjegjësia për vlerësimet jo korekte apo të pa unifikuara të DH/MFK

**7. Konstatohet inkonsistencë lidhur me indikatorët sipas Pasaportës së Indikatorëve për marjen e rezultateve të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020 dhe Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2019-2022 (shtylla e Kontrolit të Brendshëm dhe Kontabilitetit në Sektorin Publik)**

Situata:

Gjatë vitit 2019, Drejtoria e Harmonizimit ka kryer rishikimin e Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2019-2022 (shtylla e Kontrolit të Brendshëm dhe Kontabilitetit në Sektorin Publik), pa bërë një analizë të plotë të realizimit të objektivave të Strategjisë së mëparshme 2014-2020. Referuar Pasaportës së Indikatorëve për marjen e rezultateve të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020, për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe arritjen e objektivave ishte përcaktuar indikatori si më poshtë:

5.1.1 Titujt e indikatorëve	100 % e institucioneve buxhetore duhet të përdorin kërkuesat FMC në mënyrë që të përmirësojnë sistemin e kontrollit të brëndshëm dhe të realizojnë objektivat dhe rezultatet
--------------------------------	--

<b>Objektivat e përgjithshëm dhe specifik</b>	Efektiviteti menaxherial në institucionet vendore dhe qëndrore. Implementimi i suksesshëm i sistemit menaxherial modern në të gjitha institucionet e qeverisjes, si lokale ashtu dhe qëndrore						
<b>Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performance-s</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brëndshëm Financiar dhe Publik						
<b>Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave</b>	MFE						
<b>Frekuencë e publikimit të të dhënave</b>	Vjetor						
<b>Një përshkrim I shkurtër I metodologjisë</b>	<p>Performanca e institucioneve publike përbhet nga një numër indikatorësh I kombinuar në mënyrë të till që të ndihmojë krijimin e një opiniioni të bazuar në:</p> <p>Kualitetin e sistemeve të kontrollit të brëndshëm dhe pajtueshmëria e institucioneve publike konform legjislacionit në fuqi. Vlerësimi realizohet në bazë të vetylësimit të sistemit i bërë nga institucioni që plotëson pyetsorin. Institucioni vlerësues plotëson pyetsorin duke përdorur një sistem pikëzimi me 4 pika:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Institucionet që nuk plotësojnë kriteret</li> <li>2. Institucionet që plotësojnë pjesërisht kriteret</li> <li>3. Institucionet që I plotësojnë kriteret por kanë nevojë për përmirësim</li> <li>4. Institucionet që I plotësojnë kriteret.</li> </ol> <p><b>Rezultati minimal</b> që një institucion mund të arrij është 39 pikë (39 pyetje *1 pikë). Ky është rasti kur institucioni vlerëson veten me 1 pikë=nuk I plotëson kriteret.</p> <p>-Rezultati maksimal që një institucion mund të arrij është 156 pikë (39 pyetje*4 pikë)=I plotëson kriteret</p> <p>Indikatorët do të maten si një mesatare e vetëvlerësimit. Mesatarja e vlerësimit matet si totali i mesatarës së vlerësimit për cdo pyetje, me totalin e pyetjeve që është 39.</p> $AV_{Budget\ Unit} = \frac{\text{Vlerësimi total}}{39\ pyetje}$ $Vlera\ e\ indikatorit = \frac{\sum_{i=1}^{N_{BU}} (\text{Rezultati}_i)}{Numri\ i\ institucioneve\ buxhetore}$						
<b>Informacion mbi vlerat</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>2015</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Baza fillestare</td> <td>3</td> </tr> </tbody> </table>	Viti	2015	Baza fillestare	3		
Viti	2015						
Baza fillestare	3						
<b>Informacion mbi vlerat target</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>2017</th> <th>2020</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Vlera e indikatorit</td> <td>Trend Rritës</td> <td>Trend rritës</td> </tr> </tbody> </table>	Viti	2017	2020	Vlera e indikatorit	Trend Rritës	Trend rritës
Viti	2017	2020					
Vlera e indikatorit	Trend Rritës	Trend rritës					

Për sa më sipër, synohej një trend rritës në efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga viti në vit, me afat vitin 2020. Megjithatë, ashtu sikundër është trajtuar edhe në auditimet e mëparshme, theksohen fakti se DH/KBFP nuk ka përfshirë në raport një nivel të matshëm për të përcaktuar efektivitetin e sistemit të njësive publike. Pyetësorët e vetëvlerësimit nuk janë vlerësuar me pikë nga ana e drejtorisë për të gjitha cështjet që 99 pyetjet mbulojnë, në mënyrë që të kryhej dhe

matja e pikëve për njësitë publike, dhe po ashtu në rang sistemi.

**Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike 2019-2022** ka përcaktuar si **Objektiv Specifik 6:** Kontrolli i brendshëm efektiv

Objektivi kryesor: Forcimi i sistemit për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik në qeverinë qendrore dhe vendore.

**Komponenti 6.1:** Menaxhimi financiar dhe kontrolli në të gjithë institucionet publike. **Produktet: MFE-ja në fokus do të kenë:**

1. Krijimi i një menaxhimi financiar dhe mjesdisi kontrolli të brendshëm më të fortë;
2. Sisteme funksionale për kontrollin e brendshëm;
3. Sistem i forcuar monitorimi i KBFP-së.

Në mënyrë të përbledhur ndryshimet e kryera në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike paraqiten si më poshtë:

Indikatori	Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020	Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike 2019-2022
<b>Objektivi</b>	100 % e njësive buxhetore do te përdorin kërkesat e MFK për të përmirësuar sistemet e kontrollit të brendshëm dhe arritjen e rezultateve dhe objektivave	<b>Objektivi kryesor:</b> Forcimi i sistemit për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik në qeverinë qendrore dhe vendore. <b>Objetivi 1:</b> Përgjegjshmëri efektive menaxheriale në gjithë institucionet publike.
<b>Metodologja</b>	Mesatarja $\frac{\text{Njesia Buxhetore}}{\text{Totali i kritereve}}$ Vlera e Indikatorit = $\frac{\sum \text{Vlera e Indikatorit}}{\text{Numri i njësive buxhetore}}$	
<b>Produkti/Targeti</b>	Trend i rrites i efektivitetit te sistemit te kontrollit te brendshëm nga viti në vit	Produkti 6.1.1: Krijimi i një menaxhimi financiar dhe mjesdisi kontrolli të brendshëm më të fortë; Produkti 6.1.2: Sisteme funksionale për kontrollin e brendshëm; Produkti 6.1.3: Sistem i forcuar monitorimi i KBFP-së.

*Për sa më sipër, grupi i auditimit vijon të theksojë rëndësinë e krijimit të produkteve të matshme për vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, në mënyrë që të shqyrtohet rëndësia e kryerjes së analizave krahasimore ndër vite, në përputhje me Pasaportën e Indikatorëve të Strategjisë së mëparshme. Pra në strategjinë e re edhe ato tregues (sado që mund të kishim vërejtje edhe për to) nuk janë më. Nuk ka as strategjia dhe as ndonjë metodologji në funksion të saj tregues të matshëm lidhur me produkte të cilat në mënyrën se si janë dizenuar nuk kanë as fillim dhe as fund.*

**Kriteri:**

*Ligji nr. 154/2014 dt. 19.2.2015 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" Neni 15 gërmaj; Neni 16, pika 1; Neni 25 pika ç; Neni 30 pika 1 dhe 2*

<u>Impakti:</u>	Problematikat e konstatuara nga auditimet e mëprashme vijojnë të ekzistojnë dhe mos marrja e masave të duhura për përmirësimin e situatëska sjellë impakt në cilësinë e dizenjimit të strategjisë kombëtare lidhur me sistemet e kontrollit të brendshëm dhe ajo qështë më e rëndësishmja nuk ka vendosur indikatorë të matshëm dhe të krahasueshëm që do të tregonin një pamje të qartë të ecurisë së kontrollit të brendshëm në sektorin publik.
<u>Shkaku:</u>	Drejtuesit e DH/MFK dhe strukturat përgjegjëse për menaxhimin financiar dhe kontrollin (NPA dhe Titullari i Institucionit), nuk kabë bërë analizën ë duhur dhe nuk kanë marrë parsysh rekomandimet e KLSH lidhur me pasaportën e imdikatorëve duke sjellë një strategji me mangësi në indikatorët e matjes së progresit lidhur me komponentin 6.
<u>Rëndësia:</u>	E lartë

## 8 Mbi Administrimin e rregjistrat të NA/NZ

Situata: Nga auditimi u konstatua se referuar përgjegjësisë së Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit mbi krijimin dhe përditësimin e regjistrat të nëpunësve autorizues dhe zbatues të njësive publike, sipas nenit 26, pika 1. dh e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, e cili citon se “*Struktura Përgjegjëse e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin në Ministrinë e Financave është përgjegjëse për krijimin dhe përditësimin e regjistrat të nëpunësve autorizues dhe nëpunësve zbatues të njësive publike.*”, nga verifikimi i rregullsise së përbajtjes dhe përditësimit të regjistrat të nëpunësit zbatues dhe autorizues, bazuar në dokumentin e vendosur në dispozicion më datë 19/6/2020, u identifikuva pasaktësi dhe mungesë informacioni, ku konkretisht:

Të dhënat e pasqyruar për subjektet nuk janë të unifikuara në emërtime dhe përbajtje, pasi në disa raste evidentohet mungesa e të dhënavë mbi pozicionin e nëpunësit zbatues dhe autorizues, varësinë shkresave konfirmues, pozicionin sipas struktura, apo arsimimin, ku më hollësish (trajtuar në Aneksin nr. 2):

Nga auditimi i të dhënavë të raportuara për nëpunësit zbatues në projekte (në total 325 rekorde), u konstatua se:

- Në 311 raste mungojnë të dhënat lidhur me arsimin
- Në 86 raste mungojnë të dhëna lidhur me pozicionin
- Në 82 rekorde mungojnë të dhëna mbi shkresën konfirmuese
- Në 11 rekorde mungojnë kredencialet e personit përgjegjës
- Në 318 rekorde niveli hierarkik rezulton i paplotësuar

Nga auditimi i të dhënavë të raportuara për nëpunësit zbatues në bashki (në total 261 rekorde), u konstatua se:

- Në 54 raste mungojnë kredencialet e personit përgjegjës
- Në 59 raste mungojnë të dhënat lidhur me pozicionin
- Në 55 raste mungojnë të dhënat mbi arsimin

- Në 176 raste mungojnë të dhëna mbi shkresën konfirmuese
- Në 271 rekorde niveli hierarkik rezulton i paplotësuar

Nga auditimi i të dhënave të raportuara për nëpunësit zbatues në institucionet qëndrore (në total 892 rekorde), u konstatua se:

- Në 53 raste niveli hierarkik rezulton i paplotësuar
- Në 121 raste mungojnë kredencialet e personit përgjegjës
- Në 152 raste mungojnë të dhënat lidhur me pozicionin
- Në 106 rekorde mungojnë të dhënat mbi eksperiencën e punës
- Në 503 raste mungojnë të dhëna mbi shkresën konfirmuese

Nga auditimi i të dhënave të raportuara për nëpunësit autorizues në institucionet qëndrore (në total 1011 rekorde), u konstatua se:

- Në 523 raste mungojnë kredencialet e personit përgjegjës
- Në 57 raste ku është evidentuar se mungojnë kredencialet, konstatohet edhe mungesa e të dhënave lidhur me pozicionin
- Në 75 raste ku është evidentuar se mungojnë kredencialet, konstatohet edhe mungesa e të dhënave lidhur me shkresën konfirmuese

Nga auditimi i të dhënave të raportuara për nëpunësit autorizues në institucionet vendore (në total 266 rekorde), u konstatua se:

- Në 168 raste mungojnë kredencialet e personit përgjegjës
- Në 174 raste mungojnë të dhënat lidhur me pozicionin
- Në 198 raste mungojnë të dhëna mbi shkresën konfirmuese

U konstatuan dublikime të dhënash mbi nëpunësit zbatues dhe autorizues në disa institucione, apo projekte, trajtuar më hollësishët në aneksin nr. 2.1

U konstatua se informacioni i paraqitur në regjistër nuk është i përditësuar, duke identifikuar nëpunës autorizues apo zbatues të cilët edhe pse janë të konfirmuar, nuk rezultojnë në regjistër.

Lidhur me nëpunësit autorizues dhe zbatues të deleguar për një periudhë të përkohshme, vijon të mos praktikohen sinjalizimet në regjistër për përfundimin e afatit të delegimit, duke rezultuar në mungesë të informacionit të saktë e të plotë mbi periudhat respektive.

Nga auditimi u konstatua se sipas regjistrat të vendosur në dispozicion, në Degën e INSTAT, rrathi Korçë, pozicioni i nëpunësit zbatues dhe autorizues mbahet nga i njëjtë person, në kundërshtim me ligjin 10296, i ndryshuar, nen 22 pika 3.c “Veprimtaritë e kontrollit” e cila citon se “*Veprimtaritë e kontrollit përbajnë, minimalishtsistemin e dy nënshkrimeve, i cili nuk lejon që angazhimi financiar të kryhet pa marrë nënshkrimet e nëpunësit autorizues dhe të nëpunësit zbatues të njësisë apo të nëpunësve të deleguar prej tyre sipas shkallës së riskut të lidhur me të, të vlerësuar për çdo angazhim;*” dhe manualin e MFK, Kapitulli II, pika “Sistemi me dy firma”, e cila citon se “*Sistemi me dy firma (me të paktën dy firma) është një*

*procedurë e cila kryhet për të vërtetuar saktësinë e të dhënave të përfshira në dokument....Qëllimi i kësaj procedurë është të garantojë se personi përgjegjës përrregjistrimet në kontabilitet është i informuar për detyrimin financiar që do të merret përsipër apo që do të paguhet dhe do të kryejë saktë veprimet e kontabilitetit. Sistemi i firmës së dyfishtë jep garancinë se marrja përsipër e detyrimit financiar apo pagesa bëhet nga personi i autorizuar dhe se nuk ka shkelje të disiplinës financiare apo buxhetore..”*

Referuar memo-s nr.23209 datë 16.12.2019 të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit identifikohen 466 institucione buxhetore në të cilët nëpunësi zbatues kryen edhe regjistrimin e transaksioneve buxhetore, në kundërshtim me rregullat e kontrollit të brendshëm financiar për ekzekutimin e transaksioneve financiare të buxhetit tështetit, ku përcaktohet detyrimi ligor përfshirjen e minimalisht tre punonjësve në rolin e regjistruesit të transaksionit, nëpunësit zbatues dhe nëpunësit autorizues, shprehur nënenin 22 pika 3 “*Veprimitaritë e kontrollit*” të ligjit 10296, i ndryshuar, ku citohet se “*Veprimitaritë e kontrollit përbajnjë, minimalisht: ....ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin;*”.

Nga auditimi u konstatohet se Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik përgjatë vitit 2019 ka konfirmuar 49 shkresa për nëpunësit zbatues të institucioneve buxhetore të identikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit si institucione që operojnë në kundërshtim me rregullat e kontrollit të brendshme. Deri në fund të periudhës së auditimit, DHKBFP nuk ka arritur t’i japë një zgjidhje problematikës së konstatuar në memon e datës 16.12.2019.

**Kriteri:** Ligji 10296 neni 22 pika 3

**Impakti:** Identifikohen 466 institucione buxhetore në të cilët nëpunësi zbatues kryen edhe regjistrimin e transaksioneve buxhetore, në kundërshtim me rregullat e kontrollit të brendshëm financiar për ekzekutimin e transaksioneve financiare të buxhetit tështetit

**Shkaku:** Miratimi i NZ në kundërshtim me ligjin 10296 neni 22 pika 3

**Rëndësia** E lartë

±

#### **Observacion i subjektit:**

Përsa më sipër është dërguar Projektraporti dhe për këtë cështje subjekti i audituar ka bërë observacione, komente dhe shpjegime dhe më konkretisht:

Përsa i përket Rekomandimit nr 1 bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, (ligji për MFK) në nenin 3 përcaktohet se: “*Ky ligj zbatohet në njësitë publike, ku sipas këtij ligji, përfshihen:*

*1. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme.*

*2. Shqëritë tregtare, organizatat joftimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta, të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme.*

*3. Njësi të tjera që shpenzojnë fonde publike, sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare.”*

Ndërkohë, ashtu sikurse kemi sqaruar edhe në observacionet e mëparshme, bazuar në nenin 18, pika 1 e ligjit për MFK, përcaktohet se: “*Nëpunësi autorizues i njësisë publike, sipas pikës I të*

*nenit 3 tē kētij ligji, nē bazē tē vetëvlerësimëve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës pér cilësinë dhe gjendjen e sistemeve tē kontrolleve tē brendshme tē njësisë publike që mbulon, pér vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt tē vtitit aktual. Pér tē realizuar detyrimin e tij, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet tē zbatojë një sistem tē brendshëm raportimi pér tē marrë informacion nga njësitë e varësimëve, pér tē mbështetur deklaratën, sipas këtij ligji.”*

Në këtë mënyrë, përtëj faktit se tē gjitha njësitë publike, sipas nenit 3 tē ligjit tē MFK, duhet tē zbatojnë kërkesat e ligjit tē sipërcituar, raportimi dhe si rrjedhojë vlerësimi i sistemit tē kontrollit tē brendshëm kryhet vetëm nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Sa më sipër, struktura e DH/MFKK nuk ka asnjë kompetencë apo përgjegjësi ligjore, pér t'ju kërkuar njësive tē tjera publike tē plotësojnë e dorëzojnë pyetësorë tē veçantë tē vetëvlerësimit.

Pavarësisht specifikimeve ligjore pér raportimin dhe vlerësimin e sistemit tē MFK-së, DH/MFKK ofron mbështetjen e saj pér tē gjitha njësitë publike, duke u fokusuar tek njësitë e qeverisjes së përgjithshme, tē cilat janë tē detyruara nga ligji pér tē raportuar e vlerësuar. Megjithatë, përveç kësaj, duke patur parasysh edhe burimet e kufizuara, DH/MFKK ka ofruar mbështetje pér tē gjitha ato njësi publike, tē cilat kanë shprehur nevojën pér asistencë në këtë fushë. Kjo është e evidentuar edhe nëpërmjet trajnimeve tē ndryshme tē realizuar me stafin e këtyre njësive publike, si dhe asistencës së vazhdueshme nga zyra pér tē gjitha çështjet që lidhen me sistemin e MFK-së (bashkëlidhur evidencia përkatëse).

Qëndrimet e Audituesve Shtetërorë tē KLSH: *Bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financier dhe kontrollin”, tē ndryshuar, (ligji pér MFK) nē nenin 3 përcaktohet se:*

*“Ky ligj zbatohet nē njësitë publike, ku sipas këtij ligji, përfshihen:*

- 1. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme.*
- 2. Shoqëritë tregtare, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta, tē cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantoohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme.*
- 3. Njësi tē tjera që shpenzojnë fonde publike, sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare*

*Pra fusha e zbatimit tē këtij ligji është më e gjerë sesa njësitë e qeverisjes së përgjithshme, gjithashtu neni 18 pika 1 e tij e cituar nē observacion nga DH/MFK rregullon procedurën e raportimit mbi raportimin pér gjëndjen e sistemeve tē kontrolleve tē brendshme pér njësitë e qeverisjes së përgjithshme, por një gjë e tille nuk e pengon DH/MFK pér dorëzimin dhe shpërndarjen e pyetësorëve tē veçantë sipas kërkesave tē nenit 3 tē Ligjit. nr.10296, datë 08.07.2010 ndryshuar me Ligjin nr.110/2015, datë 15.10.2015*

Përsa i përket Rekomandimit nr 2 Në mbështetje tē nenit 26, pika 3 e ligjit tē MFK-së përcaktohet se: *“Struktura Përgjegjëse e Harmonizimit pér Menaxhimin Financiar dhe*

*Kontrollin ndihmon Nëpunësin e Parë Autorizues dhe Ministrin e Financave për monitorimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe për përgatitjen e raportit vjetor për gjendjen e menaxhimit financiar dhe kontrollit publik, ku përmblidhet informacioni i marrë, në përputhje me dispozitat e nenit 18 të këtij ligji.”*

Ndërkohë, bazuar dhe në nen 18, pika 1 e këtij ligji, siç përmendur më sipër, struktura e DH/MFKK ka përgjegjësinë për të përbledhur informacionin e raportuar nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Përgjegjësia e plotësimit të saktë të këtyre pyetësorëve, mbetet tek titullari i njësisë që ka raportuar, në përputhje me kërkesat e ligjit të MFK. Në lidhje me ofrimin e mbështetjes ndaj njësive të qeverisjes së përgjithshme për plotësimin e pyetësorëve të vetëvlerësimit struktura e DH/MFKK, përvëç trajnimeve të vazhdueshme (bashkëlidhur lista e pjesëmarrësve në 4 seanca trajnimi mbi mënyrën e plotësimit të pyetësorit të rishikuar të vetëvlerësimit) dhe mbështetjes në vend, ka përgatitur një metodologji për vlerësimin e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, me qëllim kryesor ofrimin e mbështetjes dhe ndërgjegjësimin e njësive, në lidhje zbatimin e kërkesave të ligjit të MFK.

Ndërkohë, përsa i përket përbledhjes së të dhënave për vlerësimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe konsolidimit të rezultateve të pyetësorëve të vetëvlerësimit për çdo njësi që ka raportuar pranë DH/MFKK, theksojmë se DH/MFKK, siç dëshmuar edhe grupit të auditimit, ka menaxhuar dhe analizuar të gjithë pyetësorët e vetëvlerësimit të dorëzuar, si dhe është bërë vlerësimi për çdo pyetje përbërëse të tij (për 99 pyetjet). Përbledhja dhe konsolidimi i të dhënave të pyetësorëve të vetëvlerësimit është kryer sipas mënyrës së vlerësimit të parashikuar në udhëzuesin e pyetësorit, dhe është paraqitur në Raportin Vjetor për secilin grup institucionesh (përkatësisht ministri, bashki dhe këshilla qarku, institucione të pavaruar+grupi 87 si dhe njësitë shpenzuese me buxhet të madh).

Në të njëjtën kohë, për vlerësimin e performancës së sistemeve të kontrollit të brendshëm, është zbatuar Metodologja për Monitorimin e Performancës së Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë Publike (Urdhri nr. 117, datë 01.04.2019), specifikisht mbi bazën e 3 treguesve të performancës për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Vlerësimi i këtyre treguesve është bazuar mbi analizimin e pyetjeve të pyetësorit të vetëvlerësimit, ku theksojmë se dy prej treguesve janë vlerësuar mbi bazën e analizimit të 30 pyetjeve specifike të pyetësorit, ndërkohë që treguesi “Gjithëpërfshirja dhe rregullsia e raportimit vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm”, është vlerësuar mbi bazën e analizimit të të gjitha pyetjeve në pyetësor. Gjithashtu, theksojmë se në analizën e kryer, është realizuar krahasimi i rezultateve me vitin 2018 për elementë të caktuar të sistemit të MFK-së për grupet e institucioneve të marra në analizë.

Vlen të theksojmë se, vlerësimi i performancës së sistemeve të kontrollit të brendshëm, është çështje e ndryshme në Raportin Vjetor, dhe nuk lidhet me vlerësimin e gjendjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm, siç përcaktohet në nenin 18 të ligjit të MFK, i cili bazohet në vetëvlerësimin e raportuar nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Për të gjitha ato njësi të cilat kanë detyrimin për të raportuar dhe nuk e kanë realizuar këtë gjë, struktura e DH/MFKK ka propozuar marrjen e masave administrative, sipas përcaktimeve ligjore. Procedura e ndjekur i është vënë në dispozicion grupit të auditimit.

Për sa i përket rishikimit të manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ka nisur procesi i vlerësimit dhe rishikimit të elementeve të ndryshëm për të përmirësuar më tej dokumentin. Pavarësisht faktit se ky dokument është planifikuar të miratohet gjatë vitit 2021, DH/MFKK ka shprehur angazhimin për ofrimin e mbështetjes për të gjitha njësitë publike të cilat kanë nevojë për asistencë lidhur me zbatimin e elementeve të ndryshëm të sistemit të MFK.

**Qëndrimet e Audituesve Shtetërorë të KLSH:** Grupit të auditimit nuk i është vendosur në dispozicion se në cilën pikë është arritur përsa i përket rishikimit të manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Gjithashtu nga testimi i realizuar nga grupi i auditimit nuk rezulton të jetë kryer nga ana e Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit asnjë analizë e pyetesorëve të dërguara nga njësitë publike, me qëllim përcaktimin e saktësisë së konsistencës së plotësimit të tyre.

Përsa i përket Rekomandimit nr 3. Bazuar në nenin 18, pika 1 të ligjit të MFK, theksohet se: ..  
*Për të realizuar detyrimin e tij, nepunësi autorizues i njësitë publike duhet të zbatojë një sistem të brendshëm raportimi për të marrë informacion nga njësitë e varësisë, për të mbështetur deklaratën, sipas këtij ligji.*" Pra, lidhur me konsolidimin e të dhënavë të institucionit epror me njësitë e varësisë, në zbatim të bazës ligjore të menaxhimit financiar dhe kontrollit, DH/MFKK në shkresën njoftuese për plotësimin e pyetësorit, ka rivënë theksin në detyrimin që ka institucioni epror në procesin e njoftimit zyrtar për plotësimin e pyetësorit nga njësitë e varësisë (nëse ka) dhe dërgimin për konsolidimin e përgjigjeve. Gjithashtu, njësitë publike konfirmojnë për shpërndarjen e pyetësorit të vetëvlerësimit tek njësitë e varësisë dhe konsolidimin e informacionit nëpërmjet evidencave mbështetëse të dhëna në përgjigjet e arsyetuara në pyetësor (pyetja nr. 8, për raportimet e njësive të varësisë për realizimin e veprimtarisë së tyre). Gjithashtu, siç përmendëm dhe më sipër në gjetjen nr. 2, DH/MFKK ka menaxhuar dhe analizuar të gjithë pyetësorët e vetëvlerësimit të dorëzuar si dhe është bërë vlerësimi për çdo pyetje përbërëse të tij (për 99 pyetjet), siç dëshmuar edhe pranë grupit të auditimit. Përbledhja dhe konsolidimi i të dhënavë të pyetësorëve të vetëvlerësimit është kryer sipas mënyrës së vlerësimit të parashikuar në udhëzuesin e pyetësorit, theksojmë për të gjitha pyetjet, dhe është paraqitur në Raportin Vjetor për secilin grup institucionesh (përkatësisht ministri, bashki dhe këshilla qarku, institucione të pavaruar+grupi 87 si dhe njësitë shpenzuese me buxhet të madh). Ndërkohë, vlerësimi i performancës së sistemeve të kontrollit të brendshëm, është çështje e ndryshme në Raportin Vjetor, dhe nuk lidhet me vlerësimin e gjendjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm, i cili bazohet në vetëvlerësimin e raportuar nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, siç përcaktohet në nenin 18 të ligjit të MFK. Për vlerësimin e performancës së sistemeve të kontrollit të brendshëm, është zbatuar Metodologja për Monitorimin e Performancës së Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë Publike (Urdhri nr. 117, datë 01.04.2019), specifisht mbi bazën e 3 treguesve të performancës për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Vlerësimi i këtyre treguesve është bazuar mbi analizimin e pyetjeve të pyetësorit të vetëvlerësimit, ku theksojmë se dy prej treguesve janë vlerësuar mbi bazën e analizimit të 30 pyetjeve specifike të pyetësorit, ndërkohë që treguesi "Gjithëpërfshirja dhe rregullsia e raportimit vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm", është vlerësuar mbi bazën e analizimit të të gjitha pyetjeve në pyetësor.

**Qëndrimet e Audituesve Shtetërorë të KLSH:** DH/MFK nuk rezulton të ketë bërë konsolidim të rezultateve të pyetësorëve të vetëvlerësimit për çdo njësi që ka raportuar pranë Drejtorisë apo vlerësim specifik për situatën e cdo njësie, objektiv ky që solli rishikimin e pyetësorit të vetëvlerësimit. Vlerësimi në pikë sipas përgjigjeve të dhëna në pyetësor është bërë sipas indikatorëve të MFK

Përsa i përket Rekomandimit nr 4. Bazuar në programin e auditimit 458/1, datë 09.06.2020, si dhe në planin e punës të DH/MFKK miratuar nëpërmjet shkresës nr. 4642 Prot, datë 19.03.2019, bazuar në rekomandimet e ekspertëve të mbështetjes teknike të strategjisë së menaxhimit të financave publike, nga Bashkimi Europian, (paragrafi “*Përhapja e vizitave në terren gjatë vittit mund të zgjidhë problemin e kapacitetit gjatë muajve të parë të çdo viti. Rezultatet e vizitave në terren mund të përdoren më pas kur analizohen rezultatet e pyetësorëve*”) si dhe në raportin e KLSH të vittit 2018 (gjetje nr. 13...Pra monitorimet kryhen vetem për efekt të raportit vjetor dhe jo si një monitorim i vazhdueshëm nga ana e DH/MFK me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm metodologjisë, standardeve dhe udhëzimeve, i cili është një nga detyrimet kryesore të kesaj drejtorie, cituar në manual...), procesi i vizitave në terren për vitin 2019 u konceptua për t'u zhvilluar përgjatë gjithë vittit 2019. Në mbështetje të këtyre rekomandimeve, por edhe për të paraqitur informacionin e përvitshëm në raportin vjetor të përgatitur në vitin 2019, si dhe për të ruajtur vijimësinë dhe konsistencën e raportimit në lidhje me monitorimet, në këtë raport (të përgatitur në vitin 2019) janë përfshirë vetëm 5 nga monitorimet e parashikuara për vitin 2019 (në periudhën Mars - Prill), bazuar në planin e punës së miratuar. Ndërkojë, për 12 institucionet e tjera ka vijuar normalisht procesi i monitorimit sipas këtij plani. Në institucionet e monitoruara në pjesën tjeter të vittit 2019, përveç situatës së viti 2018, struktura e DH/MFKK ka monitoruar edhe Planin e Veprimit për Ngritjen e Sistemit të MFK-së për vitin 2019 duke siguruar kështu një mbulim të veprimtarisë përgjatë dy viteve (2018-209). Me qëllim, ruajtjen e vijimësisë, si dhe paraqitjen e një informacioni sa më të qartë e të konsoliduar në raportin vjetor të KBFP për vitin 2019 (hartuar në muajin Maj të vittit 2020) janë paraqitur gjetjet e konstatuara në këto monitorime për të gjitha njësitë e monitoruara, gjatë vittit 2019. Në vijim, në Raportet vjetore të sistemeve të kontrollit të brendshëm, do të paraqiten vetëm monitorimet e realizuara në vitin për të cilin raportohet.

Ndërkojë, përsa i përket procesit të monitorimit në terren, theksojmë se, vlerësimi i funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme vjen si një kërkesë ligjore ku, bazuar në ligjin për menaxhimin financier dhe kontrollin, neni 18, pika 1, përcakton në bazë të vetëvlerësimeve detyrimin e Nëpunësit Autorizues të njësisë së qeverisjes së përgjithshme për të depozitar te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues deklaratën dhe raportin përkates për cilësinë dhe gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike që mbulan. Duke u bazuar në këto raportime, hartoher pjesa e Raportit Vjetor lidhur me vlerësimin e gjendjes së sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili paraqitet nga Ministri përgjegjës për financat në Këshillin e Ministrave. Në këtë mënyrë, ashtu sikurse del qartë nga specifikimet ligjore, vlerësimi i gjendjes së sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme kryhet mbi bazën e Deklaratës dhe Raportit vjetor të cilësisë dhe gjendjes së sistemit të kontrollit të brendshëm të depozitura pranë DH/MFKK nga këto njësi.

**Ky vlerësim, nuk përfshin rezultatet e procesit të monitorimit në terren.** Ashtu sikurse theksohet në nenin 26, pika 3, procesi i monitorimit është i ndarë nga procesi i përgatitjes së raportit vjetor si më poshtë: “*Struktura Përgjegjëse e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin ndihmon Nëpunësin e Parë Autorizues dhe Ministrin e Financave për monitorimin e sistemeve të menaxhimit financier dhe kontrollit për përgatitjen e raportit vjetor për gjendjen e menaxhimit financier dhe kontrollit publik, ku përmblidhet informacioni i marrë, në përpunhje me dispozitat e nenit 18 të këtij ligji*”. Vlen të theksojmë se, gjetjet dhe rekomandimet në lidhje me monitorimet në terren, të paraqitura në Raportin Vjetor të KBFP, janë një angazhim plotësues i MFE, me qëllim

dhëni e një kuadri sa më informues, për veprimtarinë e njësive të qeverisjes së përgjithshme, në lidhje me zbatimin e kërkesave të ligjit të MFK. Gjithashtu, theksojmë se procedura për përgjedhjen e dhe realizimin e vizitave në terren është kryer në përputhje të plotë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, ku paraprakisht, bazuar edhe në rekomandimet e KLSH të lëna në raportin e viti 2019 (DH/MFKK nuk rezulton të ketë kryer dhe dokumentuar një analizë për përgjedhjen e njësive që janë monitoruar...) nëpërmjet Memos së datës 29.01.2020, është njoftuar drejtuesi i strukturës së harmonizimit për kontrollin e brendshëm financiar publik për përgjedhjen dhe miratimin e listës së institucioneve që do të monitorohen gjatë vitit 2020. Nga ana tjetër, në përfundim të procesit të monitorimit, një raport i detajuar me gjetje dhe rekomandime konkrete i'u është dërguar njësive të monitoruara dhe do të ndiqet në vazhdimësi ecuria e veprimtarisë së tyre mbi bazën e planeve të veprimit për zbatimin e këtyre rekomandimeve.

Për sa i përket monitorimeve të viti 2020, gjetjet dhe rekomandimet për të cilat do të janë pjesë e Raportit Vjetor që do të përgatitet gjatë viti 2021, sqarojmë se, DH/MFKK ka miratuar nëpërmjet shkresës nr. 2709, datë 06.02.2020, planin e trajnimeve, asistencës teknike dhe monitorimeve në terren për vitin 2020. Në këtë plan ishin planifikuar 17 institucione për tu monitoruar gjatë vitit 2020. Në bazë të planit të miratuar, nisi procesi i monitorimit në dy prej institucioneve të përgjedhura, proces i cili u ndërpërdi për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19. Për këtë arsy, në muajin Maj u hartua dhe miratua plani i rishikuar i punës (Memo datë 12.05.2020), ku u përcaktuan për tu monitoruar 6 institucione brenda rrëthit të Tiranës, proces i cili filloj gjatë muajit Korrik.

Duke marrë në konsideratë programin e miratuar të auditimit dhe periudhën në të cilën do të kryhej auditimi, theksojmë se, DH/MFKK ka realizuar objektivat dhe aktivitetet e përcaktuara në planin e punës për vitin 2019, duke përfshirë dhe aktivitetet në kuadër të realizimit të procesit të monitorimit në vend të sistemit të kontrollit të brendshëm (**17 njësi publike të monitoruara**). Për më tepër, DH/MFKK ka paraqitur në Raportin Vjetor për vitin 2019, informacionin e plotë e të konsoliduar lidhur me të gjithë monitorimet e realizuara përgjatë gjithë viti 2019, në zbatim të rekomandimeve dhe planit të punës përkatës, duke paraqitur gjithë informacionin relevant për vitin 2019, të ndryshëm nga ai për vitin 2018

**Qëndrimet e Audituesve Shtetërorë të KLSH: Në vijim te observacionit mbi projekt reportin grupit të auditimit struktura e DH/MFK i ka vendosur në dispozicion 21 dokumentacione shoqëruese mbi monitorimet ku më konkretisht:**

**I) Mbi monitorimin e sistemit të MFK në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas shkresës nr 4642/1 Prot me datë 27.05.2019**

Referuar monitorimit të vendosur në dispozicion nga DH/MFK grupi i auditimit sqaron se bashkangjitur njoftimit për monitorim, me anë të shkresës nr 13407 Prot me datë 15.07.2019 ku DH/MFK jep rezultatet e monitorimit të zhvilluar, ku në paragrafin 18 të tij thotë: "Në përfundim të këtij procesi, për vitin 2018...." pra cilëson faktin se monitorimi i zhvilluar përsa i përket sistemeve të kontrollit të Brendshem i referohet vitit 2018 dhe si i tillë nuk mund të konsiderohet përsa i përket sistemeve të kontrollit të brëndshëm për vitin 2019. Në përfundim të monitorimit DH/MFK jep gjithashtu 11 rekomandime

**2) Mbi monitorimin e sistemit të MFK në Ministrinë e Shëndetsisë dhe Mbrojtjes Sociale sipas shkresës nr 13414 Prot me datë 15.07.2019**

Referuar monitorimit të vendosur në dispozicion nga DH/MFK grupi i auditimit sqaron se në paragrafin 18 të tij thotë: "Në përfundim të këtij procesi, për vitin 2018...." pra cilëson faktin

*se monitorimi i zhvilluar përsa i përket sistemeve të kontrollit të Brendshem i referohet viti 2018 dhe si i tillë nuk mund të konsiderohet përsa i përket sistemeve të kontrollit të brëndshëm për vitin 2019. Në përfundim të monitorimit DH/MFK jep gjithashtu 9 rekomandime*

*3) Mbi monitorimin e sistemit të MFK në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural sipas shkresës nr 23106 Prot me datë 16.12.2019*

*Referuar monitorimit të vendosur në dispozicion nga DH/MFK grupi i auditimit sqaron se bashkangjitur njostimit për monitorim, me anë të shkresës nr 112623 Prot me datë 03.07.2019 ku DH/MFK jep rezultatet e monitorimit të zhvilluar, ku në paragrafin 18 të tij thotë: "Në përfundim të këtij procesi, për vitin 2018...." pra cilëson faktin se monitorimi i zhvilluar përsa i përket sistemeve të kontrollit të Brendshem i referohet viti 2018 dhe si i tillë nuk mund të konsiderohet përsa i përket sistemeve të kontrollit të brëndshëm për vitin 2019. Në përfundim të monitorimit DH/MFK jep gjithashtu 15 rekomandime*

*4) Mbi monitorimin e sistemit të MFK në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit sipas shkresës nr 13183 Prot me datë 19.07.2019*

*Referuar monitorimit të vendosur në dispozicion nga DH/MFK grupi i auditimit sqaron se në paragrafin 18 të tij thotë: "Në përfundim të këtij procesi, për vitin 2018...." pra cilëson faktin se monitorimi i zhvilluar përsa i përket sistemeve të kontrollit të Brendshem i referohet viti 2018 dhe si i tillë nuk mund të konsiderohet përsa i përket sistemeve të kontrollit të brëndshëm për vitin 2019. Në përfundim të monitorimit DH/MFK jep gjithashtu 7 rekomandime*

*5) Mbi monitorimin e sistemit të MFK në Ministrinë e Drejtësisë sipas shresës nr 24495 Prot me datë 31.12.2019*

*Referuar monitorimit të vendosur në dispozicion nga DH/MFK grupi i auditimit sqaron se në paragrafin 18 të tij thotë: "Në përfundim të këtij procesi, për vitin 2018...." pra cilëson faktin se monitorimi i zhvilluar përsa i përket sistemeve të kontrollit të Brendshem i referohet viti 2018 dhe si i tillë nuk mund të konsiderohet përsa i përket sistemeve të kontrollit të brëndshëm për vitin 2019. Në përfundim të monitorimit DH/MFK jep gjithashtu 8 rekomandime*

*6) Mbi monitorimin e sistemit të MFK në Ministrinë e Evropës dhe Punët e Jashtme sipas shkresës nr 16831 Prot me datë 20.09.2019*

*Në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga DH/MFK dhe sipas shkresës së sipërcituar nuk jepen rezultatet e monitorimit të realizuar por vetëm shkresa informuese e padokumentar mbi realizimin e monitorimit*

*7) Mbi monitorimin e sistemit të MFK në Ministrinë e Kulturës sipas shkresës nr 16928 Prot me datë 23.09.2019*

*Referuar monitorimit të vendosur në dispozicion nga DH/MFK grupi i auditimit sqaron se bashkangjitur njostimit për monitorim, me anë të shkresës nr 21203 Prot me datë 19.11.2019 ku DH/MFK jep rezultatet e monitorimit të zhvilluar, ku në paragrafin 18 të tij thotë: "Në përfundim të këtij procesi, për vitin 2018...." pra cilëson faktin se monitorimi i zhvilluar përsa i përket sistemeve të kontrollit të Brendshem i referohet viti 2018 dhe si i tillë nuk mund të konsiderohet përsa i përket sistemeve të kontrollit të brëndshëm për vitin 2019. Në përfundim të monitorimit DH/MFK jep gjithashtu 8 rekomandime*

*8) Mbi monitorimin e sistemit të MFK në Ministrinë e Mbrojtjes sipas shkresës nr 21188 Prot me datë 18.11.2019*

*Referuar monitorimit të vendosur në dispozicion nga DH/MFK grupi i auditimit sqaron se bashkangjitur njostimit për monitorim, me anë të shkresës nr 963 Prot me datë 17.01.2020 ku DH/MFK jep rezultatet e monitorimit të zhvilluar, ku në paragrafin 18 të tij thotë: "Në*

përfundim të këtij procesi,për vitin 2018.... ” pra cilëson faktin se monitorimi i zhvilluar përsa i përket sistemeve të kontrollit të Brendshem i referohet viti 2018 dhe si i tillë nuk mund të konsiderohet përsa i përket sistemeve të kontrollit të brëndshëm për vitin 2019.Në përfundim të monitorimit DH/MFK jep gjithashtu 9 rekondime

9) Mbi monitorimin e sistemit të MFK në Bashkinë Vlorë sipas shkresës nr 5808 Prot me datë 04.04.2019

Me anë të kësaj shkrese jepet vetëm njoftimi për fillimin e monitorimit dhe si i tillë nuk mund të konsiderohet si monitorim i kryer përsa kohë nuk jepet asnjë evidencë mbështetëse

10) Mbi monitorimin e sistemit të MFK në Bashkinë Vlorë sipas shkresës nr 13412 Prot me datë 15.07.2019

Referuar monitorimit të vendosur në dispozicion nga DH/MFK grupi i auditimit sqaron se në paragrafin 18 të tij thotë: “Në përfundim të këtij procesi,për vitin 2018.... ” pra cilëson faktin se monitorimi i zhvilluar përsa i përket sistemeve të kontrollit të Brendshem i referohet viti 2018 dhe si i tillë nuk mund të konsiderohet përsa i përket sistemeve të kontrollit të brëndshëm për vitin 2019. Në përfundim të monitorimit DH/MFK jep gjithashtu 13 rekondime

11) Mbi monitorimin e sistemit të MFK në Bashkinë Krujë sipas shkresës nr 16928 Prot me datë 23.09.2019

Me anë të kësaj shkrese jepet vetëm njoftimi për fillimin e monitorimit dhe si i tillë nuk mund të konsiderohet si monitorim i kryer përsa kohë nuk jepet asnjë evidencë mbështetëse

12) Mbi monitorimin e sistemit të MFK në Bashkinë Shijak sipas shkresës nr 16928 Prot me datë 23.09.2019

Me anë të kësaj shkrese jepet vetëm njoftimi për fillimin e monitorimit dhe si i tillë nuk mund të konsiderohet si monitorim i kryer përsa kohë nuk jepet asnjë evidencë mbështetëse

13) Mbi monitorimin e sistemit të MFK në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë i paprotokolluar dhe pa datë

Referuar monitorimit të vendosur në dispozicion nga DH/MFK grupi i auditimit sqaron se në paragrafin 26 të tij thotë: “Në përfundim të këtij procesi,për vitin 2018.... ” pra cilëson faktin se monitorimi i zhvilluar përsa i përket sistemeve të kontrollit të Brendshem i referohet viti 2018 dhe si i tillë nuk mund të konsiderohet përsa i përket sistemeve të kontrollit të brëndshëm për vitin 2019. Në përfundim të monitorimit DH/MFK jep gjithashtu 8 rekondime

14) Mbi monitorimin e sistemit të MFK në Bashkinë Tropojë sipas shkresës nr 8876 Prot me datë 14.05.2019

Referuar monitorimit të vendosur në dispozicion nga DH/MFK grupi i auditimit sqaron se bashkangjitur njoftimit për monitorim,me anë të shkresës nr 13410 Prot me datë 15.07.2019 ku DH/MFK jep rezultatet e monitorimit të zhvilluar,ku lënda është: “Mbi monitorimin e cilësisë së Sistemit të Kontrollit të Brëndshëm për Bashkinë Tropojë për vitin 2018” gjithashtu në paragrafin 18 të tij thotë: “Në përfundim të këtij procesi,për vitin 2018.... ” pra cilëson faktin se monitorimi i zhvilluar përsa i përket sistemeve të kontrollit të Brendshem i referohet viti 2018 dhe si i tillë nuk mund të konsiderohet përsa i përket sistemeve të kontrollit të brëndshëm për vitin 2019.Në përfundim të monitorimit DH/MFK jep gjithashtu 11 rekondime

15) Mbi monitorimin e sistemit të MFK në Bashkinë Tropojë sipas shkresës nr 13410 Prot me datë 15.07.2019

DH/MFK jep rezultatet e monitorimit të zhvilluar,ku lënda është: “Mbi monitorimin e cilësisë së Sistemit të Kontrollit të Brëndshëm për Bashkinë Tropojë për vitin 2018” gjithashtu në

*paragrafin 18 të tij thotë: "Në përfundim të këtij procesi,për vitin 2018...." pra cilëson faktin se monitorimi i zhvilluar përsa i përket sistemeve të kontrollit të Brendshem i referohet vitit 2018 dhe si i tillë nuk mund të konsiderohet përsa i përket sistemeve të kontrollit të brëndshëm për vitin 2019. Në përfundim të monitorimit DH/MFK jep gjithashtu 11 rekomandime*

*16) Mbi monitorimin e sistemit të MFK në Bashkinë Devoll sipas shkresës nr 5463 Prot me datë 01.04.2019*

*Referuar monitorimit të vendosur në dispozicion nga DH/MFK grupi i auditimit sqaron se bashkangjitur njofitimit për monitorim,me anë të shkresës nr 13411 Prot me datë 15.07.2019 ku DH/MFK jep rezultatet e monitorimit të zhvilluar,ku në paragrafin 18 të tij thotë: "Në përfundim të këtij procesi,për vitin 2018...." pra cilëson faktin se monitorimi i zhvilluar përsa i përket sistemeve të kontrollit të Brendshem i referohet vitit 2018 dhe si i tillë nuk mund të konsiderohet përsa i përket sistemeve të kontrollit të brëndshëm për vitin 2019.Në përfundim të monitorimit DH/MFK jep gjithashtu 10 rekomandime*

*17) Mbi monitorimin e sistemit të MFK në Ministrinë e Arsimit,Sportit dhe Rinisë sipas shkresës nr 9904 Prot me datë 24.05.2019*

*Referuar monitorimit të vendosur në dispozicion nga DH/MFK grupi i auditimit sqaron se bashkangjitur njofitimit për monitorim,me anë të shkresës nr 13789 Prot me datë 19.07.2019 ku DH/MFK jep rezultatet e monitorimit të zhvilluar,ku në paragrafin 18 të tij thotë: "Në përfundim të këtij procesi,për vitin 2018...." pra cilëson faktin se monitorimi i zhvilluar përsa i përket sistemeve të kontrollit të Brendshem i referohet vitit 2018 dhe si i tillë nuk mund të konsiderohet përsa i përket sistemeve të kontrollit të brëndshëm për vitin 2019.Në përfundim të monitorimit DH/MFK jep gjithashtu 10 rekomandime*

*18) Mbi monitorimin e sistemit të MFK në Bashkinë Krujë sipas shkresës nr 19767 Prot me datë 01.11.2019*

*Referuar monitorimit të vendosur në dispozicion nga DH/MFK grupi i auditimit sqaron se në paragrafin 18 të tij thotë: "Në përfundim të këtij procesi,për vitin 2018...." pra cilëson faktin se monitorimi i zhvilluar përsa i përket sistemeve të kontrollit të Brendshem i referohet vitit 2018 dhe si i tillë nuk mund të konsiderohet përsa i përket sistemeve të kontrollit të brëndshëm për vitin 2019. Në përfundim të monitorimit DH/MFK jep gjithashtu 13 rekomandime*

*19) Mbi monitorimin e sistemit të MFK në Bashkinë Shijak sipas shkresë nr 17768 Prot me datë 01.11.2019*

*Referuar monitorimit të vendosur në dispozicion nga DH/MFK grupi i auditimit sqaron se në paragrafin 18 të tij thotë: "Në përfundim të këtij procesi,për vitin 2018...." pra cilëson faktin se monitorimi i zhvilluar përsa i përket sistemeve të kontrollit të Brendshem i referohet vitit 2018 dhe si i tillë nuk mund të konsiderohet përsa i përket sistemeve të kontrollit të brëndshëm për vitin 2019. Në përfundim të monitorimit DH/MFK jep gjithashtu 12 rekomandime*

*20) Mbi monitorimin e sistemit të MFK në Këshillin e Lartë Gjyqësor sipas shkresës nr 1343 Prot me datë 15.07.2019*

*Referuar monitorimit të vendosur në dispozicion nga DH/MFK grupi i auditimit sqaron se në paragrafin 18 të tij thotë: "Në përfundim të këtij procesi,për vitin 2018...." pra cilëson faktin se monitorimi i zhvilluar përsa i përket sistemeve të kontrollit të Brendshem i referohet vitit 2018 dhe si i tillë nuk mund të konsiderohet përsa i përket sistemeve të kontrollit të brëndshëm për vitin 2019. Në përfundim të monitorimit DH/MFK jep gjithashtu 10 rekomandime*

*21) Mbi monitorimin e sistemit të MFK në Kryeministri sipas shkresës nr 6181 Prot me datë 09.04.2019*

*Referuar monitorimit të vendosur në dispozicion nga DH/MFK grupi i auditimit sqaron se bashkangjitur njoftimit për monitorim, me anë të shkresës nr 13408 Prot me datë 15.07.2020 ku DH/MFK jep rezultatet e monitorimit të zhvilluar, ku në paragrafin 18 të tij thotë: "Në përfundim të këtij procesi, për vitin 2018...." pra cilëson faktin se monitorimi i zhvilluar përsa i përket sistemeve të kontrollit të Brendshem i referohet vitit 2018 dhe si i tillë nuk mund të konsiderohet përsa i përket sistemeve të kontrollit të brëndshëm për vitin 2019. Në përfundim të monitorimit DH/MFK jep gjithashitu 12 rekondime*

Përsa i përket rekondimit nr 5. Në vijim të gjetjeve të pretenduara, përsa i përket vlerësimit të efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke marrë në konsideratë 17 parimet e modelit ndërkombëtar të kontrollit të brendshëm (COSO) mbështetur në rekondimet e SIGMA nëpërmjet dokumentit: Udhëzime për vlerësimin e cilësisë së sistemeve të kontrollit të brendshëm ("Guidelines for assessing the quality of internal control systems"), si edhe rekondimet e lëna në Raportin e mëparshëm të Auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit (Raporti i vitit 2018 me shkresën nr. 301/9, datë 08.08.2018, ku cilësohej se DH/MFKK në rolin e saj si konsoliduese e të dhënavë bën vetëm një përbledhje mekanike të shifrave dhe një analizë të thjeshtë statistikore si dhe ku matja me pikë e efektivitetit evidentonte vetëm të dhëna statistikore dhe jo një vlerësim cilësor e gjithëpërfshirës të tij), fokusi i raportit vjetor të KBFP-së është konsolidimi i përgjigjeve konkrete të arsyatura të njësive publike pa u bazuar në një vlerësim sasior, i cili edhe nga eksperiencia e viteve të kaluara, nuk paraqet situatën reale të gjendjes së sistemit të kontrollit të brendshëm.

Ndërkojë, siç përsëritet dhe në gjetjet e mësipërme, (gjetjet 2 dhe 3) vlerësimi me pikë dhe rankimi i njësive publike është bërë mbi bazën e vlerësimit të 18 treguesve të performancës së përcaktuar në metodologjinë e monitorimit të performancës dhe nuk lidhet me vlerësimin e gjendjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm, i cili bazohet në vetëvlerësimin e raportuar nga njësitet e qeverisjes së përgjithshme, siç përcaktohet në nenin 18 të ligjit të MFK.

Për vitin 2019, 139 njësi të qeverisjes së përgjithshme kanë raportuar sipas detyrimit ligjor pranë DH/MFKK, e cila ka përbledhur të dhënat e përfshira në pyetësorët e vetëvlerësimit duke u bazuar në **99 pyetjet e këtij pyetësori sipas 17 parimeve të COSO**. Përpunimi i të dhënavë kryhet duke u bazuar në udhëzuesin për vlerësimin e sistemit të MFK-së, miratuar me **Urdhrin e ministrit përgjegjës për financat nr. 117, datë 01.04.2019 "Për miratimin e Metodologjisë për Monitorimin e Performancës së Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë Publike"**.

Sipas këtij udhëzuesi, sistemi do të vlerësohet sipas tre kategorive "efektiv", "pjesërisht efektiv" dhe "jo efektiv". Ky vlerësim, gjenerohet nga mesatarja e përpunimeve të raportimeve të njësive të qeverisjes së përgjithshme. Analiza bëhet për çdo parim dhe për çdo njësi që raporton, ku pjesa më e madhe e parimeve janë raportuar "*pjesërisht efektiv*" dhe si rrjedhojë i gjithë sistemi i kontrollit të brendshëm është raportuar si pjesërisht efektiv.

Vlen të ritheksohet, se ky proces vlerësimi është i rekonduar nga SIGMA, nëpërmjet dokumentit: Udhëzime për vlerësimin e cilësisë së sistemeve të kontrollit të brendshëm ("Guidelines for assessing the quality of internal control systems"), për përgatitjen e të cilës është angazhuar edhe vendi ynë, si dhe bazuar në rekondimet e KLSH, në lidhje me saktësinë e vetëvlerësimit me pikë nga ana njësive të qeverisjes së përgjithshme (ku matja me pikë e efektivitetit evidentonte vetëm të dhëna statistikore dhe jo një vlerësim cilësor e gjithëpërfshirës të tij).

Ndërkojë, mbi gjetjet e grüpuit të auditimit se efektiviteti i sistemit për vitin 2018 është në masën 72% dhe se kjo shifër është përcaktuar nga mesatarja e treguesit të performancës

“Gjithëpërfshirja dhe rregullsia e raportimit vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm”, sqarojmë se, vlera prej 72% nuk lidhet me efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, por paraqet vlerësimin mesatar për treguesin e sipërpermendur.

*Gjithashtu, vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, bazuar në konsolidimin e vetëvlerësimeve të njësive të qeverisjes së përgjithshme, paraqitet nëpërmjet raportit vjetor të vlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm në mbledhjen e Bordit të KBFP*

**Qëndrimet e Audituesve Shtetërorë të KLSH:** Grupi i auditimit ka konstatuar se për vitin 2019, nuk është kryer një përllogaritje e caktuar, si dhe nuk ka të dokumentuar kriteret/indikatorët/treguesit sipas së cilave DH/KBFP ka konkluduar në një sistem “pjesërisht efektiv”. Përllogaritja është kryer në mënyrë individuale por jo për të përcaktuar sistemin në tërësi

Përsa i përket rekomandimit nr 6 Lidhur me gjetjet e grupit të auditimit mbi raportimet e njësive të varësisë dhe konsolidimin e të dhënavë të institucionit epror me njësitë e varësisë, evidentojmë se, siç përmendëm edhe më sipër lidhur me gjetjen nr. 3, DH/MFKK në shkresën njoftuese për plotësimin e pyetësorit, ka rivënë theksin në detyrimin që ka institucioni epror në procesin e njoftimit zyrtar për plotësimin e pyetësorit nga njësitë e varësisë (nëse ka) dhe dërgimin për konsolidimin e përgjigjeve. Gjithashtu, njësitë publike konfirmojnë për shpërndarjen e pyetësorit të vetëvlerësimit tek njësitë e varësisë dhe konsolidimin e informacionit nëpërmjet evidencave mbështetëse të dhëna në përgjigjet e arsyetuara në pyetësor (pyetja nr. 8, për raportimet e njësive të varësisë për realizimin e veprimitari së tyre).

Siç theksuan edhe në gjetjen e mësipërme, treguesi nr. 13. *Gjithëpërfshirja dhe rregullsia e raportimit vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm, nuk lidhet me efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm*, por është pjesë e vlerësimit të performancës, sipas metodologjisë për monitorimin e performancës. Bazuar në këtë metodologji, miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, me Urdhrin nr. 117, datë 01.04.2019, ky tregues vlerësohet bazuar në gjykimin profesional të punonjësve të DH/MFKK, ku ndër të tjera përfshihet edhe raportimi nga njësitë publike mbi konsolidimin e informacionit nga njësitë e varësisë (pyetja nr. 8 e pyetësorit të vetëvlerësimit).

**Qëndrimet e Audituesve Shtetërorë të KLSH:** Me rishikimin e pyetësorit, është përpiluar edhe një pyetësor për njësitë e varësisë për të cilat institucionet që kanë raportuar pranë MFE duhet të kishin kryer konsolidimin e të dhënavë dhe veçanërisht ky indikator lidhet me këtfë çështje, por faktikisht në asnjë nga pyetësorët e dorëzuar nuk është identifikuar të jetë kryer ky proces, dhe për më tepër në metodologjinë e vlerësimit të këtij indikatori nuk është parashikuar kryerja e verifikimit nga stafi i drejtorisë për garantimin e gjithëpërfshirjes në vetëvlerësimin e sistemeve të kontrollit nga varësitë

Përsa i përket rekomandimit nr 7. Për sa i përket realizimit të procesit të ofrimit të asistencës teknike gjatë vitit 2019, ashtu siç është vënë në dijeni paraprakisht grupi i auditimit, në mbledhjet e Bordit të KBFP, datë 25.09.2019, dhe 19.12.2019 është bërë përzgjedhja e institucioneve pilot, bazuar në nivelin e riskut të veprimitarisë që ato kryejnë si dhe gjendjes së sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe ndryshimi për shkak të fatkeqësisë natyrore shkaktuar nga tërmeti i muajit Nëntor 2019. Përzgjedhja për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, merr në konsideratë edhe tregues performance që lidhen me planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit si edhe të veprimitarisë së njësive të auditimit të brendshëm, faktorë që janë marrë parasysh gjatë përcaktimit të institucioneve pilot në Bordin e KBFP.

Për institucionet pilot, është dërguar njoftimi me shkresë zyrtare në fundin e muajit Dhjetor dhe nisi puna për realizimin e aktiviteteve të parashikuara në fillim të vitit 2020. Theksojmë se plani i aktiviteteve për realizimin e asistencës teknike, është ndarë në misione specifike dhe ju është dërguar institacioneve pilot së bashku me shkresën njoftuese për fillimin e këtij procesi (bashkëlidhur, plani i aktiviteteve për realizimin e asistencës teknike).

Ndërkohë, përsa i përket planit të aktiviteteve në kuadër të shtyllës 5 të strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020, theksojmë se DH/MFKK ka realizuar të gjitha aktivitetet në përputhje me këtë plan (bashkëlidhur, raporti vjetor i monitorimit për vitin 2019, objektivi specifik 6). Gjithashtu, vlen të theksojmë, se procesi i përzgjedhjes së institacioneve pilot, prej vitit 2021, do të jetë i rregulluar sipas metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, e cila do të miratohet brenda viti 2020 (bashkëlidhur drafti i kësaj metodologjje).

**Qëndrimet e Audituesve Shtetërorë të KLSH:** Grupit të auditimit nuk i është vendosur dokumentacion shoqëruar mbi metodikën e përzgjedhjes së institacioneve për asistencë teknike dhe gjithashtu nuk është kundërshtuar mbi pilotimet në institucionet e përzgjedhura për mosrealizim

Përsa i përket rekomandimit nr 8. Siç theksuan dhe në gjetjet më sipër (gjetjet 2, 3, 5 dhe 6), vlerësimi i performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike është bazuar në metodologjinë e monitorimit të përfomancës (Urdhri nr. 117, datë 01.04.2019) e konceptuar mbi 18 tregues të kombinuar që ndihmojnë për të krijuar opinionin mbi performancën e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësitë e sektorit publik. Vlerësimi i tre treguesve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, mbështetet në analizën dhe gjykimin profesional të strukturës përgjegjëse për harmonizimin e MFKK-së mbi përbushjen e kritereve të vlerësimit për çdo tregues, në përputhje me përcaktimet e Urdhrit të sipërpërmendor.

Për çdo grup institucionesh, janë analizuar të gjitha pyetjet dhe janë vlerësuar nga 1-4 pikë 30 prej tyre, të cilat i korrenspodojnë pikave të fokusit të përcaktuara në metodologji.

Sqarojmë se, për të gjitha institucionet për të cilat pyetësori i vetëvlerësimit nuk është i plotë (janë përgjigjur me PO ose JO), vlerësimi është bërë vetëm me 1 ose 2 pikë për çdo pyetje. Ndërkohë që, për institucionet, përgjigjet e të cilave për pyetje të caktuara kanë qënë të arsyetuara dhe kanë pasur referencë dokumentacionin justifikues, vlerësimi është bërë me 3 ose 4 pikë. Vlerësimi është bërë, në përputhje me përcaktimet e Urdhrit nr. 117 të sipërcituar, bazuar në gjykimin profesional të stafit të DH/MFKK mbi situatën e prezantuar. Gjykimi profesional i stafit bazohet në ndërveprimin dhe komunikimin e vazhdueshëm me njësitë publike, monitorimet dhe asistencat teknike, si dhe trajnimet e zhvilluara. Nëpërmjet këtyre aktiviteteve funksionale, stafi i MFK ka krijuar gjykimin e nevojshëm dhe të duhur, duke u bazuar në cilësinë dhe anagazhimin e njësive publike në zbatimin e kritereve dhe kërkesave ligjore.

Në funksion të evidentimit të problematikave dhe ndërmarrjes së masave për përmirësimin e sistemit të MFK-së, DH/MFKK ka paraqitur në raport disa çështje për adresim.

Gjithashtu, ashtu siç evidentuar nga ana e strukturës së DH/MFKK në Raportin e KBFP, por edhe nga grapi i auditimit, ende ekziston fenomeni i dhënieve së përgjigjeve formale në pyetësorin e vetëvlerësimit. Ndërkohë, për përmirësimin e standardeve të punës dhe procesin e monitorimit, DH/MFKK ka hartuar dhe dërguar për miratim Metodologjinë për Vlerësimin e Cilësisë së Kontrollit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

**Qëndrimet e Audituesve Shtetërorë të KLSH:** Vlerësimi i pyetorëve është realizuar në mënyrë jo të drejtë dhe konsistente ndërmjet institacioneve duke patur parasysh që për

**përgjigje të ngjashme vlerësimi ka qënë i ndryshëm, sikundër evidentohet nga disa raste të trajtuar nga grupi i auditimit, dhe diferenca ndërmjet vlerësimeve për të njëjtën përgjigje sikurse trajtuar edhe ne Projektraport shkon në ekstremitet**

Përsa i përket rekomandimit nr 9. Për sa i përket treguesve të performancës së përfshirë në Strategjinë e rishikuar të Menaxhimit të Financave Publike 2019-2022, sqa rojmë se këto tregues janë konceptuar në bashkëpunim me ekspertët e Projektit të Asistencës Teknike të kësaj strategji dhe janë gjithëpërfshirës. Vlen të theksojmë se, në krahasim me startegjinë e MFP 2014 – 2020, kemi një tregues më shumë për matjen e performancës (pra, dy tregues), gjë që tregon rëndësinë që Qeveria Shqiptare i po i kushton në vijimësi zhvillimeve në sistemin e kontrollit të brendshëm. Matja e këtyre treguesve realizohet në bazë të të dhënave të gjeneruara nga pyetësorët e vetëvlerësimit (në mënyrë të ngjashme si në strategjinë e MFP 2014-2020). Njëri nga treguesit e performancës mbetet i njëjtë në thelb me treguesin e paraqitur në pasaportën e indikatorëve të Strategjisë së MFP 2014-2020, duke shprehur masën në të cilën është implementuar sistemi i MFK-së në njësitë publike, ndërkojë qe treguesi i ri, e kalon fokusin në zbatimin e mekanizmave të përgjegjshmërisë menaxheriale, si një nga elementët më të rëndësishëm për krijimin dhe funksionimin e një sistemi efektit të kontrollit të brendshëm, që ndërkojë vjen dhe si kërkesë nga Bashkimi i European në kuadër të kërkesave për integrim. Baza e matjes për këto tregues është viti 2019, kur edhe ka filluar të zbatohet kjo strategji. Gjithashtu, theksojmë se, përpëra hartimit të strategjisë së re të MFP dhe përcatimit të produkteve dhe treguesëve të rishikuar të performancës, nga ana e strukturës drejtuese për menaxhimin e reformës në financat publike është kryer një analizë (përfshirë në raportin e monitorimit të strategjisë) mbi arritjet dhe problematikat kryesore të hasura në realizimin e objektivave të përcaktuara në strategjinë e mëparshme përfushën e kontrollit të brendshëm (bashkëlidhur raporti i monitorimit përf vitin 2019).

**Qëndrimet e Audituesve Shtetërorë të KLSH:Ndryshimet në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike 2019-2022 nuk identifikojnë një metodologji identifikative dhe kuantitative në funksion të treguesve të matshëm**

Përsa i përket rekomandimit nr 10. Për sa i përket konstatimeve të grupit të audimit, lidhur me menaxhimin e regjistrave të NA dhe NZ, sqa rojmë se, bazuar edhe në rekomandimet e kaluara të KLSH-së, është përditësuar regjistri i ri i NA dhe NZ. Ky regjistër përditësoshet, sipas njoftimeve të nëpunësve autorizues, të njësisë publike, në përputhje me nenet 19 dhe 20, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, “për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Përsa i përket mungesës së të dhënave mbi NZ, ju bëjmë me dije se në këto raste për shkak të vakancës së krijuar në pozicionin e NZ, ky pozicion mbulohet përkohësisht nga NZ i institucionit e pror, i cili është i konfirmuar paraprakisht sipas kritereve ligjore. Gjithashtu, përsa i përket monitorimit mbi përfundimin e afatit të konfirmimit të përkohshëm të NA apo NZ (të përcaktuara qartë në shkresat e konfirmimit nga ana e DH/MFKK), dega e thesarit përkatëse është përgjegjëse përfundimin e veprimeve të mëtejshme si firma të autorizuara. Për më tepër, rastet e delegimit në mungesë të funksioneve, nuk trajtohen nga ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin, por sipas Kodit të Procedurave Administrative. Autorizimet për delegimin në mungesë, trajtohen nga degët përkatëse të thesarit.

Në rastet e evidentuara përfundim të dhënat, siç shihet qartë edhe nga databaza e vënës në dispozicion, përfundimtët projekte është bërë ndryshimi i NA apo NZ, evidentuar edhe me shkresat e konfirmimit në rend kronologjik. Ruajtja e të dy rekordave nuk cënon cilësinë apo organizimin e dokumentave elektronikë.

Ritheksojmë se, regjistri mbahet për efekt disponimi informacioni të përgjithshëm për institucionet, por nuk ndikon në ecurinë dhe cilësinë e punës pasi përditësimet (regjistrimet në databazë) bëhen pasi vijnë njoftimet përkatëse për ndryshimin e firmave nga ana e vetë institucioneve. Qëllimi i gjithë procedurës është të shërbejë si një mekanizëm shtesë kontrolli lidhur me plotësimin të kërkesave ligjore, që duhet të zbatohen nga njësitë publike në caktimin e NA dhe NZ.

Gjithashtu, DH/MFKK bëri verifikimet përkatëse edhe për lapsusin (si rezultat i të dhënave të hedhura në regjistër) e konstatuar për Degën e INSTAT Korçë ku paraqitet i regjistruar i njëjtë nëpunës si NA dhe NZ. Aktualisht, pranë këtij institucioni si NA është konfirmuar me shkresën e MFE nr. 2239/1, datë 07.02.2020, [REDACTED] me shkresën e MFE nr. 7493, datë 9.06.2014 (bashkëlidhur, shkresat e konfirmimit përkatëse për NA dhe NZ).

Mbi institucionet buxhetore që sipas strukturës organike kanë të njëjtë specialist regjistrues me nëpunësin zbatues, sqarojmë se për sa i përket funksioneve dhe përgjegjësive të nëpunësve të financës që do të janë pjesë e këtij procesi, nuk është kompetencë e DH/MFKK përcaktimi i tyre. Përcaktimi i këtyre funksioneve, mbetet në tagrin e institucionit përkatës dhe këto funksione/detyra janë të evidentuara në përshkrimet e punës të punonjësve. Mënyra e aksesit të këtyre nëpunësve në sistem, përcaktohet nga struktura përgjegjëse për thesarin, e cila do të ndjekë trajnimin e tyre dhe certifikimin si përdorues të sistemit AFMIS. Pra, kërkesat e legjislacionit për menaxhimin financiar dhe kontrollin lidhur me ndarjen e detyrave dhe rolin e përgjegjësitë e NZ për këtë çështje janë zbatuar nga një pjesë e institucioneve, gjë që tregon se nuk ka paqartësi në këtë drejtim. Në këtë kuadër, përbërja dhe ndarja e detyrave të punonjësve, pjesë e strukturave të financës apo çështjet teknike të aksesimit të sistemit, nuk janë kompetencë e DH/MFKK.

Lidhur me afatin e dërgimit të observacioneve nga DH/MFKK për Akt Konstatimin nr. 2 dhe 3 (përcjellë me shkresën e KLSH në datën 13 dhe 14 Gusht 2020) gjatë hartimit të projekt raportit, ju bëjmë me dije se ky dokument është nisur me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 25271/3, datë 21.08.2020, brenda afateve të përcaktuara (bashkëlidhur shkresa përcjellëse).

**Qëndrimet e Audituesve Shtetërorë të KLSH:** Referuar nenit 22 pika 3 të ligjit 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” ku thotë: ”Veprimataritë e kontrollit përbajnjë, minimalisht: a) procedurat dhe autoritetin për delegimin, transferimin dhe regjistrimin e autorizimit standard dhe të rasteve të veçanta; b) ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjtë punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, sipas udhëzimit të Ministrit të Financave; c) sistemin e dy nënshkrimeve, i cili nuk lejon që angazhimi finansiar të kryhet pa marrë nënshkrimet e nëpunësit autorizues dhe të nëpunësit zbatues të njësisë; ç) sistemin e dy nënshkrimeve, i cili nuk lejon që pagesa të kryhet pa marrë nënshkrimet e nëpunësit autorizues dhe të nëpunësit zbatues të njësisë apo të nëpunësve të deleguar prej tyre; d) të drejtat për përdorimin e aktiveve dhe të informacionit të njësisë dhe mbrojtjen e aktiveve; dh) procedurat për kontabilizimin e plotë, të saktë, të rregullt dhe në kohë të gjitha transaksioneve, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave; e) procedurat për raportimin, mbikëqyrjen, vlerësimin e eficencës dhe të efektivitetit të veprimtarive; ë) procedurat e monitorimit; f) rregullat për menaxhimin e burimeve njerëzore; g) rregullat për dokumentimin e të gjitha transaksioneve dhe të veprimtarive që lidhen me mbarëvajtjen e

njësisë; gj) rregullat për garantimin e ruajtjes së informacionit dhe të aktiveve të njësisë". Legjislacioni i sipërcituar e cilëson në mënyrë të qarte që problematikat e evidentuara bëjnë pjesë në veprimtarinë e kontrollit

### III.3 AUDITIM MBI REKOMANDIMEV E AUDITIMIT TË MËPARSHËM (në referencë të Aktkonstatimit nr. 3 pjesë e këtij Projektraporti):

1. Qëndrimi neglizhuesndaj rekomandimeve të KLSH, të vërejtur të paktën në tre vitet e fundit, ka bërë që problematikat e konstatuara nga auditimet të vijojnë të ekzistojnë dhe mos marrja e masave për përmirësimin e situatës ka sjellë impakt në cilësinë e menaxhimit financiar dhe kontrollit, në nivelin e dobët të sistemeve të kontrollit në entet publike dhe rritjen e nevojës për auditim të jashtëm.

Situata: Në zbatim të ligjit nr 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15 gërrma J "Kontrolli i Lartë i Shtetit,sipas rastit,në fillim,përgjatë dhe/ose në përfundim të veprimtarisë duhet të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre,për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm,brënda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës"  
Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të dërguara në Drejtorinë e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, paraqitet si më poshtë:

Janë rekomanduar 27 masa organizative të cilat janë ndarë në:

- **13 Masa Organizative** drejtuar Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (DH/MFK), nga të cilat janë pranuar 8 masa organizative. Nga masat organizative të pranuara, **1 masë është realizuar**, **5 masa organizative janë në proces zbatimi, dhe 2 masa organizative nuk janë realizuar**. Lidhur me 5 masat organizative që nuk janë pranuar...
- **14 Masa Organizative** drejtuar Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm (DH/AB), nga të cilat janë pranuar 14 masa organizative. Nga masat organizative të pranuara, **3 masat janë realizuar**, **8 masa organizative janë në proces zbatimi, dhe 3 masa organizative nuk janë realizuar**. Lidhur me rekomandimin “**Mbi zbatimin e rekomandimeve në auditimin e mëparshëm**”, struktura e DH/KBFP nuk e ka marrë në konsideratë, dhe si pasojë situata nga viti në vit lidhur me aktivitetin e kësaj Drejtorie ka ardhur duke u përkeqësuar.

**Rekomanduar Masë Disiplinore**, për dy persona. **E pa zbatuar**

**Kriteri:**

*Ligji nr. 154/2014 dt. 19.2.2015 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” Neni 15 gërmec; Neni 16, pika 1; Neni 25 pika ç; Neni 30 pika 1 dhe 2*

**Impakti:**

Problematikat e konstatuara nga auditimet në DH/KBFP vijojnë të ekzistojnë dhe mos marrja e masave të duhura për përmirësimin e situatëska sjellë impakt në cilësinë e menaxhimit financiar dhe kontrollit, në nivelin e dobët të sistemeve të kontrollit në entet publike dhe rritjen e nevojës për auditim të jashtëm.

**Shkaku:**

NPA dhe Titullari i Institucionit, nuk ka marrë masat e duhura dhe mbeten në mosveprim për përmirësim të situatës.

**Rëndësia:**

E lartë

#### IV.GJETJET DHE REKOMANDIMET

##### B. MASA ORGANIZATIVE MBI AKTIVITETIN E DREJTORISË SË HARMONIZIMIT TË AUDITIT TË BRENDSHËM

**1. Gjetje nga auditimi:** Në sektorin publik janë krijuar dhe funksionojnë tetë (8) komitete auditimi përkatesisht në: Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Shërbimit Social, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme, Ministrinë e Kulturës dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit. Gjatë vitit 2019 ka përfunduar mandati i Komitetit të Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Mbrojtjes dhe aktualisht ky organ nuk është riorganizuar akoma. Në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë nuk është krijuar ende Komiteti i Auditimit të Brendshëm. Në Ligjin nr. 114/2015, neni 3 pika 2, është përcaktuar se: “*Komiteti i Auditimit të Brendshëm, në ato njësi publike ku krijohet, e shtrin autoritetin për të gjitha njësitë e varësisë*” dhe në pikën 3 është përcaktuar se: “*Mënyra e funksionimit, kompetencat dhe përbërja e Komitetit të Auditimit të Brendshëm rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrit të Financave*”. Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM nr. 160, datë 02.03.2016 “Për mënyrën e funksionimet kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të

Brendshëm në njësitë publike”, ka përcaktuar se: “*Anëtarët e Komitetit të Auditimit të Brendshëm emërohen me urdhër të titullarit të njësisë publike, si ...*”, pra emërimi lihet në diskrecion të Titullarit të Institucionit, pa ndonjë procedurë të mirë përcaktuar mbi vlerësimin e profesionalizmit dhe kapaciteteve që do përfshihen në këto Komitete. Nga analizimi i këtyre strukturave, konstatojmë që një pjesë e tyre shfaqen si anëtar në më shumë se një Komitet, fakt që tregon se përcaktimet e bëra në kornizën ligjore kanë një spektër të kufizuar të ekspertëve që mund të përfshihen në këto struktura.

Strukturat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si përgjegjëse për bashkërendimin e përgjithshëm, harmonizimin dhe monitorimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik, për analizimin e funksionimit të komitetave, i kanë kërkuar të gjitha ministrive të sipërcituara vënien në dispozicion të raportit vjetor të veprimtarisë të se cilët Komitet të Auditimit të Brendshëm (KAB). Bazuar në këto raporte evidentohet se, gjatë kësaj periudhe komitetet e ngritura, kanë funksionuar bazuar në përcaktimet e akteve ligjore. Nisur nga Raportet Vjetore të depozituara (dërguara) pranë DH/AB, të cilat na u vunë në dispozicion, kemi konstatuar që një pjesë e rëndësishme e strukturave të Komitetave të Auditimit funksionojnë pa një rregullore të brendshme të miratuar. Është zbatuar përgjithësisht realizimi i numrit minimal të përcaktuar në bazën rregullative të mbledhjeve të tyre. Ndërsa referuar fushave ku është përqendruar aktiviteti i tyre, kemi konstatuar se fokusi i tyre ka qenë kryesisht në shqyrtim dhe miratim të kartës së auditimit, miratimi i planeve strategjik dhe vjetore dhe në pak raste gjëjmë një analizë të punës së strukturave AB apo dhe ballafaqim me problematikat që ka ngritur KLSH lidhur me aspekte të MFK dhe veçanërisht të AB. Gjykojmë se roli i deritanishëm i këtyre strukturave nuk justifikon qëllimin për të cilin janë ngritur. Në këtë drejtim kanë ndikuar edhe ndryshimet e përbërjes së këtyre strukturave.

Në Raportin Vjetor të vitit 2019, problematikat dhe rekomandimet e dhëna nga Komitetet e Auditimit jepen jo në mënyrë konkrete për çdo institucion, por në mënyrë të përbledhur megjithëse çdo institucion ka jo vetëm qasje të veçante por dhe raportojnë problematika specifike. Ndërsa po ti referohemi opinionit të dhënë nga Komitetet e Auditimit siç cilësuar në Raportin Vjetor “*Komitetet e Auditimit të Brendshëm konkludojnë se veprimtaria audituese është në përgjithësi në përputhje me kuadrin rregulator, por evidentohet se ka nevojë për përmirësim në fusha specifike për të cilat janë dhënë rekomandimet përkatëse, për çdo NJAB nga Komiteti që mbështet veprimtarinë e auditimit të brendshëm. Titullarët e njësive publike duhet të mbështesin më shumë strukturat e auditimit të brendshëm. Duke vlerësuar kontributin që KAB jep në mbështetjen dhe garantimin e realizimit të auditimit të brendshëm si funksion i pavarur që jep siguri objektive dhe këshillim për menaxhimin, krijimi i Komitetave të Auditimit në njësitë e qeverisjes qëndrore dhe të vetëqeverisjes vendore konsiderohet si një domosdoshmëri për funksionimin e auditimit sipas standardeve dhe praktikave më të mira, në mënyrë të veçantë në njësitë publike që paraqiten me risk të lartë në Matricën e Riskut*”, gjykojmë se nuk është i saktë dhe i mbështetur në evidencat që disponon DH/AB lidhur me aktivitetin e këtyre Komitetave. Krijimi i Komitetave në strukturat e qeverisjes qëndrore, është një hap pozitiv për të ndihmuar në garantimin e pavarësisë së strukturave të AB dhe rritjen e profesionalizmit të tyre, por që mbetet akoma larg objektivave dhe qëllimeve të synuara. Analiza e punës dhe aktivitetetit të strukturave AB nga këto Komitete është akoma e vakët dhe në disa raste nuk është marrë fare në analizë. Nuk konstatojmë vëmendje të shtuar në zbatimin e rekomandimeve me efekt në forcimin e sistemeve të brendshme të kontrollit. Nuk konstatohet që për vitin 2019, këto struktura të kenë rapportuar raste të trajtimit të konfliktit të interesit në realizimin e angazhimeve audituese.

Në Raportin Vjetor, DH/AB raporton se në asnjë nga njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk është

*krijuar Komiteti i Auditimit të Brendshëm. DH/AB ka përgjedhur gjashtë njësi të pushtetit vendor, për dhënien e asistencës së duhur në lidhje me krijimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, referuar shkresës nr.13893, datë 22.07.2019 “Mbi krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm”, e cila i është dërguar Bashkisë Tiranë, Bashkisë Durrës, Bashkisë Vlorë, Bashkisë Lezhë, Bashkisë Kavajë dhe Bashkisë Pogradec. Gjithashtu parashtronhet kërkesa për shtrirjen e këtyre Komitetetve në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, por ne gjykojmë se kjo kërkesë nuk është e mbështetur në analiza studimore të situatës së auditit të brendshëm në vend, dhe kur flitet për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore është jo vetëm e parakohshme por mbart një risk të lartë duke ju referuar kapaciteteve në dispozicion. Në gjykimin tonë Komitetet e Auditimit duhet të funksionojnë fillimi që kanë shumë njësi varësie (si në rastin e Bashkisë Tiranë me 25 ndërmarrje në varësi). Ndërsa fakti i cilësuar që njësitë publike të përgjedhura, kanë një nivel të lartë të detyrimeve të prapambetura, gjë që i rendit në njësi me risk të lartë dhe me nevojë imediate për të vlerësuar shkaqet e krijimit të tyre nëpërmjet vlerësimit me efektivitet të sistemeve të kontrollit të brendshëm me anë të analizës dhe rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe monitorimit nga Komiteti i Auditimit të Brendshëm për një miradiministrim të fondeve publike, nuk rezulton i bazuar në të dhëna konkrete (mbi baza të të cilave arrihet në këtë konkluzion) si dhe nuk është arsyё për të justifikuar ngritjen e strukturave të auditimit për sa kohë që përgjegjësia për kontrollin dhe monitorimin e detyrimeve të prapambetura është e strukturave drejtuese të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (Nënpunësi i Parë Autorizues).*

**1.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik përmes Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, të marrë masat për një raportim objektiv dhe të mbështetur në evidenca mbi aktivitetin e Komitetetve të Auditimit, në Raportin Vjetor mbi funksionimin e KBFP. Në kuadër të ndryshimeve/përmirësimëve ligjore të synuara tëpërcaktohet drejt mënyra dhe kriteret për krijimin e Komitetetve të Auditimit, përbërja e tyre dhe detyrimet për ndjekjen, mbikëqyrjen dhe raportimin e aktivitetit të strukturave AB.

#### Menjëherë dhe në vijimësi

**2. Gjetje nga auditimi:** Edhe për vitin 2019, analiza e veprimitarisë së auditimit të brendshëm është kryer nga konsolidimi i të dhënave të raporteve vjetore të njësive të auditimit të brendshëm, që raportojnë aktivitetin e tyre pranë DH/AB. Konstatohet se, sikundër është trajtuar edhe në auditimet e mëparshme të KLSH, nuk rezulton një analizë e plotë në shkallë sistemi nga ana e DH/AB për njësitë të cilat plotësojnë kushtet e nevojshme për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në nivel qendror, njësi të vetëqeverisjes, institucione të pavarura dhe shoqëri aksionare, me qëllim që kjo njësi të jep ndihmesën e saj për ngritjen dhe funksionimin e njësive të auditimit të brendshëm në shkallë vendi. DH/AB nuk ka të dhëna të sakta lidhur me mbulimin me auditim për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme me qëllim që të përcaktohen kapacitetet audituese dhe nevojat për mbulim me auditim në shkallë sistemi me njëren nga format e përcaktuara në nenin 10 “Organizimi i shërbimit të Auditimit të Brendshëm” të Ligjit 114/2015 dt.22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik” dhe në VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar megjithëse sipas kërkesave të nenit 24 të Ligjit 114/2015 dt.22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”, për monitorimin e veprimitarisë së AB në nivel kombëtar. DH/AB ka detyrim të realizojë këtë analizë. Problematikat jepen në përgjithësi dhe jo

duke cilësuar subjektet problematike në të cilat strukturat nuk janë ngritur dhe funksionojnë në përputhje me kërkesat ligjor. Në gjykim të grupit të auditimit, Drejtoria e Harmonizimit raporton në reportin vjetor të KBFP në nivel të përgjithshëm, pavarësisht se në këtë raportim përfshihen vetëm 129 njësi (dy më shumë se viti i kaluar), numër që në gjykimin tonë nuk përfaqëson informacion të mjaftueshëm për njësitë të cilat plotësojnë kushtet e nevojshme për ngritjen e njësive të auditimit në nivel qendror, njësi të vetëqeverisjes, institucionë të pavarura dhe shoqëri aksionare. Pra sistemi sipas DH/AB, përfshin 129 NJAB, numër që nuk krahasohet me numrin e institucioneve të cilat duhet sipas ligjit të raportojnë mbulimin më auditim të brendshëm. Për vitin 2019, nuk kanë mbulim me shërbim auditimi në një nga format e ligjit *Bashkia Belsh; Bashkia Has; Bashkia Pukë; Bashkia Konispol dhe Bashkia Delvinë*. Lidhur me këtë situatë nuk ka dokumentim për veprimet që Drejtoria e Harmonizimit/AB ka bërë për të inkurajuar realizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm sipas një nga mënyrave të përcaktuara në ligj. Institucionë të pavarura pa mbulim me shërbim auditimi sipas një nga formave të ligjit, për vitin 2019, raportohen 31 institucionë.

Është vlerësuar përputhshmëria me kërkesat ligjore e strukturave të AB në referencë të VKM nr. 83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditit të brendshëm në sektorin publik”, ku përcaktohet: “Njësia e AB përbëhet nga jo më pak se tre punonjës përfshirë dhe drejtuesin e njësisë”, ...në strukturën përgjegjëse të njësisë së auditimit të brendshëm mund të punësohen deri në 1/3 e punonjësve të pa certifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik” nga ku konstatohet se janë raportuar 47 njësi auditimi me më pak se 3 auditues. Janë 21 institucionë që në strukturën e AB kanë vetën 1 punonjës ndërkohë që në Bashkinë Himarë, struktura e auditimit nuk ka asnjë punonjës ndërsa 25 institucionë janë më nga 2 punonjës. Për vitin 2019, 36% e strukturave nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në VKM nr. 83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditit të brendshëm në sektorin publik”, për sa i takon plotësisë së këtyre strukturave.

Rezultoi se janë 32 institucionë që në përbërje të strukturave të NJAB-ve kanë më shumë se 1/3 të punonjësve të pa certifikuar, situatë që bie në kundërshtim me kriterin e Ligjit nr. 114/2015 dt.22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. Ndërkohë që në 5 prej tyre nuk ka asnjë punonjës të certifikuar në strukturën e NJAB-së.

**Si konkluzion, në fund të vitit 2019, kemi rreth 28% të strukturave AB të paplotësuara, ndërkohë që 20% e audituesve në nivel sistemi janë të pa certifikuar.** Të dhënat krahasimore ndër vite pasqyrohet në tabelën e mëposhtme.

Pershkrimi/Vitet	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Numri i njësive të auditimit	106	100	103	112	119	127	129
Pozicioni të auditimit të plotësuara (në %)	95%	93.9%	92%	93%	93%	91%	72%
Auditues të certifikuar (në %)	85%	82.9%	90%	76%	77%	77%	80%

Burimi: Përpunuar nga KLSH (2020)

Nga auditimet e realizuara nga KLSH në njësitë e vetëqeverisjes vendore, kemi konstatuar edhe komandim të punonjësve në pozicionin e “Inspektorit të Auditimit”, në kundërshtim me nenin 48, pika 1, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, rasti i Bashkive Delvinë, Rrogozhinë. Struktura me kualifikim jo të përshtatshëm konsatuam në Bashkitë Shkodër, Patos, Himarë, Klos, Rrogozhinë, Cërrrik, Skrapar, Maliq.

**2.1 Rekomandimi:** : Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit Brendshëm Financiar Publik përmes Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, të plotësojë analizën për identifikimin e nevojave për mbulim me auditim të brendshëm në rang kombëtar dhe përcjelljen e

këtij informacioni pranë Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, duke rekomanduar dhe hapat konkretë për të raportuar drejt nivelin e strukturave dhe kapaciteteve të AB.

**Rekomandimi 2.2:** Ministri i Financave dhe Ekonomisë të përcaktojë afate konkrete për plotësimin e analizës së strukturave të AB dhe në raportimin e vitit 2020, raportimi i sistemeve të KBFP të bazohet në një numër përfaqësues subjektesh që kanë shërbim AB funksional.

**Rekomandimi 2.3:** DH/AB në funksion të përgjegjësive të saj, të marrë masat për kryerjen e monitorimeve të vazhdueshme pranë titullarëve të njësive publike të cilat nuk plotësojnë kërkesat ligjore në strukturat respektive dhe përcjelljen e këtij informacioni edhe pranë strukturave përgjegjëse për punësimin e punonjësve në sektorin publik.

#### Menjëherë dhe në vijimësi

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i raportimit të NJAB-ve lidhur me auditimet e kryera, është kryer analizimi i këtyre të dhëna respektivisht me numrin e audituesve në këto struktura, për të dhënë një pamje të qartë të ngarkesave të strukturave AB. Konstatohet se ka një shpërndarje të pabarabartë të ngarkesës në rang sistemi. Nga verifikimi i të dhënave të vëna në dispozicion nga DH/AB vihet re se strukturat AB të ngritura në 10 (dhjetë) institucione nuk kanë realizuar asnjë mision auditimi, çka tregon formalitet të auditimit të brendshëm. Nga verifikimi në planin strategjik të konsoliduar vihet re se secila nga strukturat e këtyre institucioneve ka bërë planifikim.

Nga llogaritjet e grupit të auditimit për ngarkesën e audituesve me auditim përgjatë vitit 2019, konstatohen nivele të ulëta të ngarkesës me auditimi, duke filluar me Bashkinë Rrogozhinë me 0.5 auditime për auditues në periudhën vjetore, pasuar nga aktiviteti i audituesve të OSHEE me 0.7 auditime për auditues në vit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me 0.9 auditime për auditues në vit, ndërkohë që në 51 institucione niveli i auditimeve ka qenë me pak se 2.5 auditime për auditues në vit. Nëse do të bënim një grupim të situatës së institucioneve dhe numrit të auditimeve të kryera do të kishim:

Nr. Auditim	0	0-2.5	2.5-4	4-6	6-8	8+	N/a	Totali
Nr i Institucioneve	10	51	47	12	4	4	1	129

Burimi: Përpunuuar nga KLSH (2020)

**3.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit Brendshëm Financiar Publik përmes Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm, *në mënyrë të menjëherësme duhet të analizojë me profesionalizëm dhe në mënyrë të detajuarçështjen e efektivitetit dhe eficencës së njësive AB dhe të reflektojë këtë analizë dhe rezultatet e saj në opinionet e dhëna në raportin vjetor të KBFP. Raportimi i DH/AB të ndalojë jo vetëm në problematikat e përgjithshme por edhe në cilësimin e subjekteve që nuk përformojnë detyrat funksionale dhe paguhen nga paratë e shtetit për punë të pakryer.*

#### Menjëherë dhe në vijimësi

**4. Gjetje nga auditimi:** Bazuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016, kapitulli II, pika 2.2 d, ku përcaktohet se: *Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm: d) Përgatit dhe administron planin e konsoliduar strategjik dhe vjetor të veprimtarisë së auditimit të brendshëm në njësitë publike.*

*Sipas formave standard tē planit strategjik tē përcaktuar në kapitullin III tē Manualit e Auditimit tē Brendshëm në Sektorin Publik, përcaktohet se: "Pasqyrat e planit strategjik dhe vjetor duhet tē plotësohen në EXCEL" dhe pjesë e tij janë 5 pasqyrat përbledhëse.*

*Pasqyra 1 "Vlerësimi i nivelit të riskut pér tē gjithë subjektet që duhet tē auditohen nga NJAB"*

*Pasqyra 2 "Plani strategjik i subjekteve të synuara pér t'u audituar pér vitet"*

*Pasqyra 3 "Plani i angazhimeve të NJAB pér vitin"*

*Pasqyra 4 "Planifikimi i nevojave pér trajnim të NJAB pér vitin"*

*Pasqyra 5 "Planifikimi i buxhetit dhe shpérndarja e burimeve te NJAB pér vitin"*

Nga shqyrtimi i planit strategjik tē konsoliduar tē vënë nē dispozicion nga Struktura Përgjegjëse e Harmonizimit pér AB rezultoi se konsolidimi pér çdo format pasqyre tē jetë si vijon:

*Pasqyra 1 "Vlerësimi i nivelit të riskut pér tē gjithë subjektet që duhet tē auditohen nga NJAB" konsolidimi i kësaj pasqyre është bërë konform formatit*

*Pasqyra 2 "Plani strategjik i subjekteve të synuara pér t'u audituar pér vitet"- nē këtë pasqyrë mungojnë kolonat përkrah viti tē planifikuar që përcaktojnë nivelin e riskut pér periudhat 1+2.*

*Pasqyra 3 "Plani i angazhimeve të NJAB pér vitin" është konsoliduar sipas formatit tē përcaktuar*

*Pasqyra 4 "Planifikimi i nevojave pér trajnim të NJAB pér vitin "nuk është konsoliduar sipas formatit standard tē kërkuar nē manual, por përcaktohen vetëm temat e identifikuara dhe mungojnë kolonat nē lidhje me pjesëmarrësit nē trajnim, periudhën gjatë viti tē dhe kohëzgjatja e trajnimit, pér secilin nga institucionet".*

*Pasqyra 5 "Planifikimi i buxhetit dhe shpérndarja e burimeve te NJAB pér vitin", konsolidimi i kësaj pasqyre është bërë sipas formatit tē përcaktuar.*

Në formatet Manualit tē Auditimit tē Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016, kapitulli III, përcaktohet formati i Pasqyrës nr.1: "Vlerësimi i nivelit të risqeve pér tē gjithë subjektet që do tē auditohen nga NJAB". Ajo çka vihet re nga verifikimi i pasqyrës së konsoliduar e përgatitur nga Drejtoria e Harmonizimit tē Auditimit tē Brendshëm është se nē planin e konsoliduar nuk paraqiten tē gjitha subjektet dhe fushat pér çdo institucion, por thjesht jepen numrat e subjekteve, fushave dhe vlerësimet e risqeve te fushave/subjekteve nē tē lartë, tē mesëm dhe tē ulët. Pér tē bërë kontrollin e saktësisë dhe plotësisë nē lidhje me konsolidimin e kësaj pasqyre u përzgjodh një kampion:*Ministria e Brendshme; Ministria e Shëndetësisë; Ministria e Infrastrukturës dhe Energetikes; Ministria e Financave dhe Ekonomisë; Bashkia Durrës; Bashkia Elbasan; Bashkia Fier; Bashkia Vlorë; Bashkia Tiranë.*

Nga verifikimi i pasqyrave individuale tē secilit nga këto subjekte tē zgjedhura u vu re se subjektet dhe fushat ishin tē identifikuara, por nē planin e konsoliduar nuk janë.

Tek Bashkia Vlorë fusha tē plotësuara janë 12 dhe jo 16 sëc paraqitet te plani i konsoliduar, tabela nuk është e plotësuar plotësisht tek kolona e fushave nuk përcaktohen fushat pér subjektet e parashikuara pér auditim. Vetëm një nga fushat e shënuara tek kolona e planit individual, "Analiza e situatës se institucionit lidhur me detyrimet e prapambetura" është fushë, elementët e tjerë duhet tē ishin tek kolona e parë "Subjektet". Pra plani individual i Bashkisë Vlorë ka problematika nē plotësim.Bashkia Tiranë rezulton me diferenca, me totalitet e raportuara pér çdo kolonë te planit individual dhe asaj tē konsoliduar. Tek zonat me risk, diku janë përdorur x dhe diku 1 nē kolonat e risqeve dhe ajo çka rezulton është se janë mbledhur kufizat e plotësuara me shifrën 1 dhe totalitet nuk dalin tē sakta, nga rillogaritja nga ana jonë e totaleve tē zonave me risk përkatësisht i lartë, i mesëm dhe i ulët nuk rezulton, që shifrat tē janë tē njëjtë më planin individual dhe me planin e konsoliduar, po ashtu diferenca vërehen dhe tek kolonave e

fushave. *Ministria e Brendshme*-Nga verifikimi i tabelës individuale të kësaj ministrie rezultoi se mungon rreshti i totalit në fund, nga përllogaritjet tona sipas fushave të plotësuara në këtë tabelë individuale rezulton se ka diferenca me planin e konsoliduar të përgatitur nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm ne totalin e fushave për t'u audituar. *Ministria e Shëndetësisë & Mbrojtjes Sociale*- nga verifikimi i bërë në lidhje me tabelën individuale (pasqyra 1) të këtij institucioni konstatuan se mungon rreshti i totalit në fund, nga përllogaritjet tona sipas fushave të plotësuara në këtë tabelë individuale rezulton se ka diferenca me planin e konsoliduar të përgatitur nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm. *Ministria e Financave dhe Ekonomisë* - nga verifikimi i bërë në lidhje me tabelën individuale (pasqyra 1) të këtij institucioni konstatuan se mungon rreshti i totalit në fund, nga përllogaritjet tona sipas fushave të plotësuara në këtë tabelë individuale rezulton se ka diferenca me planin e konsoliduar të përgatitur nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.

*Sa më sipër konkludojnë së nuk ka një metodologji të mire përcaktuar për të shërbyer si guidë për çdo institucion në plotësimin e pasqyrave të planeve individuale, e cila ka shkaktuar që në disa institucione të rezultojnë problematika në totalitet e tabelave për numërimin e zonave me risk të lartë, të mesëm dhe të ulët. Pasqyra e konsoliduar nuk është ë plotë, në të nuk paraqiten fushat dhe subjektet për t'u audituar po janë vërmë vetëm shifrat sesa të tilla janë. Po ashtu nga verifikimi i nëntë institacioneve të përzgjedhura gjashë kanë rezultuar si me problematika dhe diferenca në atë çka rezulton nga verifikimi ynë dhe nga plani i konsoliduar i DH/AB. Po ashtu diferenca ka dhe mes planeve individuale dhe atij të konsoliduar. Në përfundim grupi i auditimit nuk shpreh dot siguri të arsyeshme përsa i përket mënyrës së hartimit të planit të konsoliduar, nëse është kryer në formën e një inkorporimi mekanik të këtyre planeve në Planin e Konsoliduar Strategjik dhe Vjetor apo është përpunuar informacioni i dhënë nga njësità publike.*

Bazuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm në sektorin Publik, përcaktohet se: *Plani Strategjik dhe Plani Vjetor, i përgatitur nga njësität e AB, para se të dërgohet përmiratim tek titullari i njësisë publike, duhet të dërgohet përmendim tek Komiteti i Auditimit të Brendshëm deri me datën 30 Shtator të çdo viti, i cili e shqyrton dhe jep mendim deri me datën 10 Tetor të çdo viti. Planet pas dhënies së mendimit të KA-së, miratohen nga titullari i institucionit dhe ato dërgohen jo më vonë se data 20 Tetor e çdo viti, në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm. Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, brenda datës 15 Dhjetor të çdo viti përgatit planin e konsoliduar strategjik dhe vjetor për të gjithë veprimtarinë e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik.*

Nga verifikimi i planeve vjetore dhe strategjike u konstatua se pranë Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2019, kanë dorëzuar planet 124 subjekte. Konstatohen 19 institucione të cilat kanë datën e dërgimit të planeve përtrej afatit të përcaktuar ligjor dhe 69 subjekte të cilat kanë mbërritur pranë MFE në këtë afat. Ndërsa subjektit, të cilat ka mungesë së dhënat në lidhje më afatin e dërgimit dhe mbërritjes pranë MFE janë Autoriteti Portual Durrës; Universiteti Politeknik i Tiranës; Qendra Spitalore Korçë.

Në lidhje me ndryshimet në planet vjetore, rezultojnë të jenë kryer në total vetëm 22 ndryshime në planet respektive të njësive publike, të shoqëruar me shkresa për ndryshim planesh drejtuar DH/AB, pavarësisht devijimeve më të shumta në numër të reportuara në planin filletar të auditimeve të këtyre strukturave. Krahasuar me vitin 2018, ku kanë qenë 18 rishikime planesh në vitin 2019 ka pasur 22, pra një rritje. Ndryshimet e planeve në fund të vit më tepër lidhen më tepër me ligjërinë e mosrealizimeve se me nevojën për ndryshime reale.

*Sipas Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar me urdhrrin nr.100, datë 25.10.2016, kapitulli III, pikë 3.5 “Rishikimi i planeve strategjikë dhe vjetor të Auditimit të*

*Brendshëm*" përcaktohet se: Ndryshimet në planin vjetor të Auditimit të Brendshëm duhet të arsyetoohen me shkrim nga drejtuesi i NjAB, ndryshime të cilat miratohen nga titullari i njësisë, pasi të jetë marrë edhe mendimi i Komitetit të Auditimit, (atje ku krijohet). Nga shqyrtimi i të dhënave me rishikimet e kryera në plane u konstatua se kriteri i mësipërm nuk është zbatuar nga 2 prej 22 institacioneve, të cilat kanë bërë rishikim në plan dhe nuk kanë të përcaktuar arsyen (shpjegimi) e rishikimit përkatësish: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve te Transportit Rrugor dhe Bashkia Krujë. Në lidhje me ndryshimet e bëra, vihet re se jo të gjithë institucionet të cilat kanë bërë rishikim në plan kanë paraqitur pasqyrën nr.3 të ndryshimit të planit. Këtu përfshihen Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"; Bashkia Fier; Bashkia Korçë. Siç përcaktohet dhe në kriterin e sipërcituar të Manualit e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar me urdhrit nr.100, datë 25.10.2016 duhet, që rishikimet të miratohen nga ana e titullarit, ky kriter nuk është plotësuar nga ana e 5 institacioneve: Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"; Bashkia Vlorë; Shërbimi Social Shtetëror; Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Bashkia Krujë.

Nga verifikimi i të dhënave të vëna në dispozicion nga DH/AB mbi auditimet e realizuara dhe atyre të planifikuara në planin strategjik, vihet re ka diferenca në realizimin e planeve: mosrealizime dhe tejkalim të planeve. Nga 119 institacione në të cilat mund të bënim krahasimin plan dhe realizim rezultuan 62 institacione të cilat nuk kanë realizuar planin ose 52% e strukturave, ku diapazoni i këtyre mosrealizimeve është nga 1 në 10 auditime të mos realizuara. 26 institacione ose 22% e strukturave kanë realizuar të njëtin numër auditimesh siç kanë planifikuar, po ashtu ka dhe 31 institacione ose 26% e strukturave të cilat kanë realizuar më shumë auditime krahasuar me planin, ku numrin më të madh të këtij mbi realizimi e mban Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me 57 plane të realizuara nga 15 të planifikuara, etj. Kjo tregon për problem në planifikim ose përfshirjen e audituesve në auditime apo mision të ndryshme nga niveli i planifikuar. Gjithsesi nga strukturat e DH/AB, konstatohet se nuk ka korrespondencia të mjaftueshme si për institucionet që nuk kanë realizim të planit por edhe atyre që shfaqen me tejkalime. Nuk ka indikatorë orientues për të matur dhe vlerësuar ngarkesën e punës së audituesve të brendshëm publik.

**4.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit Brendshëm Financiar Publik përmes Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm, *në funksion të përgjegjësive të saj të përcaktuara në germiën "h" të nenit 24 të LAB, të marrë masat për vlerësimin e përgjegjshëm të mangësive të konstatuara në drejtim të planit të konsoliduar, afatin e dërgimit, llojin e auditimeve të planifikuara, dhe mënyrat e rishikim të këtyre planeve, duke përfshirë këtë problematikë në trajnimet e kryera pranë këtyre njësive.*

**4.2 Rekomandimi:** DH/AB *në përgatitjen e Raportit Vjetor të strukturave AB si pjesë të raportimit mbi sistemet e kontrollit të brendshëm të bëjë një analizë të plotë mbi strukturat që paragiten me mosrealizim apo tejkalim të planeve të angazhimit dhe jo të japë vetëm tregues në nivel sistemi.*

#### Menjëherë dhe në vijimësi

**5. Gjetje nga auditimi:** : Nga auditimi konstatohet se treguesit e performancës të strukturave të AB, janë përkeqësuar. Në bazë të rezultateve të deklaruara në auditimet e kryera përgjatë vitit 2019, konstatohen se në 18 institacione strukturat AB janë më 0 gjetje, po 18 është numri i institacioneve strukturat audituese të të cilave kanë reportuar më pak se 10 gjetje. Në vitin 2018 institucionë me numër gjetjesh 1-10 kanë qenë 28, ndërsa në 2019 ky numër shkon në 36, çka

tregon për një performancë më të dobët të strukturave te NJAB-ve. Janë 70 institucione që paraqiten me më pak se **100.000** lekë dëm ekonomik të konstatuar, ndërkoq që në vitin 2018 kanë qenë **58** institucione strukturat AB të të cilave raportonin një nivel të tillë dëmi, ndërsa në 2019 kemi një rritje me **20%**. Bazuar në rezultatet e deklaruarë në auditimet e kryera përgjatë vitit 2019 për 129 njësitë e auditimit me total 428 auditues, është konstatuar dëm ekonomik në vlerën totale **908 milion** lekë, ose 3,424 milion lekë më pak se një vit më parë. Nëse i referohemi numrit të gjetjeve, për vitin 2019 janë konstatuar **8,593** gjetje të konstatuara, dhe **8,314** rekomandime respektive. Rezulton se në shkallë sistemi, gjetjet e vitit 2019 rezultojnë më të ulëtat në **8** vitet e fundit, dhënë në tabelën e mëposhtme.

*Tabela, vlera e dëmit në nivel total për një periudhë 8 vjeçare, shprehur në 000/lekë me MIE*

Gjetjet	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Totali (në vlerë)	3.199,964	4.321,991	20.138,457	68.789,045	2.111,308	7.848,500	4.332,463	908,022
Totali (në numër)	4,698	3,556	4,441	4,186	9,421	6,286	9,368	8,593
Numri i audituesve	391	387	351	352	386	400	429	428

Burimi i të dhënave: DH/AB përpunuar grupi i auditimit

Nga analiza e dëmit të konstatuar prej 908,022 mijë lekë, përbërja sipas fushave rezulton 29% e vlerës është konstatuar në fushën e tatiimeve, taksave, doganave, 21% e vlerës është konstatuar në fushën e prokurimit publik, 20% në fusha të tjera, 11% është konstatuar në fushën e pagave, 10% është konstatuar në fushën e koncesioneve, ankandeve, 6% në fushën e privatizimit, 1% në sigurime shoqërore e shëndetësore, 1% në administrimin e pronës dhe 1% në kreditime/subvencione. Duke ju referuar të dhënave të raportuara nga KLSH për veprimtarinë audituese përgjatë vitit 2019, rezulton se janë identifikuar parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, **me dëm ekonomik në shumën totale prej 27,304,777 mijë lekë, dhe shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në perfomancën e subjekteve të audituara, në shumën totale prej 130,511,594 mijë lekë, fakt që tregon se ulja e nivelit të gjetjeve nga strukturat AB nuk janë rrjedhojë e performancës më të mirë të subjekteve të audituara.** Më hollësish, sipas fushave në të cilat janë identifikuar dëmet ekonomike dhe shkeljet e disiplinës financiare me efekt negativ ekonomik nga KLSH, krahasuar me njësitet e auditit të brendshëm në sektorin publik, paraqiten si më poshtë:

*Në mijë lekë*

Fusha	NJAB	KLSH		
		Dëm ekonomik	Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ	Total
Sistemet e tatiimeve, taksave, doganave	260,322	1,073,164	45,434,873	46,508,037
Prona, qeradhiqënie dhe koncensione, urbanistika, subvencione	162,432	20,640,915	501,471	21,142,386
Paga, sigurime dhe shpërbërime	111,919	8,028	348,911	356,939
Prokurime	191766	2,095,002	74,821,940	76,916,942
Të tjera	181,580	3,487,667	9,404,498	12,892,065
<b>Total</b>	<b>908,022</b>	<b>27,304,777</b>	<b>130,511,594</b>	<b>157,816,371</b>

Burimi: Përpunuar nga KLSH (2020)

Gjatë vitit 2019, strukturat AB kanë raportuar 3 raste për investigim të mëtejshëm nga njësi të specializuara, krahasuar me 20 raportime të një viti më parë.

**5.1 Rekomandimi:** DH/AB të bëjë një analizë të drejtë dhe të plotë të nivelit të gjetjeve në rapport me shtrirjen e strukturës AB në sektorin publik, llojeve të gjetjeve dhe në reflektim të rekomandimeve të KLSH si auditues i jashtëm, dhe të raportojë drejt pranë Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, nivelin e strukturave AB dhe eficencës së punës së tyre.

## Menjëherë

**6. Gjetje nga auditimi:** Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm (DH/AB), është organi përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të veprimtarisë së njësive të auditimit të brendshëm. Vlerësimi i jashtëm i cilësisë synon të ndihmojë njësítë e auditimit të brendshëm, për të kryer veprimtarinë e tyre në përputhje të plotë me standartet, duke identifikuar dobësitë dhe adresuar risqet që kërcënojnë arritjen e objektivave të auditimit. Këto kontolle kryhen bazuar në Standardet e Auditimit të Brendshëm, si Standardi 1312 ....*Vlerësimet e jashtme duhet të kryhen të paktën një herë në 5 vjet nga një vlerësues i kualifikuar dhe i pavarur ose nga një skuadër vlerësuesish nga jashtë organizatës dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditit të Brendshëm të IIA të cilat përkufizojnë se qdo NJAB duhet të kenë në vlerësim të jashtëm të cilësisë të paktën një herë në 5 vjet nga një shqyrtues i kualifikuar i pavarur jashtë organizatës.* Sipas Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 22 datë 06.03.2017, është miratuar Metodologja e Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik, mbi bazën e të cilit kryhen procedurat e vlerësimit të jashtëm. Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm nuk disponon të dhëna historike të vlerësimeve të kryera më parë, sipas kërkesave të përcaktuara në Metodologjinë e miratuar. Për vitin 2019, rezulton se Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm vlerësoi në total 15 njësi të auditimit të brendshëm (3 Ministri Linje, 3 Institucionale Qendrore, 7 Bashki dhe 2 Shoqëri Aksionarë). Edhe për këtë vit nuk dokumentohet se si është bërë përzgjedhja e subjekteve për vlerësim të cilësisë. Megjithëse konstatohet një rritje e numrit të monitorimeve theksojmë se mbetet shumë për të bërë që të arrihet mbulimi i duhur për strukturat e AB.

**6.1 Rekomandimi:** DH/AB si organi përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të veprimtarisë së NJAB të studiojë me përgjegjësi kapacitetet audituese që ka përmbulimin e detyrave funksionale që rrjedhin nga nen 24 i LAB.DH/AB të përmirësojë kriteret që zbaton për përzgjedhjen e njësive publike në të cilat do të kryhet vlerësimi i jashtëm i cilësisë, në përputhje me kërkesat e Manualit të AB, duke përfshirë subjekte me struktura jo tëkonsoliduar AB.

## Menjëherë

**7. Gjetje nga auditimi:** Ligji nr. 114/2015 datë 15.10.2015 “Për Auditin e Brendshëm në Sektorin Publik”, në nenim 19 “Certifikimi i audituesve të brendshëm” ka përcaktuar se “1. Certifikimi i audituesve të brendshëm organizohet nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, sipas procedurës së miratuar me urdhër të Ministrit të Financave.2. Të drejtën për të aplikuar në procesin e certifikimit e kanë individët e klasifikuar në shkronjën “ç”, të pikës 2, të nenit 11, të këtij ligji. 3. Individët, që zotërojnë një certifikatë profesionale, të njojur ndërkombëtarisht, në fushën e auditimit të brendshëm, i nënshtronen një procedure specifike certifikimi, të përcaktuar në urdhrin e nxjerrë sipas pikës 1 të këtij nenit”.

Rregullorja e Trajnimit të Vijueshëm Profesional të Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar sipas urdhrit nr. 3, datë 08.01.2016 të Ministrit të Financave ka përcaktuar kriteret dhe procedurat e regjistrimit të kandidatëve, duke cilësuar në pikën 2 se “Të drejtën për të aplikuar në procesin e certifikimit e kanë punonjësit që plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligjin e AB në sektorin publik si .... Të jetë i punësuar në njësítë e auditimit të brendshëm në sektorin publik...” **Pra për punonjësit që aplikojnë të certifikohen si auditues të brendshëm si kriter kërkohet**

që të jenë punonjës të auditit të brendshëm në sektorin publik, ndërsa për njehsimin e certifikatave ndërkombe të nuk kërkohet plotësimi i këtij kriteri. Kjo problematikë është konstatuar edhe në auditimet e mëparshme të KLSH, dhe nga ana e DH/KBFP nuk janë ndërmarrë masat për rishikimin e këtij kriteri.

Gjatë periudhës objekt auditimi, nëpërmjet shkresës nr.8174 prot, datë 06.05.2019 është bërë kërkesë me subjekt “Kërkesë për njohje të certifikatës profesionale ndërkombe CIA” nga [REDAKTUE], drejtuar Drejtorisë së Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, Ministria e Financave. Bashkangjitur kësaj kërkesë për aplikim janë paraqitur dokumentet: Certifikatë e Kualifikimit Profesional të marrë jashtë vendit CIA; Programi i Certifikimit CIA të IIA-së, fotokopje e përkthyer dhe e noterizuar; Dokument Identifikimi; Diplomë e Universitetit të Tiranës, dega Financë-Kontabilitet (Sistemi 4-vjecar).

KKAB me Vendimin nr.36, datë 05.07.2019 ka vendosur: *Të kërkojë informacion zyrtar nga Albanian Internal Auditors për afatin e vlefshmërisë së certifikatës nr.14519 të Znj. Dallandyshë Çela lëshuar nga IIA (Shitator 2016), programin e këtij niveli certifikimi, si dhe shpjegime çfarë nënkuption afati i përkohshëm i kësaj certifikate*

Me shkresën nr.12880, datë 05.07.2019 “Kërkesë për Informacion”, drejtuar Albanian Internal Auditors është kërkuar pajisja me informacionin e sipërcituar (Kryetaria e KKAB është pjesë e Bordit të Albanian Internal Auditors). Nëpërmjet shkresës nr.12880/1, datë 16.07.2019 ‘Kthim Përgjigje’ është shprehur se: “Për të mbajtur aktiv statusin e certifikatës, çdo profesionist i certifikuar duhet të fitojë dhe raportojë tek IIA 40 orë kreditë CPE, përfshirë 2 orë trajnim mbi etikën. Ky raportim duhet të bëhet brenda datës 31 Dhjetor të çdo viti. Nëse një i certifikuar dështon në plotësimin e raportimit brenda afatit të CPE-ve të kërkuar, statusi i certifikatës bëhet “jo-aktiv” dhe certifikata nuk mund të përdoret derisa të plotësohen kërkesat. Nëse statusi i certifikatës qëndron “jo-aktiv” për më shumë se 12 muaj për shkak të mos raportimit, të certifikuarit i caktohen penalitete për riaktivizimin e certifikatës. Është dhënë edhe ëebsite i IIA, për informacione më të detajuara.”

Nëpërmjet shkresës nr.12880/1, datë 16.07.2019 “Dërgohet vendimi i komisionit”, është përcjellë Vendimi Nr. 37, datë 06.09.2019 i KKAB. KKAB në Vendimin Nr.37, datës 16.07.2019 (Protokolluar nr.16208 prot, datë 10.09.2019) vendosi:

3. Rrëzimin e kërkesës [REDAKTUE] dhe mosnjohjen e certifikatës profesionale ndërkombe “Certified Internal Auditor” (CIA) të lëshuar nga Instituti Global i Audituesve të Brendshëm, sipas arsyetimit bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Ky vendim i komunikohet kërkueses [REDAKTUE] dhe strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm.

Vendimi nuk ka qenë unanim. Nëpërmjet shkresës nr.16749, datë 19.09.2019 me subjekt “Ankesë për mosnjohje nga Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm në sektorin publik (KKAB) të certifikatës profesionale ndërkombe- CIA, dhënë nga IIA”, i është drejtuar Znj. Anila Denaj dhe Z. Gent Cakaj. Nëpërmjet shkresës nr.16749, datë 19.09.2019 është dërguar pranë KKAB për të vlerësuar ankimimin nr.16749, datë 19.09.2019. KKAB në Vendimin Nr.38, datës 03.10.2019 (Protokolluar nr.17971 prot, datë 08.10.2019) vendosi që:

3. Të konsiderojë si të pambështetur shkresën nr.16749/1, datë 27.09.2019 të strukturës përgjegjëse të harmonizimit për auditimin e brendshëm, për rivlerësimin e vendimit nr.37, datë 06.09.2019 “Për mosnjohjen e certifikatës “Auditues i Brendshëm i Certifikuar” (CIA) të lëshuar nga Instituti Global i Audituesve të Brendshëm”, për shkak se nuk ka bazë të mjaftueshme ligjore dhe faktike për rishikimin e vendimit nr.37, datë 06.09.2019.
4. Ky vendim i komunikohet kërkueses [REDAKTUE], dhe strukturës përgjegjëse për

*harmonizimin e auditimit të brendshëm.*

Nga verifikimi në ëebsite të ILA, nga grupi i auditimit rezulton [REDACTED] zoteron certifikatën ndërkombejtare të Audituesit të Brendshëm të certifikuar. Referuar mungesës së kritereve ligjore për disponimin ose jo “aktiv” të certifikatës së AB, në kuadrin ligjor ekzistues për njëhësimin e certifikatave ndërkombejtare në fushën e AB, vendimmarja e KKAB nuk është e mbështetur. Vendimmarja e KKAB në gjykimin e grupit të auditimit është e pajustifikuar

**7.1 Rekomandimi:** Klsh rekomandon se përsa kohë vendimmarja e KKAB rezulton në qëndrime të ndryshme lidhur me njohjen/mosnjohjen e certifikimeve, të plotësohet kuadri rregulator në lidhje me certifikatat të njohura ndërkombejtarisht

Ministri i Financave dhe Ekonomisë në vijim të konstatimeve të trajtuarë më sipër, dhe të dokumentacioneve përkatëse shoqëruese, të analizojojë dy vendimet e KKAB për këtë cështje përpara ndryshimit të bazës ligjore.

**Menjëherë**

## **II. MBI AKTIVITETIN E DREJTORISË SË HARMONIZIMIT TË MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT (MFK)**

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se niveli i raportimit të njësive publike pranë Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin është i ulët dhe nuk përfshin shoqëri aksionere, organizata jofitimprurëse, autoritete të përbashkëta, megjithëse një pjesë e tyre raportojnë mbi sistemet e auditit të brendshëm pranë Drejtorisës së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm. Ligji nr.10296, datë 08.07.2020 i ndryshuar, në nenin 3 “Fusha e zbatimit të ligjit” cilëson “*Ky ligj zbatohet në njësitë publike, ku përfshihen: 1. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme. 2. Shoqëritë tregtare, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta, të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme. 3. Njësi të tjera që shpenzojnë fonde publike, sipas një marrëveshjeje ndërkombejtare*”, ndërkohë me ndryshimet ligjore të vitit 2015, neni 18 (pika 1) thekson se “Nëpunësi autorizues i njësisë publike, sipas pikës 1, të nenit 3, të këtij ligji, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual....”, pra janë përashtuar nga përgjegjësia përgatitjen e pyetësorëve të vetëvlerësimit dhe raportit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe dorëzimin e tyre tek nëpunësi i parë autorizues, njësitë publike të përfshira në pikën 2, dhe 3 të nenit 3. Raportimi kufizohet vetëm tek njësitë e qeverisjes së përgjithshme, në ndryshim me ligjin e auditimit të brendshëm ku fusha e zbatimit dhe raportimi pranë DH/AB është e njëjtë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin për qëllime të vlerësimit të sistemeve të kontrollit në sektorin publik, është kufizuar në dërgimin e pyetësorëve vetëm në 150 njësi publike nga të paktën 1400 ente publike që operojnë në sistemin e thesarit. Nga analiza e listës së subjekteve të cilave ju është dërguar pyetësori konstatohet se kemi edhe njësi varësie të strukturave qendrore, fakt që sjell numër më të kufizuar të enteve mbi të cilat është bazuar vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm në vend. Niveli i ulët i mbulimit me monitorim nuk është përfaqësues i situatës së njësive në sektorin publik.

Megjithë këmbënguljen e KLSH, për disa vite rresht, numri i shkresave të dërguara për pyetësorin e vetëvlerësimit si dhe niveli i përgjigjeve mbetet larg asaj që quhet mbulim i përshtatshëm për dhënie opinioni, fakt që tregon mos vlerësim të situatës edhe pse në raportet e

KLSH strukturat e DH/MFK janë vënë në dijeni që një raportim i tillë nuk reflekton nivelin real të sistemeve. Nga ana tjetër mos rakordimi për subjektet e reportuara nga të dy strukturat pjesë të DH/KBFP, reflekton një raportimin vjetor të KBFP me pamje jo të plotë për përgjithësimë në nivel kombëtar.

**1.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, si strukturë përgjegjës për raportimin dhe monitorimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në sektorin publik, të marrë masat për shpërndarjen e pyetësorëve sipas kërkesave të nenit 3 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 të ndryshuar.

**Menjëherë**

**1.2 Rekomandimi:** Ministri i Financave dhe Ekonomisë bashkë me Bordin KBFP të analizojë problematikën që sjell shmangia e cilësuar në nenin 18 të ligjit në raport me fushën e zbatimit të specifikuar në nenin 3 por edhe më gjerë, për të evidentuar ndryshimet me synim deviacionin e përgjegjësive lidhur me aplikimin dhe raportimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

**Menjëherë**

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se raportimi bazuar në të dhënat vetëm të pyetësorëve të vetëvlerësimit, nuk reflekton situatën reale të sistemeve të kontrollit në njësitë publike. Pyetësori i vetëvlerësimit KBFP është miratuar me urdhrin nr. 117, datë 01.04.2019 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Ndryshimi i pyetësorit nuk është shoqëruar me rishikim të manualit të MFK miratuar me urdhrin nr. 108 datë 17.11.2016, me qëllim përshtatjen e tij me ndryshimet në mënyrën e vlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Konstatohet se raportimi përfundimini përfundimini se nëtijat e Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit nuk rezulton të jetë kryer, asnjë analizë e pyetësorëve të dërguara nga njësitë publike, me qëllim përcaktimin e saktësisë dhe konsistencës. Vlerësimi dhe konsolidimi i të dhënavëve rezulton të jetë kryer **vetëm** përfundimini përfundimini se papërshtatshme mbulimi (30 pyetje nga 99 pyetje që përban pyetësori), shoqërohet me deformim të opinionit mbi këto sisteme në nivel kombëtar.

Kemi konstatuar se në raportin vjetor të KBFP për vitin 2019, nuk është kryer një analizë krahasimore me vitet e mëparshme, referuar shkallës së vlerësimit të institucioneve, me arsyetimin e subjektit të audituar se janë përfshirë 18 indikatorë krahasuar me 17 indikatorë në vitin 2018. Baza e përdorur përfundimini përfundimini se rezultojnë kryesishët në rënien, dhe bëjnë përashtim vetëm 2 nga 11 ministritë, përkatësisht MBZHR dhe MEJP që rezultojnë me rritje referuar të dhënavëve të reportuara. Të dhënat përfundimini përfundimini se rezultojnë Shkodër, Korçë, Lezhë, Kukës, Fier, Elbasan, Tiranë, Durrës, Berat, Dibër, Gjirokastër dhe Vlorë.

Situata e reportuar në gjykimin tonë nuk reflekton saktësisht situatën reale në sektorin publik, kjo sepse përfundimini përfundimini se paraqiten me treguesit në rënien, me përashtim të Bashkisë Fier, Tiranë, Gjirokastër dhe Vlorë.

29% e pyetjeve lidhur me Mjedisin e Kontrollit, 33% të pyetjeve të lidhura me komponentin e Menaxhimit të Riskut, vetëm 12% e pyetjeve të lidhura me aktivitetet e kontrollit, 37% e pyetjeve të komponentit Informim dhe Komunikim dhe 100% e pyetjeve të Monitorimit.

Gjithashtu, nga auditimet e realizuara nga KLSH për llogari të zbatimit të buxhetit të vitit 2019, në njësitë e vetëqeverisjes vendore kemi konstatuar që lidhur me komponentin e **Mjedisit të Kontrollit** problematikat janë të ndjeshme duke nisur nga mungesa e rregulloreve të përditësuara të funksionimit, ku të reflektohen ndryshimet strukturore si nëbashkitë Patos, Klos, mungesë të përshkrimit të përgjegjësive të punonjësve apo mungesë të procedurave të lidhura me shkeljet disiplinore të punonjësve me kontratë apo shkeljeve të etikës si në rastin e Bashkive Sarandë, Himarë, Klos, Rrogozhinë, Finiq, Ura Vajgurore; Malësi e Madhe. Gjithashtu në Bashkitë Tepelenë, Klos, Malësi e Madhe, Këshilli i Qarkut Gjirokastër, Divjakë, Rrogozhinë, Finiq, Ura Vajgurore, Patos, Krujë, Berat është konstatuar mungesë të rregullave të dorëzimit të detyrave, trajnimeve të punonjësve si dhe delegimit të detyrave.

Në lidhje me komponentin e **Menaxhimit të riskut**, ka rezultuar se nuk është caktuar koordinatori i riskut, në Bashkitë Finiq, Ura Vajgurore, Rrogozhinë, Sarandë, etj. Nuk është hartuar regjistri i riskut në Bashkitë Tepelenë, Malësi e Madhe, nuk është kryer asnje procedurë për menaxhimin e riskut në Bashkitë Sarandë, Cërrrik dhe nuk ka të përcaktuar adresim të riskut si dhe nuk janë marrë masa për menaxhimin e tij në bashkitë Finiq, Ura Vajgurore, Skrapar, Cërrrik, Klos, Krujë, Himarë.

Nuk kanë një strategji të miratuar të risqeve në Bashkitë Sarandë, Delvinë, Roskovec, Ura Vajgurore, Divjakë, Krujë, Finiq.

Në lidhje me komponentin e **Aktivitetit të kontrollit** kemi konstatuar se ky komponent nuk kuptohet plotësisht në Bashkitë Berat, Roskovec, Skrapar, Klos, Rrogozhinë. Nuk janë hartuar rregulla për proceset e punës ne Bashkitë Tepelenë, Skrapar. Nuk janë hartuar rregulla për ruajtjen e aktiveve, ne Bashkitë Tepelenë, Delvinë, Prefekti i Qarkut Tiranë. Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave, në kundërshtim me pikën 15/b, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011, "Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike" rasti i Bashkisë Dropull, Skrapar, Finiq, Roskovec, Ura Vajgurore, Skrapar, Himarë etj. Gjurma e Auditimit nuk është miratuar në bashkitë Himarë, Delvinë, Finiq, Cërrrik, Ura Vajgurore, Malësi e madhe, Skrapar.

Në lidhje me komponentin e **Informimi dhe komunikimi**, nuk ka problematika të konstatuara nga auditimet e realizuara.

Në lidhje me komponentin e **Monitorimit**, ka problematika të lidhura me pikëzimin apriori të pyetësorit konstatuar në Bashkinë Cërrrik apo raportime jo mirë të dokumentuara në bashkitë Sarandë, Krujë, Roskovec, Skrapar

**2.1 Rekomandimi:** *Strukturat e DH/MFK të marrin masat për të bërë testimin e të paktën 50% të pyetësorëve të vetëvlerësimit përparrë se të përpunojnë të dhënat për përgatitjen e Raportit Vjetor mbi sistemet e kontrollit të brendshëm. Mbi bazën e problematikave të konstatuara të hartoher një udhëzues i plotë që duhet të ndiqet nga entet publike në plotësimin sa më të saktë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Për të gjitha devijimet që nuk i takojnë gabimeve njerëzore të merren masa disiplinore në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.*

*Afati 30.12.2020*

**2.2 Rekomandimi:** *DH/MFK të bëjë konsolidimin dhe përpunimin e të gjithë pyetësorëve të vetëvlerësimit për një vlerësim bazuar në të dhënat totale të dorëzuara nga njësia publike sipas*

*kërkesave të pyetësorit të rishikuar, duke bërë edhe identifikimin e mangësive pér çdo njësi publike. Të merren masa pér ndërhyrje të nevojshme në drejtim të përmirësimit të situatës.*

#### **Menjëherë**

**3.Gjetje nga auditimi:** Referuar detyrimit të Drejtorisë së Harmonizimit pér kryerjen e konsolidimit të raporteve dhe pyetësorëve të vetëvlerësimit të njësive publike, sipas ligjit Nr 10296 datë 08/07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” nenit 26, pika 3 i cili citon se “*Struktura Përgjegjëse e Harmonizimit pér Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin ndihmon nëpunësin e parë autorizues dhe Ministrin e Financave pér monitorimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe pér përgatitjen e raportit vjetor pér gjendjen e menaxhimit financiar dhe kontrollit publik, ku përmblidhet informacioni i marrë, në përputhje me dispozitat e nenit 18 të këtij ligji.*”, u krye analizimi i të dhënave në Raportin Vjetor të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik pér vitin 2019. Në këtë raport, Drejtoria e Harmonizimit eshtë shprehur se “*Në vijim, nga analiza e përgjithshme e 17 parimeve të kontrollit të brendshëm konstatojmë se, sistemi i kontrollit të brendshëm pér vitin 2019 paraqitet pjesërisht efektiv, ku peshën kryesore në këtë rezultat e zënë mangësitë lidhur me raportimin në kohën e duhur të problematikave të sistemit të kontrollit të brendshëm.*”.

Grupi i auditimit ka konstatuar se pér vitin 2019, nuk është kryer një përllogaritje e caktuar, si dhe nuk janë dokumentuar kriteret /indikatorët/ treguesit sipas së cilave DH/KBFP ka konkluduar në një sistem “pjesërisht efektiv”. Nëse pér vlerësimin e viteve 2016, 2017, 2018, KLSH ka cilësuar pasaktësi në vlerësim tëtreguesit, pasi ky tregues ishte përcaktuar nga mesatarja e efektivitetit të treguesit të performancës pér MFK “Gjithëpërfshirja dhe rregullsia e raportimit vjetor mbi sistemet e kontrollit të brendshëm pér ministritë e linjës, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e pavarura, Grupit 87 të Kryeministrisë dhe njësive shpenzuuese me buxhet të madh”, mesatare që jo domosdoshmërisht lidhet me efektivitetin e sistemit, ajo që konstatohet pér vitin 2019 është mungesa e plotë e raportimit të treguesit.

Viti	2016	2017	2018	2019
Niveli i efektivitetit i raportuar	79%	85%	72%	
	3.16/4	3.41/4	-	Nuk ka raportim

**3.1 Rekomandimi:** *Strukturat Drejtuese të DH/KBFP, në bashkëpunim me Bordin e KBFP, të marrin masat pér të kërkuar një raportim të saktë të efektivitetit të sistemit të kontrollit financiar publik, duke përfshirë edhe një analizë të trendit të ecurisë me vitet e mëparshme.*

Afati 31.12.2020

**4.Gjetje nga auditimi:** *Konstatohet se gjatë vitit 2019, DH/MFK nuk ka kryer monitorimet mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm ndërkohë që Raporti Vjetor i KBFP, rrapertron monitorimet e realizuara pér funksionimin e sistemeve të kontrollit të vitit 2018. Në funksion të nenit 25 pika 3 dhe nenit 26 pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar eshtë përgjegjëse pér monitorimin sistematik të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë e sektorit publik pér të vlerësuar nga afér ecurinë e zbatimit të nenit 18 të ligjit të MFK ku përcaktohet se Nëpunësi Autorizues duhet të paraqesë pranë Ministrisë së Financave pyetësorin e vetëvlerësimit, deklaratën dhe raportin mbi cilësinë e sistemeve të*

kontrollit të brendshëm të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të viti aktual.

Bazuar në manualin e MFK, Kapitulli II “Rolet dhe Aktorët në Sistemin e MFK-së”, pika 2.2.2 përcaktohet se “DH/MFK është gjithashtu përgjegjëse për monitorimin sistematik të sistemeve të MFK-së në njësitë publike. Ajo e kryen këtë monitorim nëpërmjet aktiviteteve që realizon vetë, në bashkëpunim me njësi të tjera publike, si dhe bashkërisht me DH/AB”.

Nga auditimi u konstatua se në kuadër të monitorimeve sistematike të MFK në njësitë publike për përgatitjen e raportit mbi Funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brëndshëm Financiar Publik në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme për vitin 2019, Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar ka planifikuar 17 vizita monitoruese sipas shkresës nr. 2709 prot datë 06.02.2020.

Deri në momentin e dorëzimit të raportit vjetor për cilësinë dhe funksionimin e kontrollit të brëndshëm financiar publik nuk rezulton asnjë monitorim i realizuar që mund të jetë pjesë e raportit për vitin 2019 mbi cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm për këtë periudhë.

Planifikimi i monitorimeve përgjatë gjithë viti kalendarik, i shërben kësaj drejtorie në zbatim të qëllimit të parë sipas manualit, pra grumbullimi i informacioneve me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të metodologjisë, standardeve dhe udhëzimeve, si dhe vlerësimit tësaktësisë së plotësimit të pyetësorëve të vetëvlerësimit mbi të cilat bëhet raportimi mbi gjendjen e sistemeve.

Në raportin vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar dhe publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme për vitin 2019 konkretisht në kapitullin 3, përcaktohet se përgjatë vitiit 2019 janë monitoruar 17 njësi të qeverisjes së përgjithshme. Këto monitorime, i përkasin identifikimit të besueshmërisë në dorëzimin e pyetësorëve të njësive të qeverisjes së përgjithshme pranë DH/MFK për gjendjen e sistemeve të këtyre njësive në vitin 2018 (realizuar në muajin shkurt 2019), dhe jo monitorimeve për sistemet gjatë vitiit 2019 sikundër përcakton raporti vjetor i gjeneruar nga kjo drejtori. Konstatohet se kjo strukturë jo vetëm nuk ka realizuar planin vjetor të miratuar, por ka raportuar punë të parealizuar, raportim që ka sjellë si pasojë që edhe Raporti i Paraqitur nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë për Kryeministrin dhe që do shoqërojë edhe Raportin e Zbatimit të Buxhetit të vitiit 2019, të mbart këtë raportim fiktiv.

**4.1 Rekomandimi:** *Strukturat drejtuese të DH/KBFP, Nëpunësi i Parë Autorizues dhe Titullarii Institucionit, të nxjerrë përgjegjësi konkrete për të gjithë punonjësit që nuk kanë kryer detyrat funksionale dhe me veprimet dhe mos veprimet e tyre kanë lejuar raportim të gabuar në Raportin Vjetor që i paraqitet Kuvendit.*

*Menjëherë*

**4.2 Rekomandimi:** *Për monitorimet lidhur me situatën e vitiit 2020, të programohet një numër i përshtatshëm monitorimesh, si dhe të përfshihet në programet e punës edhe ndjekja e rekomandimeve të lëna. Përzgjedhja e subjekteve për monitorim ti referohet subjekteve që shfaqin problematika të mëdha lidhur me sistemet e kontrollit bazuar jo vetëm në pyetësorët e vetëvlerësimit por edhe në raportet e auditimit të KLSH.*

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**5.Gjetje nga auditimi:** Sipas planit vjetor të DH/MFK është përcaktuar si objektiv që të kryejë trajnime specifike të institucioneve për asistencë lidhur me implementimin e sistemit të MFK. Nga auditimi u konstatua se në kuadër të planifikimit të aktiviteteve sipas shtyllës 5 të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020, Drejtoria e Harmonizimit gjatë vitiit 2019, në mbledhjen e bordit të KBFP-së me datë 25.09.2019 vendosi përgatitjen dhe dërgimin e një

shkrese informuese për institucionet pilot të përgjedhura me afat realizimi aktivitetesh 1 vjeçar për 4 ministri linje dhe 3 bashki, konkretisht për: Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Shëndetësisë, Bashkinë Vlorë, Durrës dhe Lezhë. Pilotimet janë parashikuar fillimisht si një asistencë teknike mbi realizimin e kërkesave të MFK për implementimin e një sistemi modern te MFK. Gjatë auditimit të mëparshëm të KLSH, rezultoi se pilotimet e iniciuara nga Drejtoria e Harmonizimit, në Ministrinë e Brendshme dhe në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, deri në fund të periudhës objekt auditimi, nuk kishin kryer të gjithë aktivitetet e planifikuara nga drejtoria. Ky proces, rezulton i papërfunduar dhe i ndërprerë nga DH/MFK për këto dy institucionë edhe gjatë këtij viti, duke mos realizuar pilotimin në përbushje të objektivave përmes modernizimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Rezulton se në mbledhjen e bordit të KBFP-së me datë 19.12.2019, u vendos që për shkak të situatës së krijuar nga termetet, të zëvendësohen institucionet e përgjedhura për asistencë teknike, konkretisht Bashkia Lezhë dhe Durrës me Bashkinë Elbasan dhe Kukës.

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentacionin e vendosur në dispozicion për vijueshmërinë e procesit të pilotimit në institucionet e përcaktuar si më sipër konstaton si më poshtë:

**1. Pilotimi në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (i papërfunduar).** Përgjedhja e institucionit është kryer në mbledhjen e bordit të KBFP-së më datë 25.09.2019, pa u shoqëruar me kriteret sipas së cilës është vendosur të kryhet monitorimi në këtë institucion, edhe pse ky institucion qëndron në rang rankimi në vendin e parë sipas renditjes së ministrive të linjës pëtreguesit e performancës.

Planifikimi për kryerjen e vlerësimit të institucionit për gjendjen e sistemeve të MFK dhe ofrimi i asistencës teknike është përcaktuar përgjatë vitit 2020 sipas shkresës datë 30.10.2019. Plani i aktiviteteve të cilat duhet të ishin përfunduar sipas afateve të dakordësuara si a) vlerësimi paraprak për statusin e implementimit të kërkesave të MFK-së, b) trajnimin e përgjithshëm për stafin e MFE mbi kërkesat dhe mënyrën e implementimit të kërkesave ligjore të MFK-së, c) përgatitja e manualeve të proceseve të punës nuk rezultojnë të jenë të dokumentuara apo të ketë produkte, ndërsa për 5 aktivitete të tjera nuk ka u vu në dispozicion asnjë dokument që vërteton realizimin e tyre.

Përsa i përket institucioneve të tjera të planifikuara për implementimin e sistemit modern të MFK, rezulton se janë kryer vetëm njoftimet si më poshtë, pa u shoqëruar me aktivitetet konkrete që do të kryhen në këto institucionë dhe afatet përkatëse. Janë njoftuar në periudhën nëntor-dhjetor 2019, institucionet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Elbasan, Bashkia Kukës, Bashkia Vlorë por nuk ka raportim apo dokumentim të aktiviteteve të realizuara. Edhe për këto institucionë nuk disponohet metodologjia apo vlerësimi sipas së cilës është kryer përgjedhja e tyre. Konkretisht, Bashkia Kukës sipas renditjes të sistemeve të kontrollit të brendshëm, nuk rezulton të disponojojë sisteme të dobëta. Gjithashtu, në analogji edhe Bashkia Vlorë rezulton në nivele të kënaqshme renditjeje, si dhe ka qënë pjesë e pilotimit të Drejtorisë së Harmonizimit një vit më parë, proces i cili është deklaruar i konkluduar me rishikimin e kuadrit rregullativ dhe implementimin e sistemit modern.

Konstatojmë gjithashtu mungesë të analizës dhe evidencave të zbatimit të kritereve në përgjedhje të njësive "pilot". Kështu, përgjedhja e Bashkisë Vlorë, e cila është institucion i cili ka qenë pjesë e projektit të mëparshëm si njësi pilot evidenton formalizmin në proces dhe lë të paqartë arsyet pse këtonjësi klasifikohen si njësi pa sistem modern të MFK, edhe pse renditja e saj në rankimet e treguesve të performancës për vitin 2019 është e kënaqshme.

Nga auditimi u konkludua se në kundërshtim me planin e aktiviteteve në kuadër të shtyllës 5 të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020, Drejtoria e Harmonizimit nuk ka mundur të kryejë implementimin e sistemit të MFK në asnjë nga njësitat e përgjedhura pilot për vitin 2019, edhe pas ndryshimeve të kryera në llojin e tyre, duke mos përgatitur relacione shpjeguese dhe duke mos e prezantuar këtë çështje si mosrealizim objktivi në Raportin Vjetor 2019.

Mosrealizimi edhe i këtij aktiviteti nga ana e DH/MFK, evidenton mangësitë që ekzistojnë në planifikimet/realizimet e punës së kësaj drejtorie, të cilat ndikojnë edhe në progresin e pritshëm të objektivave të strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike të rishikuar.

**5.1 Rekomandimi:** *Drejtoria e Harmonizimit të KBFP të marrë masat për një planifikim të kujdeshëm të punës së DH/MFK, në mënyrë që fokusi kryesor të jenë realizimi i objektivave lidhur me forcimin e kontrollit të brendshëm, në funksion të të cilit janë edhe pilotimet. Strukturat largohen formalitetit të realizimit të funksioneve të pilotimit dhe raportimit lidhur me to.*

**5.2 Rekomandimi:** *Drejtoria e Harmonizimit të KBFP dhe Nëpunësi i Parë Autorizues të analizojnë ngarkesat funksionale të DH/MFK të lidhura me aktivitetin e viti 2019, për të gjykuar realisht mbi pamundësinë e kryerjes së pilotimeve dhe vlerësimi i kostove buxhetore të pajustifikuara në kushtet e mos përmbrushjes së detyrave funksionale nga kjo drejtori.*

**Menjëherë**

**6.Gjetje nga auditimi:** Në lidhje me sistemin e pikëzimit të përgjedhur nga DH/MFK në kuadër të indikatorëve të performancës, u analizuan vlerësimet e dhëna nga ana e Drejtorisë në vijim të përgjigjeve të institucioneve shtetërore në pyetësorët e vetëvlerësimit.

Për sa më sipër, në përfundim të auditimit me zgjedhje mbi vlerësimin e indikatorëve të raportuar sipas strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020 grupi i auditimit konstatoi që ylerësimi i pyetësorëve është realizuar në mënyrë jo të drejtë dhe konsistente ndërmjet institucioneve duke patur parasysh që përgjigje të ngjashme vlerësimi ka qenë i ndryshëm, sikundër evidentohet nga disa rastë të evindetuara. Këto raste përshijnë: Bashkinë Kolonjë dhe Ministrinë e Shëndetsisë dhe Mbrojtjes Sociale me vlerësimë të ndryshme për përgjigje të ngjashme përsa i përket pyetjes 5, Ministria e Mbrojtjes dhe Bashkia Vlorë me vlerësimë të ndryshme për përgjigje të ngjashme përsa i përket pyetjes 8, Bashkia Shkodër dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me vlerësimë të ndryshme për përgjigje të ngjashme përsa i përket pyetjes 10, Bashkia Ura Vajgurore dhe Bashkia Selenicë me vlerësimë të ndryshme për përgjigje të ngjashme përsa i përket pyetjes 18, Bashkia Elbasan dhe Ministria e Drejtësisë me vlerësimë të ndryshme për përgjigje të ngjashme përsa i përket pyetjes 21, Bashkia Selenicë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me vlerësimë të ndryshme për përgjigje të ngjashme përsa i përket pyetjes 22, Bashkia Fushë Arrëz dhe Bashkia Korçë me vlerësimë të ndryshme për përgjigje të ngjashme përsa i përket pyetjes 23, Bashkia Kavajë dhe Bashkia Mat me vlerësimë të ndryshme për përgjigje të ngjashme përsa i përket pyetjes 24, Gjykata Kushtetuese dhe Ministria e Kulturës me vlerësimë të ndryshme për përgjigje të ngjashme përsa i përket pyetjes 30, Kryeministria dhe Bashkia Vau i Dejës me vlerësimë të ndryshme për përgjigje të ngjashme përsa i përket pyetjes 43, Bashkia Fushë Arrëz dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me vlerësimë të ndryshme për përgjigje të ngjashme përsa i përket pyetjes 62, Bashkia Kavajë dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme me vlerësimë të ndryshme për përgjigje të ngjashme përsa i përket pyetjes 82, Bashkia Patos dhe Këshilli i Qarkut Fier me vlerësimë të ndryshme për përgjigje të ngjashme përsa i përket pyetjes 88 dhe Bashkinë Ura Vajgurore dhe Bashkinë Pukë me vlerësimë të ndryshme për përgjigje të ngjashme përsa i përket pyetjes 92.

Mungesa e standartizimit të pikëzimit të dhënë nga ana e Drejtorisë krahas përgjigjeve të institucioneve, ndikon drejtpërdrejtë në vlerësimin final dhe rankimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm për këto institucione.

Gjithashtu, vijon të ekzistojë problematika lidhur me mos përgatitjen nga ana e DH/MFK të komenteve apo sugjerimeve lidhur me pyetjet ku evidentohen mangësi, në mënyrë që subjekti të njihet me dobësitë e tij me qellim përmirësimin e këtyre sistemeve. Ky përfundim lidhet edhe me faktin se roli i Drejtorisë, sikundër është përcaktuar në misionin dhe objektivat e saj, duhet t'i shërbejë institucioneve nëpërmjet asistimit të vazhdueshëm për përmirësimin e shtyllave të sistemeve të kontrollit të brendshëm, dhe jo kryerjen e analizave statistikore për më tepër të pabazuara në modele standarde.

Gjithashtu, grupi i auditimit nëpërmjet të dhënavë të siguruara nga auditimet e kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit gjatë vitit 2020 në disa institucione, ka analizuar trajtimin ndër të tjera edhe sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit në subjektet e audituara. Në pyetësorët e dorëzuar nga KLSH, krahasuar me përgjigjet e dorëzuara nga institucioneve pranë DH/MFK evidentohet se për pyetje të cilat janë lidhur me të njëjtat cështje/dokumentacione, ka pasur përgjigje të ndryshme nga subjektet.

Ky fenomen evidenton formalitetin e përgjigjeve nga ana e institucioneve dhe dobësitë në realizimin e monitorimeve nga ana e Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, me qëllim informimin dhe trajnimin e vazhdueshëm të stafit mbi rëndësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

**6.1 Rekomandimi:** DH/KBFP të marrë masat për një vlerësim real me pikë të institucioneve raportuese pranë drejtorisë. Të nxirret përgjegjësia për vlerësimet jo korakte apo të pa unifikuara të DH/MFK

Menjëherë

**7.Gjetje nga auditimi:** Konstatohet inkonsistencë lidhur me indikatorët sipas Pasaportës së Indikatorëve për marrjen e rezultateve të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020 dhe Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2019-2022 (shtylla e Kontrollit të Brendshëm dhe Kontabilitetit në Sektorin Publik). Gjatë vitit 2019, Drejtoria e Harmonizimit ka kryer rishikimin e Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2019-2022 (shtylla e Kontrollit të Brendshëm dhe Kontabilitetit në Sektorin Publik), pa bërë një analizë të plotë të realizimit të objektivave të Strategjisë së mëparshme 2014-2020.

Referuar Pasaportës së Indikatorëve për marjen e rezultateve të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020, për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe arritjen e objektivave ishte përcaktuar si indikator “100 % e institucioneve buxhetore duhet të përdorin kërkasat FMC në mënyrë që të përmirësojnë sistemin e kontrollit të brëndshëm dhe të realizojnë objektivat dhe rezultatet”, raportimi duhet të ishte vjetor, ndërsa lidhur me matjen ishte parashikuar “*Performance e institucioneve publike përbehet nga një numër indikatorësh i kombinuar në mënyrë të tillë që të ndihmojë krijimin e një opinioni të bazuar në: Kualitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe pajtueshmëria e institucioneve publike konform legjislacionit në fuqi. Vlerësimi realizohet në bazë të vetëvlerësimit të sistemit i bërrë nga institucioni që plotëson pyetësorin. Institucioni vlerësues plotëson pyetësorin duke përdorur një sistem pikëzimi me 4 pika: Rezultati minimal që një institucion mund të arrij është 39 pikë- nuk i plotëson kriteret. Rezultati maksimal që një institucion mund të arrij është 156 pikë i plotëson kriteret. Indikatorët do të maten si një mesatare e vetëvlerësimit. Mesatarja e vlerësimit matet si totali i mesatares së vlerësimit për çdopyetje, me totalin e pyetjeve që është 39*”. Synohej një

trend rritës në efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga viti në vit, me afat vitin 2020. Megjithatë, ashtu sikundër është trajtuar edhe në auditimet e mëparshme, theksohet fakti se DH/KBFP nuk ka përfshirë në raport një nivel të matshëm për të përcaktuar efektivitetin e sistemit të njësive publike. Pyetësorët e vetëvlerësimit nuk janë ylerësuar me pikë nga ana e drejtorisë për të gjitha çështjet që 99 pyetjet mbulojnë, në mënyrë që të kryhej dhe matja e pikëve për njësitë publike, dhe po ashtu në rang sistemi.

**Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike 2019-2022** ka përcaktuar si **Objektiv Specifik 6:** Kontrolli i brendshëm efektiv me fokus, krijimin e një menaxhimi financiar dhe mjedisi kontrolli të brendshëm më të fortë; sisteme funksionale për kontrollin e brendshëm; sistem i forcuar monitorimi i KBFP-së. Strategjia nuk shoqërohen me metodologji të matjes së indikatorëve për sa kohë nuk ka indikatorë dhe aq më pak me targete lidhur me produktet.

Indikatori	Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020	Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike 2019-2022
Objektivi	100 % e njësive buxhetore do te përdorin kërkesat e MFK për të përmirësuar sistemet e kontrollit të brendshëm dhe arritjen e rezultateve dhe objektivave	Forcimi i sistemit për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik në qeverinë qendrore dhe vendore. Përgjegjshmëri efektive menaxheriale në gjithë institucionet publike.
Metodologja	Mesatarja $\frac{\text{Njësia Buxhetore}}{\text{Tëratë i përsurte}}$ Kriteri 39 pyetje  Vlera e Indikatorit = $\frac{\text{Njësia Buxhetore}}{\text{Numri i njësive buxhetore}}$	Mungan
Produkti/Targeti	Trend rritës i efektivitetit te sistemit te kontrollit te brendshëm nga viti në vit	Produkti Krijimi i një menaxhimi financiar dhe mjedisi kontrolli të brendshëm më të fortë; Produkti Sisteme funksionale për kontrollin e brendshëm; Produkti Sistem i forcuar monitorimi i KBFP-së.

*Për sa më sipër, grupi i auditimit vijon të theksojë rëndësinë e krijimit të produkteve të matshme për vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, në mënyrë që të shqyrtohet rëndësia e kryerjes së analizave krahasimore ndër vite, në përputhje me Pasaportën e Indikatorëve të Strategjisë së mëparshme. Pra në strategjinë e re edhe ato tregues (sado që mund të kishim vërejtje edhe për to) nuk janë më. Nuk ka as strategji dhe as ndonjë metodologji në funksion të saj, tregues të matshëm lidhur me produkta të cilat në mënyrën se si janë dizenuar, nuk kanë as fillim dhe as fund.*

**7.1 Rekomandimi:** Bordi i KBFP, Nënpunësi i Parë Autorizues, në bashkëpunim me strukturat drejtuese të Drejtorisë së Harmonizimit të KBFP të marrin masa të menjëherëshme për plotësimin e elementeve të strategjisë që lidhen me matjen e progresit të produkteve të lidhura me objektivat e strategjisë.

Menjëherë

**8.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se referuar përgjegjësisë së Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit mbi krijimin dhe përditësimin e regjistrat të nëpunësve autorizues dhe zbatues të njësive publike, sipas nenit 26, pika 1. dh e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, e cili citon se “*Struktura Përgjegjëse e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin në Ministrinë e Financave është përgjegjëse për krijimin dhe përditësimin e regjistrat të nëpunësve autorizues*

*dhe nепунесве збатуес тё нјесиве публике.*”,nga verifikimi i rregullsisë së përbajtjes dhe përditësimit të regjistrat të nепунесит збатуес dhe autorizues, bazuar në dokumentin e vendosur në dispozicion më datë 19/6/2020, u identifikuva pasaktësi dhe mungesë informacioni, ku konkretilisht:

**Të dhënati e pasqyruar për subjektet nuk janë tё unifikuara në emërtime dhe përbajtje,** pasi në disa raste evidentohet mungesa e tё dhënavë mbi pozicionin e nепунесит збатуес dhe autorizues, varësinë e shkresave konfirmuese, pozicionin sipas strukturës, apo arsimimin.

Nga auditimi i tё dhënavë tё raportuara për nепунесит збатуес në projekte (në total 325 rekorde), u konstatua se:

- Në 311 raste mungojnë tё dhënat lidhur me arsimin
- Në 86 raste mungojnë tё dhëna lidhur me pozicionin
- Në 82 rekorde mungojnë tё dhëna mbi shkresën konfirmuese
- Në 11 rekorde mungojnë kredencialet e personit përgjegjës
- Në 318 rekorde niveli hierarkik rezulton i paplotësuar

Nga auditimi i tё dhënavë tё raportuara për nепунесит збатуес në bashki (në total 261 rekorde), u konstatua se:

- Në 54 raste mungojnë kredencialet e personit përgjegjës
- Në 59 raste mungojnë tё dhënat lidhur me pozicionin
- Në 55 raste mungojnë tё dhënat mbi arsimin
- Në 176 raste mungojnë tё dhëna mbi shkresën konfirmuese
- Në 271 rekorde niveli hierarkik rezulton i paplotësuar

Nga auditimi i tё dhënavë tё raportuara për nепунесит збатуес në institucionet qëndrore (në total 892 rekorde), u konstatua se:

- Në 53 raste niveli hierarkik rezulton i paplotësuar
- Në 121 raste mungojnë kredencialet e personit përgjegjës
- Në 152 raste mungojnë tё dhënat lidhur me pozicionin
- Në 106 rekorde mungojnë tё dhënat mbi eksperiençen e punës
- Në 503 raste mungojnë tё dhëna mbi shkresën konfirmuese

Nga auditimi i tё dhënavë tё raportuara për nепунесит autorizues në institucionet qëndrore (në total 1011 rekorde), u konstatua se:

- Në 523 raste mungojnë kredencialet e personit përgjegjës
- Në 57 raste ku është evidentuar se mungojnë kredencialet, konstatohet edhe mungesa e tё dhënavë lidhur me pozicionin
- Në 75 raste ku është evidentuar se mungojnë kredencialet, konstatohet edhe mungesa e tё dhënavë lidhur me shkresën konfirmuese

Nga auditimi i tё dhënavë tё raportuara për nепунесит autorizues në institucionet vendore (në total 266 rekorde), u konstatua se:

- Në 168 raste mungojnë kredencialet e personit përgjegjës
- Në 174 raste mungojnë tё dhënat lidhur me pozicionin
- Në 198 raste mungojnë tё dhëna mbi shkresën konfirmuese

U konstatuan dublikime tё dhëash mbi nепунесит збатуес dhe autorizues në disa institucione, apo projekte.U konstatua se informacioni i paraqitur në regjistër nuk është i përditësuar, duke identifikuar nепунес autorizues apo збатуес tё cilët edhe pse janë tё konfirmuar, nuk rezultojnë në regjistër. Lidhur me nепунесит autorizues dhe збатуес tё deleguar për një periudhë tё përkohshme, vijon tё mos praktikohen sinjalizimet në regjistër përfundimin e afatit tё delegimit, duke rezultuar në mungesë tё informacionit tё saktë e tё plotë mbi periudhat

respektive.

Nga auditimi u konstatua se sipas regjistrat tē vendosur nē dispozicion, nē Degën e INSTAT, rrathi Korçë, pozicioni i nēpunësit zbatues dhe autorizues mbahet nga i njëjtë person, nē kundërshtim meligjin 10296, i ndryshuar, neni 22 pika 3.c “Veprimtaritë e kontrollit” e cila citon se “*Veprimtaritë e kontrollit përbajnjë, minimalisht sistemin e dy nënshkrimet, i cili nuk lejon që angazhimi financiar të kryhet pa marrë nënshkrimet e nēpunësit autorizues dhe tē nēpunësit zbatues tē njësisë apo tē nēpunësve të deleguar prej tyre sipas shkallës së riskut tē lidhur me tē, tē vlerësuar pér çdo angazhim;*” dhe manualin e MFK, Kapitulli II, pika “Sistemi me dy firma”, e cila citon se “*Sistemi me dy firma (me tē paktën dy firma) eshtë një procedurë e cila kryhet pér tē vërtetuar saktësinë e tē dhënave tē përfshira në dokument....Qëllimi i kësaj procedurë eshtë tē garantojë se personi përgjegjës pér rregjistrimet nē kontabilitet eshtë i informuar pér detyrimin financiar që do tē merret përsipër apo që do tē paguhet dhe do tē kryejë saktë veprimet e kontabilitetit. Sistemi i firmës së dyfishtë jep garancinë se marrja përsipër e detyrimit financiar apo pagesa bëhet nga personi i autorizuar dhe se nuk ka shkelje tē disciplinës financiare apo buxhetore..*”

Referuar memo-s nr.23209 datë 16.12.2019 tē Drejtorisë së Përgjithshme tē Thesarit identifikohen 466 institucione buxhetore nē tē cilët nēpunësi zbatues kryen edhe regjistrimin e transaksioneve buxhetore, nē kundërshtim me rregullat e kontrollit tē brendshëm financiar pér ekzekutimin e transaksioneve financiare tē buxhetit tështetit, ku përcaktohet detyrimi ligor pér përfshirjen e minimalisht tre punonjësve nē rolin e regjistruesit tē transaksionit, nēpunësit zbatues dhe nēpunësit autorizues, shprehur nē nenin 22 pika 3 “*Veprimtaritë e kontrollit*” tē ligjit 10296, i ndryshuar, ku citohet se “*Veprimtaritë e kontrollit përbajnjë, minimalisht: ....ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit nē atë formë, nē mënyrë që i njëjtë punonjës tē mos jetë përgjegjës nē tē njëjtën kohë pér propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin;*”.

Nga auditimi u konstatohet se Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit tē Kontrollit tē Brendshëm Financiar Publik përgjatë vitit 2019 ka konfirmuar 49 shkresa pér nēpunësit zbatues tē institucioneve buxhetore tē identikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit si institucione që operojnë nē kundërshtim me rregullat e kontrollit tē brendshëm. Deri nē fund tē periudhës së auditimit, DH/KBFP nuk ka arritur t'i japë një zgjidhje problematikës së konstatuar nē memon e datës 16.12.2019.

**8.1 Rekomandimi:** Nënpunësi i Parë Autorizues nē bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme tē Harmonizimit tē Kontrollit tē Brendshëm Financiar Publik tē marrë masa pér zgjidhjen e problemit tē evidentuar.

#### Menjëherë

**9.Gjetje nga auditimi:** Në zbatim tē ligjit nr 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit tē Lartë tē Shtetit” neni 15 gërrma J “*Kontrolli i Lartë i Shtetit,sipas rastit,në fillim,përgjatë dhe/ose në përfundim tē veprimtarisë duhet tē vendosë një afat kohor pér zbatimin e rekomandimeve dhe tē informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më tē larta rreth programeve tē tyre, pér tē zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve tē mësipërm,brënda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës*”.

Nga verifikimi i zbatimit tē rekomandimeve tē dërguara nē Drejtorinë e Harmonizimit tē Kontrollit tē Brendshëm Financiar Publik, konstatohet se niveli i pranimit dhe zbatimit tē rekomandimeve tē lëna nga KLSH, paraqitet si më poshtë:

Janë rekomanduar 27 masa organizative tē cilat janë ndarë në:

- 13 Masa Organizative drejtuar Drejtorisë së Harmonizimit tē Menaxhimit Financiar dhe

Kontrollit (DH/MFK), nga të cilat janë pranuar 8 masa organizative. Nga masat organizative të pranuara, **1 masë është realizuar, 5 masa organizative janë në proces zbatimi, dhe 2 masa organizative nuk janë realizuar.**

- **14 Masa Organizative** drejtuar Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm (DH/AB), nga të cilat janë pranuar 14 masa organizative. Nga masat organizative të pranuara, **3 masa janë realizuar, 8 masa organizative janë në proces zbatimi, dhe 3 masa organizative nuk janë realizuar.**

- Lidhur me rekomandimin “**Mbi zbatimin e rekomandimeve në auditimin e mëparshëm**”, struktura e DH/KBFP nuk e ka marrë në konsideratë, dhe si pasojë situata nga viti në vit lidhur me aktivitetin e kësaj Drejtorie ka ardhur duke u përkqësuar.

- **Eshtë rekomanduar Masë Disiplinore**, për dy persona, e cila rezulton e pa zbatuar. Qëndrimi neglizhues ndaj rekomandimeve të KLSH, të vërejtur të paktën në tre vitet e fundit, ka bërë që problematikat e konstatuara nga auditimet të vijojnë të ekzistojnë dhe mos marrja e masave për përmirësimin e situatës ka sjellë impakt në cilësinë e menaxhimit financiar dhe kontrollit, në nivelin e dobët të sistemeve të kontrollit në entet publike dhe rritjen e nevojës për auditim të jashtëm.

**9.1 Rekomandimi:** Bordi i KBFP dhe Nënpunësi i Parë Autorizues, në bashkëpunim me strukturat drejtuese të Drejtorisë së Harmonizimit të KBFP të marrin masa të menjëherëshme për zbatimin e rekomandimeve të lëna në funksion të përmirësimit të sistemeve të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik.

**Menjëherë**

### **C. MASA ADMINISTRATIVE**

Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të merren masa për vendosjen dhe arkëtimin e masave administrative në zbatim të kërkesave të nenit 18 dhe 29 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, për mospërgatjen dhe nënshkrimin e deklaratës dhe raportit vjetor mbi cilësinë dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, nga ana e nënpunësve autorizues në institucionet buxhetore që drejtojnë.

### **D. MASA DISIPLINORE**

Në mbështetje të shkronjës (c) nen 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për mos zbatim jo të plotë të ligjit nr 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, në zbatim të shkronjës (a), nenit 58, “llojet e masave disiplinore” të ligjit nr.152/2013 datë 30.05.2017 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i **rekomandojmë** Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe/ose Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, që të fillojnë procedurat për dhëni e masës disiplinore për drejtuesit e strukturave që me veprimet dhe mosveprime kanë sjellë:

1. Prezantimi i një raportimi jo të saktë në lidhje me monitorimet e realizuara për efekt të raportimit në Kuvend, trajtuar më hollësishët në Raportin Përfundimtar të Auditimit. Mos përbushja e planit vjetor të aktiviteteve të DH/MFK.
2. Për mos zgjidhjen e problematikës me transaksionet financiare për nënpunësit zbatues referuar nenit 22 pika 3 “*Veprimtaritë e kontrollit*” të ligjit 10296, i ndryshuar, ku citohet se

*“Veprimtaritë e kontrollit përmbajnë, minimalisht: ....ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin; ”, trajtuar më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit.*

3. Nuk kanë marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të përsëritura nga KLSH për përmirësimin e gjendjes dhe raportimin e saktë në Kuvend.

*Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi*

#### **GRUPI I AUDITIMIT**

